Based on the empirical results, it was found that there is a higher average of the willingness to implement new technology in the teaching process by teachers who have received ICT training,  $M=3.48$ , whereas there is a significantly lower average of willingness to use technology in teaching process by teachers who do not have ICT training,  $M=2.49$ ,  $F=0.781$ ,  $p=0.000<0.05$ . The results show that there are statistically significant differences between the averages of the groups, thus the zero hypothesis is rejected and the alternative hypothesis is supported.

**Hypotheses 4:**

**Alternative hypothesis (AH): There is a statistically significant correlation between the keenness of students using technology in learning and being active.**

**Hypotheses zero (HO): There is no correlation between the keenness of students using technology in learning and being active.**

In order to find the correlation between the variables, the Pearson correlation coefficient was used. Correlational results show that there is a moderate relationship between students' keenness to apply new technology and being active in the learning process,  $r=0.516^{**}$ , with statistical significance,  $p=0.000<0.05$ . The preference to apply new technology in learning, influences students to be more active in learning.

## **DISCUSSION OF THE RESULTS**

Conditions at school are an important factor for good running of the learning process. In order to apply new technology, the school must offer proper conditions. During the analysis of the results by the ANOVA test, it was found that teachers, whose schools offer good conditions to implement new technology, are more willing to implement new technology in teaching process, rather than teachers who do not have good conditions in their schools. Also in a study conducted by Kučina, it was found that the attitude of teachers is more positive when they have good conditions in the institution to apply e-learning and ICT (Kučina, 2020).

Empirical results show that when new technology is applied, students generally have a higher motivation. About 50% of male students and 71% of female students fully agree that by new technology, they are more motivated to learn. The results of the t-test show a higher level of motivation in female students, compared to male students.

The willingness to implement new technology, in addition to the conditions of the schools, is also related to the knowledge of teachers on the use of technology. Based on the empirical results, there is a significant higher willingness of the teachers who have received ICT training to implement new technology than teachers who have not received ICT training.

Using the correlation method, a significant statistical correlation was found between the two variables. Based on the correlation coefficient, it was found that

there is a moderate correlation level, with a statistical significance, between the keenness of students to implement new technology and being active in the learning process.

## BIBLIOGRAPHY

1. Bezić, K. (2000) Tehnologija obrazovanja i školovanje učitelja. U: Rosić, V., ur., *Nastavnik i suvremena obrazovna tehnologija: zbornik radova*. Rijeka: Filozofski fakultet, str. 19-26.
2. Branisavljević, M. R. & Milovanović, M. (2014). Savremene tehnologije u nastavi stranih jezika. Sinteza. <https://www.researchgate.net/publication/269231631>
3. Camilleri, M. A. and A. C. Camilleri. (2016). "Digital Learning Resources and Ubiquitous Technologies in Education," *Tech Know Learn*, pp. 65-82.
4. Čelebić, G. & D. I. Rendulić. (2011). Osnovni pojmovi informacijske i komunikacijske tehnologije. U ITdesk.info-projekt računalne e-edukacije sa slobodnim pristupom-Priručnik za digitalnu pismenost. Zagreb: Otvoreno društvo za razmjenu ideja (ODRAZI).
5. Chan, T.-W.; Roschelle, J.; Hsi, S.; Sharples, M.; Brown, T.; Patton, C.; Cherniavsky, J.; Pea, R.; Norris, C. (2006). One-to-one technology-enhanced learning: An opportunity for global research collaboration. *Res. Pract. Technol. Enhanc. Learn.* 1, 3-29. [CrossRef]
6. Činko, M. (2016). Upotreba informacijske i komunikacijske tehnologije u nastavi (Diplomski rad), dabar, Rijeka.
7. Collier, D., K. Burkholder and T. Branum. (2013). *Digital Learning: Meeting the Challenges and Embracing the Opportunities for Teachers*. Committee for Economic Development prepared in cooperation with Texas Association of School Administrators & Fort Worth Chamber of Commerce.
8. Epignosis LLC. *E-Learning Concepts, Trends, Applications*. 2014. Available from: [https:// www.talentlms.com/elearning/](https://www.talentlms.com/elearning/)

9. Grand-Clement, S. (2017). Digital learning: Education and skills in the digital age, RAND Corporation, Santa Monica, Calif., and Cambridge, UK.
10. Johannesen, T. & Eide, E., 2000. The role of the teacher in the age of technology: Will the role change with use of Information and communication technology in education?. 24 11.
11. Johnson, L., Adams Becker, S., Cummins, M., Estrada, V., Freeman, A., and Hall, C. (2016). NMC Horizon Report: 2016 Higher Education Edition. Austin, Texas: The New Media Consortium.
12. Kučina Softić, Sandra. (2020). Digitalne kompetencije nastavnika za primjenu učenja u visokom obrazovanju (doktorski rad), dabar, Zagreb.
13. Kümmel, E., J. Moskaliuk, U. Cress and J. Kimmerle. (2020). Digital Learning Environments in Higher Education: A Literature Review of the Role of Individual vs. Social Settings for Measuring Learning Outcomes, MDPI, pp 1-19. [www.mdpi.com/journal/education](http://www.mdpi.com/journal/education)
14. Park, S. Y. (2009) An analysis of the technology acceptance model in understanding university students' behavioral intention to use e-learning. *Educational Technology & Society*, **12**(3):150-162.
15. Reimagining the Role of Technology in Education: 2017 National Education Technology Plan Update <http://tech.ed.gov> Salavati, Sadaf. (2016). Use of Digital Technologies in Education: The Complexity of Teachers' Everyday Practice (Doctoral dissertation), Linnaeus University Press, 351 95 Växjö, Sweden, ISBN: 978-91-88357-39-7.
16. Seljan, S. (2019). Informacijska i komunikacijska tehnologija (IKT) u interdisciplinarnom okruženju nastave jezika. <https://www.researchgate.net/publication/334611413>
17. Sousa, M. J., R. Cruz & J. M. Martins. (2017). Digital learning methodologies and tools-A literature review, <https://www.researchgate.net/publication/318679851>.
18. VanderArk, T. & C. Schneider. (2012). How Digital Learning Contributes to Deeper Learning.
19. Vojka-Ismajli, Hatixhe. (2012). Teknologija mësimore dhe të menduarit kritik, Libri shkollor, Prishtinë.

# ORIENTIMI NË KARRIERË I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE NËNTËVJEÇARE NË KOSOVË

Avdyl Kastrati-PhD Candidate

[avdylkastrati@hotmail.com](mailto:avdylkastrati@hotmail.com)

---

## Abstrakt

Qëllimet e të mësuarit, përfshijnë përmirësimin e efikasitetit të sistemit të arsimit dhe trajnimit dhe menaxhimin e ndërlihdjes së tij me tregun e punës. Nëse individët marrin vendime për atë që duhet të mësojnë në një mënyrë të mirëinformuar dhe të menduar mirë, të lidhur me interesat e tyre, kapacitetet dhe aspiratat e tyre, investimet në sistemet e arsimit dhe trajnimit ka të ngjarë të japin kthime më të larta (Watts, 2009). Udhëzimet shkollore për orientim në karrierë mund të planifikohen mjaft herët. Ndërgjegjësimi për rëndësinë e karrierës dhe zhvillimin e zakoneve të punës mund të fillojnë që në klasat e ulëta të shkollës fillore në mënyrë që nxënësit të kuptojnë se veprimet e tyre në moshën 11 ose 12 vjeç do të kenë implikime për zhvillimin e tyre gjatë gjithë jetës profesionale (Babarović&Šverko, 2017). Super identifikoi moshat para 14 vjeç si periudhën paraprake në të cilën fëmijët fillojnë të mendojnë për karrierën dhe veten e tyre (Super, 1980).

Qëllimi i hulumtimit është të gjendet nëse nxënësit e shkollave nëntëvjeçare arrijnë të orientohen drejtë në drejtimin që do të zgjedhin në shkollën e mesme të lartë.

Nga rezultatet empirike u gjet se rreth 72.3 % e mësimeve, konsiderojnë se i orientojnë drejtë nxënësit në karrierë, 6.3% konsiderojnë se nuk kanë dhënë ndonjë kontribut të madh, ndërsa vetëm 48.9% e nxënësve konsiderojnë se në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët, janë udhëzuar dhe edukuar drejtë për

orientim në të drejtë në karrierë, ndërsa 24.3% e tyre, konsiderojnë se askush nuk është marr me orientimin e tyre në karrierë.

Rezultatet empirike treguan se ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të nxënësve dhe mësimitdhënësve, lidhur me orientimin në karrierë. Nga këto rezultate, u gjet se mësimitdhënësit pretendojnë nivel më të lartë të udhëzimeve dhe edukimit të nxënësve për karrierë, ku  $M=59.91$ , ndërsa nxënësit, kanë qëndrim më të ulët ndaj orientimit dhe edukimit për karrierë nga ana e mësimitdhënësve,  $M=46.09$ , ndërsa  $p=0.000<0.05$ .

**Fjalë kyçe:** *karrierë, nxënës, orientimi, shkolla nëntëvjeçare.*

## HYRJE

Fenomeni i globalizimit ka çuar në rritje të konkurrencës dhe kërcënim për mbijetesën e organizatave të punës. Të gjitha llojet dhe nivelet e punësimit janë prekur në shkallë të ndryshme. Shumë punë tradicionale janë zëvendësuar me punë të reja ose janë transformuar rrënjësisht (Debono, Camilleri, Galea and Gravina, 2007). Me orientim në karrierë nënkuptojmë këshillime personale, përkrahje dhe këshillim për të ndihmuar me vendimet rreth kurseve fillestare të studimit, kurset e trajnimit profesional, arsimim dhe trajnim, zgjedhjen fillestare të punës, ndërrimin e punës ose rihyrjen në fuqinë punëtore (Kastrati&Sylejmani, 2011). Orientimi i drejtë në karrierë i nxënësve, do të jetë i mirëseardhur për të gjithë, si për nxënësit, familjen, shoqërinë, tregun e punës, etj. Shkolla siguron një mjedis ideal për të punuar për të inkurajuar pjekurinë profesionale të nxënësve dhe për t'i ndihmuar ata të vendosin për një profesion të ardhshëm (Babarović&Šverko, 2017). Orientimi në profesion filloi në fillim të shekullit të 20-të me lëvizjen e arsimit të detyrueshëm. Arsimi profesional në përgjithësi u mbështet fuqimisht në atë kohë, pasi shkollat e mesme u bënë institucione për masat që kërkonin trajnim për rolet e tyre të ardhshme industriale (Hughes&Karp, 2004).

Në shumicën e vendeve, arsimi bashkëkohor i karrierës tani kombinon dhënien e informacionit në lidhje me opsionet dhe zgjedhjet e karrierës (udhëzime në karrierë) së bashku me mbështetjen dhe këshillat personale që u ofrohen individëve kur planifikojnë rrugët e tyre të karrierës (këshillimi i karrierës) (Wong&Yuen, 2019).

Edukimi në karrierë zakonisht përfshin të mësuarit të bazuar në përvojën në lidhje me punën, në formën e përvojës së punës, vizitat në punë dhe simulimet e punës të tilla si mini-ndërmarrjet. Përvojat e tilla përfshihen për arsye eksploruese, për të ndihmuar individët të eksplorojnë fushat e punës para se të angazhohen për to. Ato paralelizohen në një kontekst arsimor nga kursi "provues", i krijuar për t'i mundësuar nxënësve të fitojnë përvojën e asaj që përfshin kursi para se të marrin një vendim të vendosur për të hyrë në të (OECD, 2004).

Mësimdhënësit, janë ata të cilët duhet të angazhohen më tepër me nxënësit, për shkak të qasjes së drejtpërdrejtë dhe informatave më të shumta për ta. Megjithatë, nuk duhet mbetur anash as familja, e sidomos, organet profesionale të shkollës: pedagogu, psikologu, të cilët, kanë kompetenca profesionale që nxënësit t'i orientojnë drejtë në karrierë. Në shumë vende, nuk bëhet orientim i drejtë, për shumë arsye, sidomos për shkak të zhvillimit të ulët, mungesës së përvojës, mungesës së organeve profesionale, etj. Informimi dhe këshillimi profesional në shkollat tona ka rëndësi të konsiderueshme dhe është më se i domosdoshëm, pavarësisht se në çfarë kushte punohet e veprohet (Dervodeli, 1997).

## **SHQYRTIMI I LITERATURËS**

Në kushtet e ndërlikueshmërisë gjithnjë e më të madhe të botës së punës, nevoja që nxënësit të marrin vendime reale në shkolla lidhur me karrierën e tyre të ardhshme është thelbësore në qoftë se dëshirojnë t'i kontribuojnë efektivisht dhe gjatë gjithë jetës vlerës ekonomike të vendit. Është e rëndësishme jo vetëm për vetë mirëqenien që të gjejnë një punë që u jep kënaqësi, por është thelbësore edhe për prosperitetin e vendit që të marrin parasysh modelin në ndryshim e sipër të industrisë dhe tregtisë, në mënyrë që sistemi arsimor t'i përgatisë nxënësit për sfidat e mundësive të punësimit në të ardhmen (Stevenson, 2014). Kur krahasohet me disa vite më parë, nxënësit sot kanë një gamë më të gjerë të mundësive

arsimore. Në të njëjtën kohë, nxënësit sot përballen me një treg pune më të ashpër, konkurrues dhe më kompleks (Debono, Camilleri, Galea and Gravina, 2007). Derisa politikatat e punësimit dhe arsimit kërkojnë të zgjerojnë zgjedhjet dhe të krijojnë sisteme që mund t'i përgjigjen nevojave të ndryshme gjatë gjithë jetës, udhëzimi në karrierë bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për politikatat publike (OECD, 2004).

Të mësuarit në lidhje me karrierën në shkollat fillore ka të bëjë me ndihmën që fëmijët të kuptojnë se kush mund të bëhen dhe duke i ndihmuar ata të zhvillojnë një ndjenjë të shëndetshme të vetvetes që do t'i mundësojë atyre të arrijnë potencialin e tyre të plotë (Niles and Harris-Bowlsbey, 2017, in Kashefpakdel, Rehill&Hughes, 2018). Ndërhyrjet e hershme mund të sjellin një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e fëmijëve dhe perceptimin e profesioneve të ndryshme, dhe të subjekteve që mundësojnë qasjen në to (Kashefpakdel, Rehill&Hughes, 2018).

Udhëzimi dhe orientimi në karrierë shikohet gjerësisht si një e mirë publike, si dhe një e mirë private. Me fjalë të tjera, përfitimet e tij potencialisht vijnë jo vetëm për marrësin individual të shërbimeve por edhe për shoqërinë e gjerë (Watts, 2013).

### **1.1. Orientimi në karrierë i nxënësve**

Me orientimin në karrierë nënkuptojmë këshillime personale, përkrahje dhe këshillim për të ndihmuar me vendimet rreth kurseve fillestare të studimit, kurset e trajnimit profesional, arsimim dhe trajnim, zgjedhjen fillestare të punës, ndërrimin e punës ose rihyrjen në fuqinë e punës (Kastrati&Sylejmani, 2011).

Orientimi në karrierë ofron një lidhje thelbësore midis arsimit dhe tregut të punës (Akkök, 2015). Orientimi për karrierën është ngulitur në kontekste të ndryshme si në shkolla, universitete, institucione trajnuese, shërbime publike të punësimit dhe vendet e punës. Aktivitetet mund të marrin forma të ndryshme, individuale ose grupore, ballë për ballë ose në distancë (Debono, Camilleri, Galea and Gravina, 2007). Orientimi në karrierë duhet të fillojë në mjedisin shkollor, pasi rrit ndërgjegjësimin e nxënësve për llojet e punëve të ndryshme dhe ndihmon në identifikimin e vendeve të punës që janë më të përshtatshme për individin

(Algadheeb, 2015). Udhëzimi për karrierën në shkollën fillore nuk ka për qëllim t'i detyrojë fëmijët të bëjnë zgjedhje të parakohshme por të shmangin mbylljen e parakohshme të opsioneve të ardhshme (Sidiropoulou-Dimakakou, Argyropoulou&Drosos, 2013).

Përkufizimi i orientimit për karrierën i miratuar në Rishikimin e Politikës së Udhëzimit të Karrierës së OECD ishte që të përshkruante shërbimet që synojnë të ndihmojnë njerëzit, të çdo moshe dhe në çdo pikë gjatë jetës së tyre, për të bërë zgjedhje arsimore, trajnuese dhe profesionale dhe për të menaxhuar karrierën e tyre (OECD, 2004).

Orientimi për karrierën i referohet ndihmës së dhënë individëve, ose grupeve të individëve, në adresimin e problemeve që lidhen me zgjedhjet e profesionit dhe jetës, duke ofruar mundësi të plota për zhvillim personal dhe kënaqësi në punë (Çinkir, 2015). Zhvillimi i karrierës nuk mund të optimizohet kur individi bën zgjedhje jashtë zonës së tij ose të saj të interesit ose nëse ai ose ajo ka një aftësi të ulët për të ndjekur një karrierë të veçantë që konsiderohet e popullarizuar (Divya, 2015).

Termi karrierë tradicionalisht është përcaktuar si profesion ose rrugë profesionale e ndjekur si detyra e jetës së dikujt (Wong&Yuen, 2019). Në vitet e fundit, termi karrierë është zgjeruar për të përfshirë të gjitha rolet e luajtura nga njerëzit gjatë gjithë jetës (Super, 1980). Ajo përcaktohet si ndërthurja dhe sekuenca e roleve të luajtura nga një rrjedhë e qëndrueshme e jetës. Këto role përfshijnë ato të fëmijës, nxënësit ose studentit, qytetarit, punëtorit, bashkëshortit, prindit, etj (Super, 1980).

Për orientimin në karrierë, një rol të rëndësishëm luajnë zhvillimi ekonomik, sistemi politik, faktorët social e kulturor, si dhe faktorë të tjerë.

Zhvillimit ekonomik mund të ndikojë jo vetëm në shtrirjen e shërbimeve udhëzuese por edhe në orientimin e tyre. Për vendet që janë ende në fazat e hershme të zhvillimit ekonomik, shërbimet e udhëzimit priren të mbizotërohen nga konsideratat e përdorimit të punës, duke kanalizuar individët në fusha të arsimit, trajnimit dhe punës që vlerësohen të nevojshme për ekonominë kombëtare (Watts, 1999).

Në sistemet demokratike, orientimi në karrierë bëhet në bazë prirjeve dhe zgjedhjeve individuale. Nëse nuk ka një farë shkalle të zgjedhjes së lirë për qytetarët, shërbimet e orientimit nuk kanë asnjë rol (Watts, 1999).

Rëndësia që i kushtohet orientimit në karrierë dhe natyra e tij ndikohen fuqimisht nga faktorët socialë dhe kulturorë. Në vendet me shtresim të fortë shoqëror individët priren të bëjnë zgjedhje brenda kufijve të përcaktuar shoqëror dhe janë në gjendje të marrin pjesën më të madhe të ndihmës që u nevojitet nga familja e tyre dhe nga rrjetet informale. Në shoqëritë me nivele relativisht të larta të lëvizshmërisë sociale, nga ana tjetër, individët kanë një fushë më të gjerë të zgjedhjes në dispozicion të tyre, dhe familjet e tyre dhe rrjetet informale kanë më pak mundësi të ofrojnë ndihmë (Watts, 1999).

### **1.1.1. Roli i shkollës në orientimin e nxënësve në karrierë**

Shkolla është faktorë me rëndësi në orientimin e drejtë të nxënësve në karrierë. Detyrë e shkollës është që përveç obligimeve të tjera, t'i përgatis të rinjtë për jetë dhe punë, gjë që nënkupton edhe përgatitjen për zgjedhjen e drejtë dhe me kohë të profesionit (Dervodeli, 1997; Kastrati&Sylejmani)). Puna edukativo-arsimore në shkolla nuk do të ishte e plotë nëse nuk përfshijnë në kuadër të punës së vet edhe orientimin në karrierë (Kastrati&Sylejmani, 2011).

Shkolla mund të organizojë një numër aktivitete të orientimit profesional që mund të drejtohen nga personeli i shkollës (p.sh. mësuesit e klasës, psikologët, pedagogët) ose bashkëpunëtorët e jashtëm. Aktivitetet e orientimit profesional, nëse kryhen si pjesë e arsimit të detyruar, kanë potencialin të prekin të gjithë nxënësit, jo vetëm ata që janë shumë të motivuar për të zhvilluar dhe drejtuar karrierën e tyre (Babarović&Šverko, 2017). Nxënësit me arritje të dobëta, zakonisht nuk kanë mundësi të zgjedhin profesionin e tyre sipas interesave të tyre, dhe pas kalimit në botën e punës shpesh bëjnë punë që nuk i plotësojnë nevojat e tyre dhe që sigurojnë të ardhura më të ulëta. Në të njëjtën kohë, adoleshentë të tillë shpesh nuk janë të interesuar për orientim në karrierë dhe nuk e kërkojnë atë vetë, pavarësisht nga fakti se ai mund të jetë shumë i dobishëm për ta (Babarović&Šverko, 2017). Prandaj, për të mirën e secilit individ dhe shoqërisë në tërësi, është e nevojshme të zhvillohen dhe organizohen ndërhyrje për

udhëzime në karrierë që do të arrinin tek këta adoleshentë. Kjo është e mundur në vetë shkollën, sepse është e mundur të përfshihen të gjithë nxënësit në ndërhyrjet e udhëzimit të karrierës në shkollë. Gjithashtu, në shkollë është e mundur të identifikohen në kohën e duhur ata që kanë shanset më të mëdha për rezultate të pafavorshme të karrierës dhe t'u kushtohet vëmendje e veçantë atyre (Babarović&Šverko, 2017).

Puna në shkollë për arsimimin, informimin dhe orientimin profesional mund të realizohet e të arrihet në shumë mënyra, si: përmes bashkëpunimit të shkollës me familjen, përmes bashkëpunimit me shërbimet profesionale të entit për punësim, me organet arsimore, me faktorët shoqërorë e politikë. Mund të realizohet duke i njohur nxënësit me llojet e profesioneve e të punëve, duke arritur te nxënësit qëndrim kritik për aftësitë e tyre vetanake, por mund ta rrihet edhe përmes zhvillimit të formave të punës në kuadër të mësimin të rregullt (Dervodeli, 1997).

Literatura në lidhje me edukimin dhe udhëzimin në karrierë pohon rezultate të jashtëzakonshme duke thënë se shkollat mund të jenë shumë përcaktuese në mësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për fazën tjetër në jetën e tyre (Moon, 2004).

### **1.1.2. Roli i bashkëpunimit të shkollës dhe familjes në orientimin profesional të nxënësve**

Ndërtimi i karrierës ofron një sfond gjithëpërfshirës teorik që ilustron rëndësinë e zhvillimit të karrierës dhe mënyrën se si do të kontribuojë në sjelljet dhe idetë e karrierës dhe profesionit. Familja është mjedisi i parë me një funksion edukativ, që siguron kujdesin dhe aftësinë e fëmijës për të funksionuar si një pjesë e shoqërisë që pranon vlerat e saj. Familja është e para që merret me edukimin e orientuar drejt vlerës. (Frýdková, 2013).

Përfshirja e familjes në orientimin në karrierë të fëmijëve të tyre, është e rëndësishme dhe e domosdoshme. Familja jetësisht është e interesuar për informimin dhe orientimin profesional të fëmijës së vet, për përparimin dhe për zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të tij (Dervodeli, 1997). Prindërit e fëmijëve, mundohen që t'i orientojnë sa më mirë fëmijët e tyre, megjithatë pa

bashkëpunimin me shkollën, dhe organet profesionale, është shumë e vështirë që fëmijët të orientohen drejtë.

Familja dhe shkolla nuk mund të punojnë veçmas. Të dy janë pjesë e proceseve shoqërore, modeleve kulturore dhe sistemeve politike dhe ligjore. Rolet e tyre në procesin e orientimit të vlerës dhe transmissioinit kulturor janë të pazëvendësueshëm (Frýdková, 2013). Një nga tiparet e rëndësishme të shkollës pedagogjike efektive është zhvillimi i bashkëpunimit me prindërit. Bashkëpunimi përfaqëson një veprim dhe negociim të përbashkët, i cili synon gjetjen e zgjidhjeve dhe një bazë të re, të përbashkët (Omerdić&Riđić, 2017).

Zakonisht prindërit komunikojnë me mësuesit ose personelin e duhur të shkollës, me komente, qëndrime ose sjellje mbështetëse ndaj vendimeve akademike dhe të karrierës. Kjo pjesë identifikon këto shqetësime të cilat janë thelbësore për adresimin e shqetësimeve akademike (Joseph, 2012).

Përfshirja e prindërve mund të hulumtohet përmes komunikimit shkollë-shtëpi, përfshirjes së prindërve në shkollë dhe përfshirjes në aktivitetet mësimore të nxënësit, vendimmarrja dhe qeverisja në shkollë ofrojnë mundësi që prindërit të përfshihen (Amatea, Smith-Adcock, & Villares, 2006). Megjithëse prindërit mund të dëshirojnë të përfshihen, ata nuk mund të dinë gjithnjë se si t'u sigurojnë mbështetjen më të mirë fëmijëve të tyre.

Mësuesit mund të rrisin përfshirjen e prindërve duke komunikuar rregullisht me ta për progresin dhe vlerësimin akademik të fëmijëve të tyre (Martínez-González et al., 2004).

Për rezultate në mësim dhe orientim të drejtë në karrierë, është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi i shkollës me familjen e nxënësve. Duke e kuptuar rëndësinë e bashkëpunimit shkollë-familje për orientimin profesional të fëmijëve, shkolla si institucion i organizuar edukativo-arsimor, duhet të gjejë mundësi dhe forma të ndryshme për të nxitur familjen për bashkëpunim (Kastrati&Sylejmani, 2011).

Bashkëpunimi i shkollës me prindër duhet të përdoret për të përmbushur mundësitë ekonomike, sociale dhe kulturore në mjedisin në të cilin jeton nxënësi. Pavarësisht nga forma organizative e bashkëpunimit midis shkollës dhe familjes,

ata duhet të mbështesin njëri-tjetrin, por gjithashtu të respektojnë ato funksione arsimore që janë specifike për secilin prej këtyre faktorëve. Prindërit sot e kuptojnë rëndësinë e ndihmës që duhet t'u ofrohet fëmijëve të tyre, dhe institucionet arsimore janë të detyruara t'i ndihmojnë ata në arsim. Sidoqoftë, përkundër kësaj, disa ndihma nuk ofrohen për shkak të ngarkesës së punës ose mungesës së njohurive të nevojshme (Stevanović, 2000; Omerdić&Ridžić, 2017).

## **METODOLOGJIA DHE METODAT**

### **2.1. Qëllimi i studimit**

Qëllim i hulumtimit është që në mënyrë empirike të gjejmë rëndësinë e orientimit të karrierë të nxënësve të shkollave nëntëvjeçare. Në kuadër të kësaj, do të mundohemi të gjejmë, angazhimin e mësimdhënësve për orientimin e drejtë të nxënësve në karrierë.

### **2.2. Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit**

#### **2.2.1. Pyetjet kërkimore**

1. A ka ndërlidhje zona ku ndodhet shkolla me orientimin e nxënësve në karrierë?
2. Cili është perceptimi i mësimdhënësve dhe nxënësve për orientimin e nxënësve në karrierë?
3. A ka ndërlidhje në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe orientimit të nxënësve në karrierë?
4. A kanë ndërlidhje trajnimet e mësimdhënësve me orientimin e drejtë të nxënësve në karrierë?

#### **2.2.2. Hipotezat e hulumtimit**

Hipoteza 1: Në shkollat e qytetit nxënësit orientohen më mirë në karrierë.

Hipoteza 2: Ka dallime në perceptimin e nxënësve dhe mësimdhënësve lidhur me orientimit të nxënësve në karrierë.

Hipoteza 3: Mësimdhënësit me përvojë më të madhe të arsimit, janë më të angazhuar për orientimin e nxënësve në karrierë.

Hipoteza 4: Mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për orientim në karrierë, iu ndihmojnë më shumë nxënësve në orientimin e drejtë në karrierë.

### 2.3. Grupi përfaqësues

Grupi përfaqësues përbëhet prej 485 pjesëmarrësve, 342 prej tyre janë nxënës dhe 143 mësimdhënës. Nga këta pjesëmarrës 245 dhe 105 mësimdhënës janë nga shkollat e fshatit dhe 97 nxënës dhe 38 mësimdhënës nga shkollat e qytetit, 214 nxënës dhe 68 mësimdhënës janë të gjinisë femërore, ndërsa 128 nxënës dhe 75 mësimdhënës, janë të gjinisë mashkullore. Në grupin e nxënësve, 7 prej tyre vijnë në mësimet në klasën e gjashtë, 31 në klasën e shtatë, 86 në klasën e tetë dhe 218 në klasën e nëntë. Në grupin e mësimdhënësve, 32 janë të moshës deri 30 vjeç, 46 janë të moshës 31-40, 32, janë të moshës 41-50, 18 mësimdhënës janë të moshës 51-60 dhe 15 mësimdhënës janë të moshës mbi 60 vjet, 13 mësimdhënës janë me shkollë të lartë, 16 kanë kryer bachelor 3 vjeçar, 87 kanë kryer bachelor 4 vjeçar, 27 kanë kryer master. Lidhur me përvojën në arsim, 25 prej tyre kanë përvojë deri 5 vite, 55 kanë përvojë 6-15 vite, 28 kanë përvojë 16-25 vite, 22 kanë përvojë 26-35 vite dhe 13 mësimdhënës mbi 35 vite kanë përvojë në arsim, 47 mësimdhënës kanë kryer trajnime për orientimin në karrierë, ndërsa 96 nuk kanë kryer trajnime të natyrës së tillë.

### 2.4. Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit, u përdorën dy pyetësorë të përgatitur enkas për këtë studim. Njëri pyetësor është i përgatitur për nxënësit, ndërsa tjetri për mësimdhënësit.

Pyetësorët përbëhen prej 2 pjesëve: Në pjesën e parë, janë paraqitur të dhënat e përgjithshme, ndërsa në pjesën e dytë, janë paraqitur 15 pyetje, që kanë të bëjnë me lidhjen e teorisë me praktikën.

Pyetësorët janë të shkallës Likert me 5 opsione, 5. Pajtohem plotësisht, 4. Pajtohem, 3. Deri diku pajtohem, 2. Nuk pajtohem dhe 1. Aspak nuk pajtohem,

mirëpo për shkaqe praktike pas realizimit të hulumtimit, është bërë reduktimi në 3 shkallë, 3. Pajtohem (shkalla 4 dhe 5), 2. Deri diku pajtohem (shkalla 3) dhe 1. Nuk pajtohem (shkalla 1 dhe 2).

#### **2.4.1. Rezultatet e besueshmërisë së instrumentit**

Për matjen e besueshmërisë së instrumentit për rëndësinë e orientimit në karrierë te nxënësit e shkollave nëntëvjeçare në Kosovë, u përdor modeli Alpha Chronach's.

Në bazë të rezultateve besueshmëria e instrumentit të nxënësve, vlera e parashikuar e besueshmërisë së instrumentit është 0.872, ndërsa vlera e besueshmërisë është 0.866. vlera e parashikuar dhe vlera e realizuar janë të përafërta dhe janë të larta, dhe tregojnë që matësi është shumë i besueshëm.

Vlera e parashikuar e besueshmërisë së instrumentit për mësimdhënës është 0.843, ndërsa vlera e realizuar është 0.844. Këto janë vlera të përafërta dhe mjaftë të larta, që janë tregues se edhe instrumenti për mësimdhënës është i besueshëm dhe i plotëson kushtet e besueshmërisë për përdorim. Në bazë të këtyre rezultateve, mund të themi se besueshmëria e instrumenteve të përdorura, është e lartë dhe instrumentet e hulumtimit i plotësojnë kushtet për përdorim.

Tabela 2.1. Besueshmëria e instrumentit të nxënësve

<b>Reliability Statistics</b>		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.872	.866	15

Tabela nr. 2.2. Besueshmëria e instrumentit të mësimdhënësve

<b>Reliability Statistics</b>		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.844	.843	15

## 2.5. Metodatat e analizës së të dhënave statistikore

Të dhënat nga hulumtimi sasior, janë analizuar përmes paketës statistikore për shkencat sociale (SPSS), ndërsa të dhënat nga hulumtimi cilësor, janë paraqitur në formë e shkurtër të qëndrimeve të pjesëmarrësve. Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentit, është përdorur Alpha Cronbach, duke marrë vlerën mbi 0.7 si vlerë që dëshmon nëse pyetëtori ka ose jo qëndrueshmëri të brendshme. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore është vendosur niveli i domethënies statistikore 0.05.

Për të bërë krahasimin e mesatareve të përvojës së mësimdhënësve dhe orientimit në karrierë të nxënësve, është përdorur Testi One Way ANOVA. T-Testi, është përdorur për të testuar ndërlidhjen e trajnimeve për orientimin në karrierë, perceptimin e mësimdhënësve dhe nxënësve, lidhur me orientimin e nxënësve në karrierë dhe orientimin e nxënësve në karrierë në bazë të vendit që ndodhet shkolla (fshat, qytet).

## REZULTATET

### 3.1. Rezultatet e nxënësve

Rreth 93.6 % e nxënësve pajtohen, 5.8 % e tyre deri diku pajtohen dhe 0.6% nuk pajtohen se Orientimi në karrierë është shumë me rëndësi për të ardhmen e tyre,  $M=4.67$  dhe  $DS=0.625$ .

Rreth 54.4 % e nxënësve pajtohen, 31.6% deri diku pajtohen dhe 14 % nuk pajtohen se Shkolla ka kuadër të mirë që më ndihmon në orientimin e tyre në karrierë,  $M=3.56$ ,  $DS=1.039$ .

Rreth 28.3 % e nxënësve pajtohen, 38% e tyre deri diku pajtohen dhe 33.7% nuk pajtohen se Mësimdhënësit kujdesen për interesat profesionale të nxënësve,  $M=2.88$ ,  $DS=1.114$ .

Rreth 39.2% e nxënësve pajtohen, 32.5% deri diku pajtohen dhe 28.3 e nxënësve nuk pajtohen se mësimdhënësi i përcjellë vazhdimisht,  $M=3.17$ ,  $DS=1.128$ .

Rreth 43% e nxënësve pajtohen, 29.5% deri diku pajtohen dhe 27.5 % e tyre nuk pajtohen se bisedojnë me mësimdhënësit për prirjet e tyre,  $M=3.2$ ,  $DS=1.223$ .

Rreth 57.9 % e nxënësve pajtohen, 21.6% e tyre deri diku pajtohen dhe 20.5 % nuk pajtohen se bisedojnë me mësimdhënësit për prirjet e tyre,  $M=3.51$ ,  $DS=1.261$ .

Rreth 55.2% e nxënësve pajtohen, 25.8% e tyre deri diku pajtohen dhe 19%, nuk pajtohen se mësimdhënësit i këshillojnë lidhur me prirjet e tyre,  $M=3.51$ ,  $DS=1.168$ .

Rreth 5.1% e nxënësve pajtohen, 28.6%, deri diku pajtohen dhe 17.3% e nxënësve nuk pajtohen se mësimdhënësit i japin informata të mjaftueshme për profesionet,  $M=3.54$ ,  $DS=1.108$ .

Rreth 40.6 % e nxënësve pajtohen, 32.5% e tyre deri diku pajtohen dhe 26.9% nuk pajtohen se mësimdhënësit i japin udhëzime për përzgjedhjen e profesionit,  $M=3.18$ ,  $DS=1.166$ .

Rreth 39.5% e nxënësve pajtohen, 35.4% e tyre deri diku pajtohen dhe 25.1% nuk pajtohen se mësimdhënësit bisedojnë me ta për drejtimet dhe profesionet,  $M=3.2$ ,  $DS=1.106$ .

Rreth 39.8% e nxënësve pajtohen, 28.9% deri diku pajtohen dhe 31.3% e tyre nuk pajtohen se mësimdhënësit i nxisin për hulumtimin e profesioneve,  $M=3.13$ ,  $DS=1.223$ .

Rreth 20.7% e nxënësve pajtohen, 21.1% e tyre deri diku pajtohen dhe 58.2% e tyre nuk pajtohen se mësimdhënësit takohen me prindërit e nxënësve për profesionin e tyre,  $M=2.41$ ,  $DS=1.312$ .

Rreth 43.9% e nxënësve pajtohen, 21.3% e tyre deri diku pajtohen dhe 34.8% nuk pajtohen se mësimdhënësit i njoftojnë prindërit e nxënësve për prirjet e tyre,  $M=3.14$ ,  $DS=1.341$ .

Rreth 62.6% e nxënësve pajtohen, 25.1% e tyre deri diku pajtohen dhe 12.3% nuk pajtohen se janë të informuar mjaftueshëm për profesionin e të ardhmes,  $M=3.82$ ,  $DS=1.120$ .

Rreth 60.8% e nxënësve pajtohen, 24.6% e tyre deri diku pajtohen dhe 14.6% nuk pajtohen se janë të orientuar drejtë në profesion,  $M=3.8$ ,  $DS=1.193$ .

Rezultatet e përgjithshme treguan se 48.9 % e nxënësve janë të informuar dhe të orientuar drejtë për profesionin e tyre, 26.8% e tyre deri diku janë të informuar dhe rreth 24.3% e nxënësve nuk janë të informuar dhe nuk konsiderojnë se janë të orientuar drejtë në karrierë,  $M=3.38$ .

Nëse analizohen rezultatet e variablave, vërehet një përqindje e madhe e nxënësve që deri diku pajtohen dhe nuk pajtohen me pohimet e paraqitura, si dhe një mesatare jo shumë e lartë. Kjo është një tregues se nxënësit nuk janë sa duhet të informuar dhe të orientuar në profesion nga mësimdhënësit e tyre.

Tabela 3.1. Rezultatet e nxënësve

Item Statistics					
	Pajtohem	Deri diku pajtohem	Nuk pajtohem	M	DS
Orientimi në karrierë është shumë me rëndësi për të ardhmen time	93.6%	5.8%	0.6%	4.67	.625
Shkolla jonë ka kuadër të mirë që më ndihmon në orientimin tim në karrierë	54.4%	31.6%	14%	3.56	1.039
Mësimdhënësit kujdesen për interesat profesionale të nxënësve	28.3%	38%	33.7%	2.88	1.114
Mësimdhënësi më përcjellë vazhdimisht	39.2%	32.5%	28.3%	3.17	1.128
Bisedoj me mësimdhënësit për prirjet e mia	43%	29.5%	27.5%	3.20	1.223

Bisedoj me mësimdhënësit për profesionin që më pëlqen	57.9%	21.6%	20.5%	3.57	1.261
Mësimdhënësit më këshillojnë lidhur me prirjet e mia	55.2%	25.8%	19%	3.51	1.168
Mësimdhënësit më japin informata të mjaftueshme për profesionet	54.1%	28.6%	17.3%	3.54	1.108
Mësimdhënësit më japin udhëzime për përzgjedhjen e profesionit	40.6%	32.5%	26.9%	3.18	1.166
Mësimdhënësit bisedojnë me mua për drejtimet dhe profesionet	39.5%	35.4%	25.1%	3.20	1.106
Mësimdhënësit më nxisin për hulumtimin e profesioneve	39.8%	28.9%	31.3%	3.13	1.223
Mësimdhënësit takohen me prindërit e mi për profesionin tim	20.7%	21.1%	58.2%	2.41	1.312
Mësimdhënësit i njoftojnë prindërit e mi për prirjet e mia	43.9%	21.3%	34.8%	3.14	1.341
Unë jam mjaftë i informuar për profesionin e ardhshëm	62.6%	25.1%	12.3%	3.82	1.120
Unë jam orientuar drejtë në profesion	60.8%	24.6%	14.6%	3.80	1.193
<b>Rezultatet e përgjithshme</b>	<b>48.9%</b>	<b>26.8%</b>	<b>24.3%</b>	<b>3.38</b>	<b>///</b>

### 3.2. Rezultatet për mësimdhënësit

Rreth 91.6% e mësimdhënëseve pajtohen dhe 8.4% e tyre deri diku pajtohen se Orientimi në karrierë është shumë me rëndësi për të ardhmen e nxënësve,  $M=4.57$ ,  $DS=0.644$ .

Rreth 46.9% e mësimeve pajtohen, 29.3% deri diku pajtohen dhe 23.8% e tyre nuk pajtohen se Shkolla ka kuadër profesional që merret me orientimin në karrierë të nxënësve,  $M=3.29$ ,  $DS=1.150$ .

Rreth 80.5% e mësimeve pajtohen, 17.4% deri diku pajtohen dhe 2.1% e mësimeve nuk pajtohen se përdorin metoda të ndryshme për identifikimin e interesave të nxënësve,  $M=4.22$ ,  $DS=0.809$ .

Rreth 77.6% e mësimeve pajtohen, 21% deri diku pajtohen dhe 1.4% e tyre nuk pajtohen se i përcjellin nxënësit vazhdimisht për prirjet,  $M=4.17$ ,  $DS=0.833$ .

Rreth 77% e mësimeve pajtohen, rreth 19.5% deri diku pajtohen dhe 3.5% e tyre nuk pajtohen se bisedojnë me mësimeve të tjerë për prirjen e nxënësve,  $M=4.12$ ,  $DS=0.892$ .

Rreth 86.7% e mësimeve pajtohen, 11.2% deri diku pajtohen dhe 2.1% e tyre nuk pajtohen se bisedojnë me nxënësit për profesionin që i pëlqen,  $M=4.37$ ,  $DS=0.793$ .

Rreth 90.3% e mësimeve pajtohen dhe 9.7% deri diku pajtohen se bisedojnë me nxënësit për prirjet që i kanë,  $M=4.39$ ,  $DS=0.661$ .

Rreth 76.3% e mësimeve pajtohen, 21.6% deri diku pajtohen dhe 2.1% e tyre nuk pajtohen se nxënësve i japin informata të mjaftueshme për profesionet,  $M=4.08$ ,  $DS=0.797$ .

Rreth 72.8% e mësimeve pajtohen, 18.2% deri diku pajtohen dhe 9% e tyre nuk pajtohen se nxënësve i japin udhëzime për përzgjedhjen e profesionit,  $M=3.89$ ,  $DS=0.935$ .

Rreth 86.7% e mësimeve pajtohen, 11.2% deri diku pajtohen dhe 2.1% nuk pajtohen, se bisedojnë me nxënësit për drejtimit dhe profesionet,  $M=4.13$ ,  $DS=0.714$ .

Rreth 71.4% e mësimeve pajtohen, 23.7% deri diku pajtohen dhe 4.9% e tyre nuk pajtohen se nxënësit i nxisin për hulumtimin e profesioneve,  $M=3.99$ ,  $DS=0.872$ .

Rreth 64.4% e mësimeve pajtohen, 23.7% deri diku pajtohen dhe 11.9% e tyre nuk pajtohen se bashkëpunojnë me prindërit e nxënësve,  $M=3.81$ ,  $DS=1.027$ .

Rreth 70% e mësimeve pajtohen, 21.6% deri diku pajtohen dhe 8.4% e tyre nuk pajtohen se i njoftojnë prindërit për prirjet e fëmijëve të tyre,  $M=3.96$ ,  $DS=0.971$ .

Rreth 49.7% e mësimeve pajtohen, 41.2% deri diku pajtohen dhe 9.1% e tyre nuk pajtohen se Nxënësit janë njaftë të informuar për profesionin e ardhshëm,  $M=3.52$ ,  $DS=0.846$ .

Rreth 42.7% e mësimeve pajtohen, 43.4% deri diku pajtohen dhe 14% e tyre nuk pajtohen se nxënësit orientohen drejtë në profesion,  $M=3.338$ ,  $Ds=0.964$ . rezultatet e përgjithshme treguan se 72.3% e mësimeve pajtohen, 21.4% e tyre deri diku pajtohen dhe 6.3 % e mësimeve nuk pajtohen se i informojnë dhe i orientojnë drejtë nxënësit në karrierë,  $M=3.99$ .

Tabela 2. Rezultatet e mësimeve

Item Statistics					
	Pajtohem	Deri diku pajtohem	Nuk pajtohem	Mea n	DS
Orientimi në karrierë është shumë me rëndësi për të ardhmen e nxënësve	91.6%	8.4%	0%	4.57	.644
Shkolla jonë ka kuadër profesional që merret me orientimin në karrierë të nxënësve	46.9%	29.3%	23.8%	3.29	1.150
Unë përdor metoda të ndryshme për identifikimin e interesave të nxënësve	80.5%	17.4%	2.1%	4.22	.809
I përcjellë nxënësit vazhdimisht për prirjet	77.6%	21%	1.4%	4.17	.833
Bisedoj me mësimeve për nxënësit e tjerë për prirjen e nxënësve	77%	19.5%	3.5%	4.12	.892

Bisedoj me nxënësit për profesionin që iu pëlqen	86.7%	11.2%	2.1%	4.37	.793
Bisedoj me nxënësit për prirjet që i kanë	90.3%	9.7%	0%	4.39	.661
Nxënësve iu jap informata të mjaftueshme për profesionet	76.3%	21.6%	2.1%	4.08	.797
Nxënësve iu jap udhëzime për përzgjedhjen e profesionit	72.8%	18.2%	9%	3.89	.935
Bisedoj me nxënësit për drejtimet dhe profesionet	86.7%	11.2%	2.1%	4.13	.714
Nxënësit i nxis për hulumtimin e profesioneve	71.4%	23.7%	4.9%	3.99	.872
Bashkëpunoj me prindërit e nxënësve	64.4%	23.7%	11.9%	3.81	1.027
I njoftoj prindërit për prirjet e fëmijëve të tyre	70%	21.6%	8.4%	3.96	.971
Nxënësit janë mjaftë të informuar për profesionin e ardhshëm	49.7%	41.2%	9.1%	3.52	.846
Nxënësit orientohen drejtë në profesion	42.7%	43.4%	14%	3.38	.964
<b>Rezultatet e përgjithshme</b>	<b>72.3%</b>	<b>21.4%</b>	<b>6.3%</b>	<b>3.99</b>	<b>////</b>

### 3.3. Krahasimi i rezultateve

Rreth 48.9 % e nxënësve dhe 72.3 % e mësimitdhënësve pajtohen, 26.8% e nxënësve dhe 21.4% e mësimitdhënësve deri diku pajtohen dhe 24.3% e nxënësve dhe 6.3 % e mësimitdhënësve nuk pajtohen se nxënësit informohen dhe orientohen drejtë në karrierë, mesatarja e rezultateve të nxënësve,  $M=3.38$ , ndërsa mesatarja e rezultateve të mësimitdhënësve,  $M=3.99$ .

Rezultatet e përgjithshme treguan se perceptimi i mësimdhënësve është më i lartë se sa perceptimi i nxënësve, lidhur me informimin dhe orientimin e nxënësve në karrierë.

Tabela 3.3. Krahasimi i rezultateve

	<b>Pajtohem</b>	<b>Deri diku pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>M</b>
<b>Rezultatet e nxënësve</b>	<b>48.9%</b>	<b>26.8%</b>	<b>24.3%</b>	<b>3.38</b>
<b>Rezultatet e mësimdhënësve</b>	<b>72.3%</b>	<b>21.4%</b>	<b>6.3%</b>	<b>3.99</b>

### 3.4. Rezultatet lidhur me hipotezat

Hipoteza alternative (HA): Në shkollat e qytetit nxënësit orientohen më mirë në karrierë.

Hipoteza zero (HO): Pavarësisht ku gjendet shkolla, orientimin e nxënësve e bëjnë njësoj.

Për të testuar hipotezën, është përdorur T-testi. Rezultatet e kombinuara të mësimdhënësve dhe nxënësve treguan se mesatarja për orientimin në karrierë në shkollat e fshatit dhe të qytetit janë shumë afër, për fshat,  $M=50.52$ , ndërsa në qytet,  $M=49.24$ ,  $p>0.05$ . Nga këto rezultate mund të konstatojmë se nuk është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela 3.4. Krahasimi i rezultateve në bazë të vendit ku gjendet shkolla

<b>Group Statistics</b>					
	<b>Shkolla gjendet</b>	<b>N</b>	<b>Mean</b>	<b>Std. Deviation</b>	<b>Std. Error Mean</b>
<b>Orientimi në karrierë</b>	<b>Fshat</b>	<b>350</b>	<b>50.52</b>	<b>11.513</b>	<b>.615</b>
	<b>Qytet</b>	<b>135</b>	<b>49.24</b>	<b>11.110</b>	<b>.956</b>

Independent Samples Test									
Orientimi në karrierë	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
	F	Sig.	t	df	Sig. (2- tailed)	Mean Differen ce	Std. Error Differen ce	95% Confidence Interval of the Difference	
								Lower	Upper
Equal variances assumed	.435	.510	1.102	483	.271	1.273	1.155	-.997	3.543
Equal variances not assumed			1.119	251.445	.264	1.273	1.137	-.967	3.512

### Hipoteza 2:

Hipoteza alternative (HA): Ka dallime në perceptimin e nxënësve dhe mësimdhënësve lidhur me orientimit të nxënësve në karrierë.

Hipoteza zero (HO): Nuk ka dallime në perceptimin e nxënësve dhe mësimdhënësve për orientimin e nxënësve në karrierë.

Rezultate empirike treguan se mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve për orientimin e nxënësve në karrierë,  $M=59.91$ , ndërsa mesatarja e rezultateve të nxënësve,  $M=46.09$ ,  $F=25.936$ ,  $p=0.000 < 0.05$ .

Në bazë të këtyre rezultateve u gjet se mësimdhënësit kanë një perceptim më të lartë se nxënësit, lidhur me orientimin në karrierë të nxënësve. Rezultati është statistikisht i rëndësishëm, çka është tregues se është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela 3.5. Testimi i hipotezës së dytë

Group Statistics					
	Grupi	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Orientimi në karrierë	Mësimdhënës	143	59.91	7.321	.612
	Nxënës	342	46.09	10.287	.556

Independent Samples Test									
Orientimi në karrierë	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
								Lower	Upper
Equal variances assumed	25.936	.000	14.592	483	.000	13.821	.947	11.960	15.682
Equal variances not assumed			16.709	368.586	.000	13.821	.827	12.195	15.448

**Hipoteza 3:**

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit me përvojë më të madhe në arsim, janë më të angazhuar për orientimin e nxënësve në karrierë.

Hipoteza zero (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe orientimit në karrierë.

Testimi i hipotezës është kryer përmes testit parametrik ANOVA një drejtimëshe. Në bazë të rezultateve vërehet se mesataren më të lartë e kanë mësimdhënësit me përvojë mbi 35 vite,  $M=62.69$ , pastaj mësimdhënësit me përvojë 26-35 vjet,  $M=61.14$ , pastaj janë mësimdhënësit me përvojë deri 5 vjet,  $M=60.4$ , mësimdhënësit me përvojë 6-15 vjet,  $M=59.2$  dhe mesataren më të ulët e kanë mësimdhënësit me përvojë 16-25 vjet,  $M=58.61$ ,  $F=1.003$ ,  $p=0.408 > 0.05$ .

Në bazë të rezultateve vërehet se dallimet në mes të mësimdhënësve me përvojë të ndryshme në orientimin në karrierë të nxënësve janë të parëndësishme statistikisht, andaj mund të konstatojmë se nuk është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela 3.6. Testimi i hipotezës së tretë

Descriptives						
Orientimi ne karrierë						
	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	95% Confidence Interval for Mean	
					Lower Bound	Upper Bound
Deri 5 vite	25	60.40	7.517	1.503	57.30	63.50
6-15 vite	55	59.20	7.422	1.001	57.19	61.21
16-25	28	58.61	7.786	1.471	55.59	61.63
26-35 vjet	22	61.14	7.305	1.557	57.90	64.38
Mbi 35 vite	13	62.69	5.073	1.407	59.63	65.76
Total	143	59.91	7.321	.612	58.70	61.12

ANOVA					
Orientimi ne karrierë					
	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	214.979	4	53.745	1.003	.408
Within Groups	7396.839	138	53.600		
Total	7611.818	142			

#### Hipoteza 4:

Hipoteza Alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për orientim në karrierë, iu ndihmojnë më shumë nxënësve në orientimin e drejtë në karrierë.

Hipoteza zero (HO): Nuk ka dallime në mes të mësimdhënësve që kanë kryer trajnime dhe atyre që nuk kanë kryer trajnime në orientimin në karrierë të nxënësve.

Testimi i hipotezës është bërë përmes testit parametrik T-test.

Rezultatet treguan se mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për orientimin në karrierë e kanë mesataren më të lartë se sa mësimdhënësit që nuk kanë kryer trajnime të natyrës së tillë. Mesatarja e rezultateve për mësimdhënësit që kanë kryer trajnime,  $M=62.06$ , ndërsa mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve që nuk kanë kryer trajnime për orientim në karrierë,  $M=58.85$ ,  $p=0.013 < 0.005$ .

Duke u bazuar në këto rezultate, mund të konstatojmë se mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për orientimin në karrierë, u ndihmojnë nxënësve më shumë në orientimin e drejtë në karrierë.

Tabela 3.7. Testimi i hipotezës së katër

Group Statistics					
	A keni kryer trajnime për orientimin në karrierë	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Orientimi ne karrierë	Po	47	62.06	7.109	1.037
	Jo	96	58.85	7.227	.738

Independent Samples Test									
Orientimi ne karrierë	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
	F	Sig.	T	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
								Lower	Upper
Equal variances assumed	.002	.964	2.508	141	.013	3.210	1.280	.680	5.740
Equal variances not assumed			2.522	92.820	.013	3.210	1.273	.683	5.737

## PËRFUNDIME

Lidhur me orientimin e nxënësve në karrierë, është marr qëndrimi i nxënësve dhe i mësimdhënësve. Nga rezultatet u gjet se rreth 48.9 % e nxënësve dhe 72.3 % e mësimdhënësve pajtohen, se nxënësit orientohen në karrierë, ndërsa 24.3% e nxënësve dhe 6.3 % e mësimdhënësve nuk pajtohen se nxënësit informohen dhe orientohen drejtë në karrierë, nga ana e mësimdhënësve.

Rezultatet e përgjithshme treguan se perceptimi i mësimdhënësve është më i lartë se sa perceptimi i nxënësve, lidhur me informimin dhe orientimin e nxënësve në karrierë.

Rezultatet empirike treguan se në shkollat e fshatit dhe shkollat e qytetit, mësimdhënësit i orientojnë nxënësit në karrierë përafërsisht njësoj, pasi që mesataret janë shumë afër dhe dallimet nuk kanë rëndësi statistikore. Pra nga rezultatet u gjet se, pavarësisht se ku i vijojnë mësimet nxënësit e shkollave nëntëvjeçare, ata orientohen përafërsisht njësoj me bashkëmoshatarët e tyre.

Kur është në pyetje vlerësimi i punës së mësimdhënësve nga vetë mësimdhënësit dhe nga nxënësit, zakonisht mësimdhënësit kanë një perceptim për punë të një niveli më të lartë se sa e perceptojnë nxënësit. Rezultatet treguan se ka dallime në perceptimin e nxënësve dhe mësimdhënësve lidhur me orientimit të nxënësve në karrierë. Dallimet janë mjaftë të larta dhe statistikisht të rëndësishme, pasi që mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve për orientimin e nxënësve në karrierë është 59.91, ndërsa mesatarja e rezultateve të nxënësve është 46.09,  $p < 0.05$ .

Ndonjëherë përvoja në arsim luan rol të rëndësishëm, pasi që mësimdhënësit me përvojë më të madhe, kanë kaluar shumë gjenerata dhe janë në gjendje që të identifikojnë prirjet e nxënësve dhe t'i orientoj drejtë në karrierë. Rezultatet treguan se mësimdhënësit që kanë më shumë përvojë, me mbi 35 vite, kanë një qasje më të mirë në orientimin në karrierë të nxënësve, me një mesatare prej 62.69, mirëpo dallimet me mësimdhënësit e tjerë, janë statistikisht të parëndësishme.

Përveç studimeve që ndjekim për të arritur një nivel të njohurive dhe dijeve shkencore, trajnimet e ndjekura pas themelimit të marrëdhënies së punës, luajnë një rol të rëndësishëm për të ngritur nivelin e njohurive apo edhe për të marr njohuri të reja lidhur e një çështje të caktuar. Rezultatet treguan se mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për orientim në karrierë, iu ndihmojnë më shumë nxënësve në orientimin e drejtë në karrierë, se sa mësimdhënësit të cilët nuk kanë kryer trajnime të tilla. Kjo u gjet përmes testit parametrik T-test dhe rezultoi se mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve që kanë kryer trajnime është 62.06,

ndërsa mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve që nuk kanë kryer trajnime për orientim në karrierë është 58.85, ndërsa  $p < 0.005$ .

Nga rezultatet e gjetura mund të rekomandojmë që mësimdhënësit të ndjekin trajnime të vlefshme dhe të cilat mund të ndihmojnë në orientimin e drejtë të nxënësve në profesionin e ardhshëm.

## LITERATURA

1. Akkök, F. (2015). Handbook for Career Guidance, EU&IBF, Georgia.
2. Algadheeb, N. A. (2015). Professional/Career Orientation, Awareness, And Their Relationship, To Locus Of Control, Journal of College Teaching&Learning, Volume 12, Number 1.
3. Amatea, E. S., Smith-Adcock, S., & Villares, E. (2006). From family deficit to family strength: Viewing families' contributions to children's learning from a family resilience perspective. Professional School Counseling, 9(3), 177-189.
4. Babarović, T.&I. Šverko (2017). Profesionalno usmjeravanje u osnovnim i srednjim školama iz perspektive učenika, (Istraživanje na temu profesionalnog usmjeravanja u osnovnim i srednjim školama iz perspektive učenika), PROGRAM ERASMUS+ (2014-2020.), Provedba inicijative Euroguidance.
5. Career Guidance and Public Policy: Bridging the Gap. (2004). OECD, Paris.
6. ÇINKIR, Ş. (2015). Students' Opinions about the Effectiveness of Guidance and Orientation Module in Turkey, Revista de cercetare și intervenție socială, 2015, vol. 49, pp. 139-155, ISSN: 1583-3410 (print), ISSN: 1584-5397 (electronic).
7. Debono, M., S. Camilleri, J. Galea and D. Gravina. (2007). Career Guidance Policy for Schools, A Career Guidance Policy and Strategy for Compulsory Schooling in Malta, Ministry of Education, Youth and Employment, ISBN: 978-99909-74-46-1.
8. Dervodeli, J. (1997). Informimi dhe orientimi profesional, "Etrupia", Prishtinë.

9. Divya, S. (2015). Orientations of High School Students and Parents towards Career Decision-making, *Indian Journal of Career and Livelihood Planning Journal of the Indian Association of Career and Livelihood Planning (IACLP)*, ISSN 2319-2313, Volume 4, Issue 1, pp 38-51.
10. Frýdková, E. (2013). School and parents Cooperation on Formation of VAlue Orientation of a Child, *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 106, 2307-2315
11. Herr, E., Cramer, S. H., & Niles, S. G. (2004). *Career Guidance and Counseling through the Life Span*. Boston, MA: Pearson Education Inc.
12. Hughes, K. L. and M. M. Karp. (2004). *School-Based Career Development: A Synthesis of the Literature*, DTI Associates&NTSC.
13. Joseph, L. L. (2012). *The impact of family influence and involvement on career development*, A dissertation submitted in partial fulfillment of the requirements for the degree of Doctor of Education in the College of Education at the University of Central Florida Orlando, Florida.
14. Kashefpakdel, E., J. Rehill and D. Hughes. (2018). *What works? Career-related learning in primary schools*, The Careers & Enterprise Company.
15. Kastrati, A.&A. Sylejmani. (2011). Rëndësia e orientimit në karrierë të nxënësve në shkollimin e mesëm, “Libri shkollor”, Prishtinë.
16. Martínez-González, R. A., Martínez, R., & Pérez, M. H. (2004). Children’s school assessment: Implications for family–school partnerships. *International Journal of Educational Research*,41(1), 24-39.
17. Mayrhofer, W., M. Meyer, M. Schiffinger and A. Schmidt. (2008). The influence of family responsibilities, career fields and gender on career success An empirical study, *Journal of Managerial Psychology*, Vol. 23 No. 3, pp. 292-323.
18. Moon, S.L. (2004). *A systematic review of recent research (1988-2003) into the impact of careers education and guidance on transitions from key stage 3 to key stage 4*. Derby: In: *Research Evidence in Education*. Centre for Guidance Studies (CeGS), University of Derby.
19. Niles, S. G., and Harris-Bowlsbey, J. (2017). *Career Development Interventions*. (5th ed.). Toronto: Pearson.

20. Omerdić, N.&M. Ridić. (2017). Level of cooperation development between family and school in elementary schools, *Metodički obzori* 12, 1, PP 54-64, UDK: 373.3.064.1.
21. Sidiropoulou-Dimakakou, D., K. Argyropoulou&N. Drosos. (2013). Career decision-making skills of primary education students in Greece: planning of career guidance activities throughout the curriculum, *Vol:7 No.1*, pp 52-72, ISSN 1726-9725.
22. Stevenson, L. (2014). Edukimi në karrierë Doracaku i mësimdhënësve *Klasat 6 dhe 7*, Prishtinw.
23. Super, D. E. (1980). A life-span, life space approach to career development. *Journal of Vocational Behavior*, 16(30), 282-298.
24. Watts, A. G. (2009). The Relationship of Career Guidance to VET, *OECD*, pp 1-16.
25. Watts, A. G. (2013). Career guidance and orientation, UNESCO-UNEVOC | Revisiting global trends in TVET
26. Watts, A.G. (1999). Careers guidance: an international perspective [En línea]. *Orientación y Sociedad*, 2. Disponible en: [http://www.fuentesmemoria.fahce.unlp.edu.ar/art\\_revistas/pr.2959/pr.2959.pdf](http://www.fuentesmemoria.fahce.unlp.edu.ar/art_revistas/pr.2959/pr.2959.pdf)
27. Watts, A.G. (2008). Career Guidance and Public Policy, *International Handbook of Career Guidance*.
28. Wong, L. P.W.&M. Yuen. (2019). Career Guidance and Counseling in Secondary Schools in Hong Kong: A Historical Overview, *Journal of Asia Pacific Counseling*, The Korean Counseling Association, Vol.9, No.1, 1-19.
29. Zelloth, H. (2009). *In Demand: Career Guidance in EU Neighbouring Countries*, European Training Foundation, Luxembourg, ISBN: 978-92-9157-5767-1.

# PROSTITUCIONI SI FORMË E TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE

MSc. Albina Berisha

International University of Struga ([a.berisha@eust.edu.mk](mailto:a.berisha@eust.edu.mk))

---

## Abstrakt

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problematik që ka ekzistuar që në kohët më hershme dhe që vazhdon të ekzistojë edhe sot duke u zhvilluar edhe më tepër. Përhapja e tij ndikohet dhe nga faktorë të ndryshëm, të cilët e bëjnë më komplekse si vepër penale. Viktima të trafikimit mund të jenë të mitur, femra, burra.

Personat që bien viktimë të trafikimit në të shumtat e rasteve janë të detyruar dhe sidomos femrat në rastet e shfrytëzimit për prostitucion detyrohen me forcë.

Shtetet në nivel ndërkombëtar kanë ndërmarrë nisma për luftimin e formave të trafikimit dhe të shfrytëzimit të qenieve njerëzore, por nuk mund të thuhet që qëllimet janë arritur sepse ende përballemi me raste të shumta. Edhe Shqipëria si një vend që origjine dhe tranziti për këto vepra penale ka kontribuar në implementimin e masave shtrënguese.

**Fjalë kyçe:** *Prostitucion, trafikim, qenie njerëzore.*

## HYRJE

Dallimi mes shfrytëzimit të prostitucionit dhe trafikimit të personave të rritur kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/të qenit i përgjegjshëm dhe vullneti i lirë për të ushtruar prostitucion.

Në bazat ligjore prostitucioni konsiderohet si vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit dhe sanksionimi është i paraparë me ligj ku ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.<sup>1</sup>

Kjo vepër penale është komplekse për nga natyra, sepse përveç ndjekjes penale të personave që e ushtrojnë prostitucionin dhe atyre të cilët ofrojnë shpërblim për të përfituar shërbimin, ndiqen penalisht dhe personat të cilët shfrytëzojnë individë për prostitucion, ata të cilët ofrojnë ambiente për qëllime të ushtrimit të prostitucionit.

## **PROSTITUCIONI, SI FENOMEN I HERSHËM**

Studiuesit e industrisë së seksit shpesh e konsiderojnë prostitucionin në rrugë si një sektor të mbi-studiuar për shkak të numrit të madh të botimeve në lidhje me të, megjithatë këto botime rrjedhin kryesisht nga fushat e shëndetit publik, drejtësisë penale dhe punës sociale dhe rrjedhimisht interpretojnë jetën e pjesëmarrësve duke u fokusuar mbi problemet me interes për ato fusha të veçanta. Kuptimi shkencor i mjedisit sociokulturor të prostitucionit në rrugë zakonisht bashkohet rreth katër temave kryesore:

1. rrugët drejt prostitucionit në rrugë;
2. çështjet shëndetësore;
3. viktimizimi i dhunshëm;
4. policia dhe drejtësia penale.

Dallimi ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit.

Dallimi kryesor mes shfrytëzimit të prostitucionit dhe trafikimit të personave të rritur kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/të qenit i përgjegjshëm dhe vullneti i lirë për të ushtruar prostitucion. E ndërsa shfrytëzimi për prostitucion në veprën penale të trafikimit bëhet duke e zhveshur viktimën nga vullneti pasi ajo detyrohet të prostitutojë nga shtrëngimi, presioni,

---

<sup>1</sup> Ligji nr.7895, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 113.

mashtrimi, apo kushtet në të cilat ndodhet, kemi veprën penale të shfrytëzimit kur femra pranon vetë me dëshirë.<sup>2</sup>

Trafikimi mund të marrë trajta të ndryshme dhe mund të përfshijë:

- shfrytëzimin seksual, përfshirë prostitucionin;
- punë apo shërbime e detyruara;
- skllavërinë, punët e shtëpisë, heqjen e lirisë me dhunë dhe praktika që lidhen me to;
- heqjen e organeve jetësore;
- kriminalitetin e detyruar me forcë, p.sh. vjedhja e personave, vjedhja e dyqaneve dhe trafikimi i drogave.<sup>3</sup>

Puna seksuale (prostitucioni) është e paligjshme në vendin tonë, ku dhe Kodi Penal parashikon një dënim që varion nga një gjobë e thjeshtë deri në tre vjet paraburgim për personat që ushtrojnë prostitucionin. Para viteve '90-të në Shqipëri nuk njihet koncepti i trafikantëve dhe i trafikimit dhe Kodi Penal parashikonte të dënohej, madje ashpër, vetëm ushtrimi i prostitucionit.<sup>4</sup>

Në një studim i bërë nga Instituti Shqiptar për Shëndetin Publik dhe Aksion Plus, Anëtar i SWAN nga Shqipëria, mbi situatën e punës seksuale në vende të Evropës Juglindore. Puna seksuale është një fenomen relativisht i ri në Shqipëri, që daton që nga fillimi i viteve nëntëdhjetë. Sipas disa raporteve nga policia dhe sistemi juridik shqiptar, pothuajse 70% e punonjëseve të seksit nga brenda vendit janë futur me forcë në këtë biznes dhe/ose me mashtrim, nëpërmjet martesave “për një jetë më të mirë” jashtë vendit. Të trafikuarat janë zakonisht vajza nga zonat rurale, nga familje me gjendje shumë të vështirë financiare.

Trafikimi menaxhohet nga grupet e krimit të organizuar, interesat e të cilave janë të përhapura në të gjithë Evropën. Edhe pse lufta e shtetit kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë më efektive vitet e fundit, pjesërisht për

---

<sup>2</sup> Sandër Simoni, Aurela Anastasi, Elizabeta Imeraj, “Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore- të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal”, fq.32

<sup>3</sup> OSCE, “Trafikimi i qenieve njerëzore- Manual për punonjësit e policisë”, fq.11

<sup>4</sup> Gjuzi Flamur, Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri, fq.15

shkak të bashkëpunimit më të mirë ndërkombëtar me organet e specializuara në vendet pritëse, trafikimi i qenieve njerëzore për punë seksuale konsiderohet ende si krimi më “fitimprurës” dhe Shqipëria u bë një nga rrugët e trafikimit nga vendet e ish-Bashkimit Sovjetik drejt Evropës Perëndimore.<sup>5</sup>

Qëllimi i ndëshkimi të trafikimit, nuk është primare ndalja e emigracionit, por mbrojtja e viktimave dhe të drejtat e tyre, si dhe ndëshkimi i trafikantëve dhe bashkëpunëtorët e tyre.<sup>6</sup>

Sipas disa të dhënave zyrtare mbi personat e trafikuar të identifikuar në Shqipëri, si edhe informacionet e tjera të marra nga aktorët antitrafik në terren, ka përfundime se Shqipëria mbetet kryesisht një vend origjine për trafikimin e burrave, grave dhe fëmijëve që i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion dhe punë të detyruar. Shumë viktima shqiptare kryesisht femra (të rritura e të mitura) i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion brenda vendit dhe në vendet fqinje e më tej, sidomos në Belgjikë, Francë, Gjermani, Irlandë, Itali, Holandë, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar (viktimat shpesh pranojnë oferta të rreme për punësim si kameriere, banakiere, kërcimtare apo këngëtare sidomos në Kosovë, Greqi dhe Maqedoni apo trafikohen me anë të mashtrimit të “të dashurit”).<sup>7</sup>

Jo të gjitha punëtorët e seksit trafikohen. Puna seksuale është një zgjedhje e lirë e atyre punonjësve të seksit që merren me biznes si pasojë e situatës shumë të vështirë ekonomike në vend.

## ZHVILLIMET E PROSTITUCIONIT NË SHQIPËRI

Trafikimi i qenieve njerëzore në Ballkan është raportuar që nga vitet 1990 dhe Shqipëria luajti një rol vendimtar që në fillim. Në këtë periudhë, rrjetet shqiptare të kontrabandës dhe trafikimit u shtuan. Në bashkëpunim me grupe të

---

<sup>5</sup> <https://web.archive.org/web/20200719222410/https://swannet.org/node/1041>

<sup>6</sup> Nasufi Dashmir, Krimi i organizuar dhe masat e veçanta hetimore për zbulimin e tij në R.M, Strugë, 2016, fq.113

<sup>7</sup> Ministria e Punëve të Brendshme, “Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 - 2017”, fq.9

tjera etnike nga rajoni, grupet kriminale shqiptare fillimisht trafikonin gratë shqiptare në industrinë e seksit në vendet e Evropës Perëndimore si Italia. Më vonë ata e zhvendosën fokusin e tyre në trafikimin e grave moldave, rumune dhe bullgare. Gratë, kryesisht nga Rumania dhe Moldavia, u sollën në Shqipëri përmes Serbisë dhe Malit të Zi ose Maqedonisë. Nga Shqipëria ata u dërguan në industrinë e seksit në Evropën Perëndimore.<sup>8</sup>

Ndryshimet që ndodhen pas rënies së regjimit komunist:

Ndryshime të mprehta socio-ekonomike ndodhën pas rënies së regjimit komunist (pas viteve 1990). Një numër i madh familjesh mbetën pa mjetet e nevojshme ekonomike, në disa raste duke vuajtur nga privimi i skajshëm ekonomik. Shtresat më të prekura ishin popullsia që jetonte në zonën rurale, familjet që migruan nga zona rurale në atë urbane dhe disa minoritete etnike (romët dhe komuniteti cigan). Shumë vajza të reja nga këto grupe të popullsisë ose bëhen shënjestër e trafikimit të qenieve njerëzore ose vendosën lirisht të ushtrojnë prostitucionin brenda ose jashtë vendit si mënyra e vetme për të marrë mbështetje ekonomike.

Një numër i madh vajzash shqiptare u trafikuan jashtë vendit (fillimisht në Greqi dhe Itali dhe më vonë në Beneluks dhe Britani të Madhe) dhe u shfrytëzuan atje si punonjëse të seksit. Nuk ka vlerësime të sakta për numrin e tyre. Burimet qeveritare pretendojnë 5,000, burimet e OJQ-ve deri në 30,000. Vajzat nga vende të tjera të Evropës Lindore (si Rumania, Moldavia, Ukraina, Bullgaria, etj.) trafikohen nëpërmjet Shqipërisë në vendet e destinacionit në Evropën Perëndimore.<sup>9</sup>

Si rezultat, prostitucioni filloi të praktikohet në vend dhe të bëhej i dukshëm. Nuk ka pasur studime shkencore për të vlerësuar numrin e punonjësve të seksit në vend, por sipas raporteve të shtypit ato mund të ndahen në katër grupe:

1. Vajzat shqiptare dhe të huaja që trafikohen jashtë vendit shfrytëzohen fillimisht si punonjëse seksi në Shqipëri. Nuk ka pasur asnjëherë përpjekje

---

<sup>8</sup> Roos de Wildt, "Post-War Prostitution Human Trafficking and Peacekeeping in Kosovo", 2019, pg.58

<sup>9</sup> <https://web.archive.org/web/20200719222410/https://swannet.org/node/1041>

për të vlerësuar numrin e tyre. Zakonisht shfrytëzimi fillon me përdhunim. Ka artikuj në shtyp që raportojnë abuzim dhe trajtim çnjerëzor të kësaj kategorie të punonjësve të seksit.

2. Punëtorët e seksit që vijnë nga shtresa të ulëta socio-ekonomike (kryesisht popullsi rome ose komuniteti cigan), të njohura ndryshe si “prostitutat e rrugës”. Prostitutat e rrugës shihen në Tiranë, të cilat ofrojnë shërbime seksuale pranë qendrës së qytetit, në rrugët kryesore dhe në zonën e Parkut Kombëtar “Liqeni”. Çmimi i shërbimeve varion nga 500 deri në 1500 lekë (3 - 12 €). Sipas informacionit të Shoqatës Shqiptare të Lezbikeve dhe Homoseksualëve, ka edhe punonjës seksi meshkuj nga popullata rome apo komuniteti cigan që ushtrojnë punë seksi në rrugë.
3. Punëtorët e seksit të nivelit të lartë që punojnë në hotele dhe motele të Tiranës dhe qyteteve të tjera të mëdha. Sipas njoftimeve të shtypit, ato janë kryesisht studente - një artikull gazete pretendonte se deri në 300 studente femra vetëm në Tiranë praktikojnë punë seksuale - vajza nga zonat rurale dhe rrethe të tjera të vendosura së fundmi në Tiranë dhe qytete të tjera të mëdha dhe punonjëse seksi të kthyer nga jashtë. Çmimet e shërbimit të tyre seksual variojnë nga 30 euro deri në disa qindra euro.
4. Punonjëse seksi në “bordello” – këto janë shpesh apartamente private që përdoren për punë seksuale. Ata veprojnë ilegalisht dhe ka artikuj të shpeshtë në media që raportojnë se policia zbulon shtëpi publike dhe arreston punonjëset e seksit. Media raportoi bastisjet e policisë në shtëpitë publike në Tiranë dhe Korçë në vitet 2002-2003. Çmimet variojnë nga 1500 (12 €) deri në disa mijëra lekë.<sup>10</sup>

Sipas statistikave të tjera të publikuara nga INSTAT:

Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Shfrytëzim prostitucioni	78	67	51	44	41

Tab.1 Të burgosur sipas veprave penale<sup>11</sup>

<sup>10</sup> <https://web.archive.org/web/20200719222410/https://swannet.org/node/1041>

<sup>11</sup> INSTAT, Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2022, fq.7

Në tabelën e mësipërme tregohen të dhëna mbi numrin e të burgosurve përgjatë viteve 2018-2022 për veprën penale “Shfrytëzim prostitucioni”, mund të vërehet një rënie vit pas viti kjo ndoshta vjen si pasojë e masave të ndërmarra nga institucionet adekuate, por ndoshta vjen dhe si pasojë që personat shfrytëzohen për prostitucion jashtë vendit gjë që e bën më të vështirë ndjekjen e tyre penale.

## **PËRPJEKTJET E BËRA NGA SHQIPËRIA PËR PARANDALIM**

Lufta kundër trafikimit të personave përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, përmirësimin e kuadrit ligjor, garantimin e integritetit, sofistikimin e proceseve hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.<sup>12</sup>

Shqipëria ka miratuar ligje dhe ka ndërmarrë hapa të ndryshëm për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo përfshin përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, krijimin e ndërgjegjësimit publik dhe trajnime për profesionistë për të njohur dhe parandaluar këtë fenomen.

Lufta kundër prostitucionit përfshin një gamë të gjerë hapa dhe strategji, dhe përfshirë Shqipërinë, disa vende ndërmarrin veprime për të adresuar këtë çështje. Disa nga hapat që mund të ketë ndërmarrë Shqipëria janë:

- Legjislacioni dhe Politikati: Miratimi dhe përdorimi i ligjeve që ndalojnë dhe ndëshkojnë prostitucionin e detyruar, trafikimin e qenieve njerëzore

---

<sup>12</sup> [Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023”.](#)

për qëllime prostitucioni, dhe veprimtarinë e tjera të lidhura me prostitucionin.

- Mbrojtja dhe Asistenca për Viktimat: Përmirësimi i mekanizmave të mbrojtjes dhe asistencës për gratë dhe vajzat që janë përfshirë në prostitucion. Kjo përfshin ofrimin e strehimit të sigurt dhe shërbimeve të tjera sociale për viktimat.
- Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi: Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik për të informuar publikun rreth rreziqeve dhe dëmeve të prostitucionit. Edukimi i publikut mund të ndikojë në ndryshimin e qëndrimeve dhe perceptimeve në lidhje me këtë çështje.
- Trajnim dhe Ndhim për Personelin Profesional: Trajnimi i personelit të shërbimeve sociale, personelit policor dhe personelit tjetër profesional për të identifikuar, trajtuar dhe ndihmuar viktimat të prostitucionit.
- Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Ndërmarrja e veprimeve të koordinuara dhe bashkëpunimi me vende të tjera për luftën kundër trafikimit dhe prostitucionit.
- Ndëshkimi i Trafikuesve dhe Përfituesve: Përdorimi i ligjeve për të ndëshkuar ata që janë përfshirë në trafikim të qenieve njerëzore dhe ata që përfitojnë nga prostitucioni i detyruar.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Efektivitetit: Vlerësimi dhe monitorimi i efektivitetit të masave të ndërmarra për të siguruar se ato kanë impaktin e dëshiruar dhe për të korigjuar politikën dhe veprimet sipas nevojave.

Në përgjithësi, lufta kundër prostitucionit kërkon një përqasje të gjerë që përfshin legjislacionin, veprimet e policisë, mbrojtjen e viktimave, edukimin publik dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Këto hapa janë pjesë e një përpjekje të përgjithshme për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe për të mbrojtur viktimat e prostitucionit.

Shqipëria ka miratuar disa ligje për të luftuar prostitucionin dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Ligjet kryesore janë:

- Ligji Nr. 10 614 datë 11.02.2014 "Për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Njerëzve dhe Mbrojtjen e Viktimave të Tij"

- Ligji Nr. 10 611 datë 11.02.2014 "Për Kthimin dhe Mbrojtjen e Personave të Identifikuar si Dëshmitarë dhe Bashkëpunëtorë në Proces".
- Ligji Nr. 10 618 datë 13.02.2014 "Për Ndikimin e Krimit dhe Trafikimin e Tij në Ekonominë Nacionale".
- Ligji Nr. 10 427 datë 29.05.2014 "Për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Njerëzve dhe Mbrojtjen e Viktimave të Tij – Ndryshimet dhe Plotësimet".
- Ligji Nr. 10 485 datë 21.12.2017 "Për Dispozitat Themelore të Shtetit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut".

Këto ligje kanë për qëllim të përmirësojnë zbatimin e ligjeve ndërkombëtare dhe për të krijuar një mjedis ligjor që mundëson identifikimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e atyre të përfshirë në trafikim dhe prostitucion. Është e rëndësishme të theksohet se detajet dhe ndryshimet e mëtejshme mund të kenë ndodhur pas datës sime të fundit të njohurive në janar 2022.

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe prostitucionit është një sfidë komplekse dhe kërkon një përgjigje të integruar nga qeveria, shoqëria civile dhe komuniteti në përgjithësi. Situata në vendin tonë ndikohet dhe nga rrethana tjera siç janë problemet ekonomike-sociale, problemet në marrëdhëniet familjare, dhuna në familje, problemet bashkëshortore, fuqizimi i krimit të organizuar etj.

Disa rekomandime të përgjithshme që mund të ndihmojnë në këtë luftë janë forcimi i ligjit dhe profesionalizimi tek punonjësit e drejtësisë, siguro që ndjekja e ligjeve aktuale të jetë e efektshme. Investimi në trajnimin e punonjësve të drejtësisë, përfshirë gjyqtarët, prokurorët dhe policinë, është thelbësore për të siguruar një zbatim të drejtë dhe efektiv të ligjeve.

Nuk duhet harruar bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i cili është thelbësor për luftën kundër trafikimit. Shkëmbimi i informacioneve dhe bashkëpunimi ndërmjet vendeve mund të ndihmojnë në kapjen dhe ndëshkimin e kriminelëve.

I rëndësishëm është dhe sigurimi i shërbimeve të mbështetjes për viktime të trafikimit. Kjo përfshin strehim, kujdes shëndetësor dhe ndihmë ligjore për ata që janë përfshirë në situata të tilla. Në këtë fushë ndihmon dhe bashkëpunimi me Organizatat Joqeveritare pasi ato kanë një rol thelbësor në luftën kundër trafikimit. Bashkëpunimi i ngushtë me to mund të sjellë informacion të vlefshëm dhe mundësi të tjera për zbatimin e strategjive efektive.

Këto janë vetëm disa nga aspektet që mund të merren në konsideratë për të forcuar luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe prostitucionit. Është e rëndësishme që rekomandimet të integrohen në një përpjekje të përbashkët dhe të koordinuar nga të gjithë aktorët përfshirë në këtë sfidë.

## REFERENCA

1. Sandër Simoni, Aurela Anastasi, Elizabeta Imeraj, “Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore- të drejtat e viktimeve të trafikimit gjatë procesit penal”.
2. OSCE, “Trafikimi i qenieve njerëzore- Manual për punonjësit e policisë”.
3. Gjuzi Flamur, Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri.
4. Ligji nr.7895, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Nasufi Dashmir, Krimi i organizuar dhe masat e veçanta hetimore për zbulimin e tij në R.M, Strugë, 2016.
6. Ministria e Punëve të Brendshme, “Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 - 2017”.
7. Roos de Wildt, “Post-War Prostitution Human Trafficking and Peacekeeping in Kosovo”.
8. INSTAT, Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale.
9. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/354>
10. <https://web.archive.org/web/20200719222410/https://swannet.org/node/1041>

# KUPTIMI I SË DREJTËS SË AUTORIT

Xhenis Sina

---

## Abstrakt

Artikulli në vazhdimësi bën një prezantim të konceptit të së drejtës së të autorit sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë. Duhet përmendur që edhe pse është një nocion i njohur për të drejtën, një rregullim i mirëfilltë do të arrijë t'i bëhet vetëm me ligjin 9380 të vitit 2005, ligji ky që do të merret si bazë analizuese edhe në këtë punim. Gjithashtu mundohemi të analizojmë elementët përbërës të kësaj të drejte që shpesh herë sjell konfuzion për t'u kuptuar edhe tek vetë profesionistët e së drejtës.

***Fjalë kyce:** pronësia intelektuale; copyright; v elementët e të drejtës autorit autor; bashkëautor; origjinaliteti; të drejta ekonomike; të drejta jopasurore; të drejta fqinje.*

## HYRJE

Zgjedha këtë fushë të re dhe moderne, sepse, së fundmi ka marrë një shtrirje dhe kuptim të plotë edhe në kontekstin shqiptar. Tanimë ne kemi një ligj të shoqëruar me akte nënligjore dhe me ngritje të strukturave të reja në mbrojtje të të drejtave të autorëve.

Vitet e fundit edhe gjykatat shqiptare kanë filluar të prekin rastet e para të vërteta, të shkeljes së të drejtave të autorit. Në një shoqëri të bazuar në parime demokratike mbrojtja e së drejtës së autorit përbën një nga drejtimitet parësore të integritetit të saj, si dhe garanton vazhdimësinë e trashëgimisë kulturore, shkencore, teknologjike në breza.

E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, si objekte të së drejtës, të rregulluara posaçësisht nga normat juridike, janë relativisht të reja, jo vetëm në

Shqipëri, por edhe në botë. Vetëm pas zbulimit të shtypit në Mesjetë, kur filluan të perhapeshin dhe të materializoheshin veprat e krijtarisë intelektuale, lindi edhe ideja e nxjerrjes së perfitimeve pasurore. (Semini-Tutulani, M, E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave (Pjesa e Posaçme), Tiranë, 2006, Scanderbeg books).

Po të analizohet si koncept e drejta e autorit, vëmë re se ajo buron nga një nocion i thjeshtë: njerëzit që krijojnë, prodhojnë ose investojnë në vepra krijuese, janë të vetmit që vendosin nëse, si dhe kur kjo veprë mund të vihet në dispozicion të publikut, me të gjitha format e përdorimit të saj. Ajo siguron bazën ekonomike për krijimin dhe shpërndarjen e veprave në fusha të ndryshme të krijtarisë si psh: në muzikë, art, letërsi, filmatografi, programacione kompjuterike, shpikje teknologjike por dhe në forma të tjera të shprehjes krijuese.

## **PRONËSIA INTELLEKTUALE: E DREJTA E AUTORIT DHE PRONËSIA INDUSTRIALE**

Pronësia intelektuale tradicionalisht ndahet në dy kategori kryesore: E Drejta e Autorit (Copyright); dhe Pronësia Industriale. Pronësia industriale në vetvete është një kategori e gjërë që përfshin disa nënkategori të tjera të cilat variojnë nga një shtet në tjetrin. Në vendin tonë nënkategoritë përbërëse të Pronësise Industriale janë: shpikjet dhe modelet e përdorimit, markat, dizenjot industriale dhe emërtimet e origjinës. Prona intelektuale është një pronë materiale, por që ka shumë karakteristika të ngjashme me pronën reale. Kështu, prona intelektuale është një aset që mund të shitet, blihet, licensohet, shkëmbehet etj, si ç' do pronë tjetër. Gjithashtu, pronari i pronës intelektuale ka të drejtë që të ndalojë veprimet e paautorizuara në lidhje me pronën e tij. Dallimi më i rëndësishëm midis pronës intelektuale dhe formave të tjera të pronave është se prona intelektuale, duke mos qënë e materializuar nuk mund të përcaktohet nëpërmjet parametrave fizikë. Ligjet për pronësinë intelektuale kanë për qëllim të mbrojnë krijuesit dhe prodhuesit e tjerë të pronës intelektuale duke u dhënë atyre të drejta të kufizuara në kohë për të kontrolluar përdorimin e pronës së tyre. Prona intelektuale mbrohet mbi baza kombëtare, prandaj objekti i mbrojtjes dhe kërkesat, që duhen përmbushur për t'u garantuar mbrojtja, variojnë nga një shtet në tjetrin.

Megjithatë, ka një prirje mbarëbotërore për harmonizimin e ligjeve kombëtare. Kjo vihet re në numrin e konsiderueshëm të marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë hartuar për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Harmonizimi i ligjeve të brendshme ka marrë një rëndësi të veçantë sidomos në ditët e sotme, kur vihet re një liberalizim i infrastrukturave dhe një globalizim i shërbimeve. Prandaj homogjeniteti i ligjeve përfaqëson mënyrën e vetme të mbrojtjes së pronësisë intelektuale, sidomos po të kemi parasysh shpejtësinë dhe pakontrollueshmërinë e qarkullimit të informacionit në Internet

## **1.2 Elementët përbërës të së drejtës së autorit:**

### **1.2.1 Objekti (vepra): origjinale dhe e prejardhur.**

Trajtimi i konceptit të veprës si objekt i rëndësishëm i të drejtës së autorit është një moment delikat, i cili sa më saktë të kuptohet dhe sqarohet aq më të lehtë e bën për juristët dhe autorët respektimin e të drejtave që burojnë nga krijimi i veprave. Ligji për të drejtën e autorit parashikon se: “Vepër është çdo krijim origjinal e intelektual i materializuar, që synon të ketë efekte në shqisat e njeriut duke marrë një formë të caktuar fizike, pavarësisht nga forma e të shprehurit”.

Nga ky përkufizim evidentohen disa elementë të të qenit vepër, si pershembull: Vepra duhet të jetë një krijim që karakterizohet nga origjinaliteti, tërësia e elementëve që e bëjnë atë të dallueshme dhe të evidentueshme nga çdo krijim e vepër tjetër e bërë deri në atë moment, pavarësisht nëse është origjinale apo e prejardhur, gjithashtu ajo është një krijim intelektual, që do të thotë mbart në vetvete një minimum vlere krijuese. Kjo do të thotë, se vepra nuk është e lidhur vetëm me subjekte që përfaqësojnë kategorinë e intelektualëve, por mund të përgatitet nga kushdo me çfarëdo niveli edukimi dhe shkollimi. Vepra duhet të jetë në formë të materializuar, në mënyrë që të shkaktojë efekte tek shqisat kryesisht pamore dhe dëgjimore të publikut, por ajo duhet të ketë një formë jo vetëm materiale, por edhe një formë fizike, pavarësisht nga forma e të shprehurit.

Një krijim që nuk fiksohet në një mbajtës fizik apo material, pavarësisht nga forma, pamja apo funksioni, nuk është vepër dhe nuk gëzon mbrojtje si e tillë.

Vepra nuk duhet te jetë e përjashtuar nga krijimet që nuk gëzojnë mbrojtje nga ligji për të drejtën e autorit. Të gjitha keto elementë të veprës duhet të ekzistojnë së bashku në mënyrë kumulative.( Në nenin 7 të ligjit Për të drejtën e autorit përcaktohet rrethi i veprave që gëzojnë mbrojtje prej tij.)

Mungesa qoftë edhe e njërit prej tyre bën që krijimi të mos jetë vepër. E drejta e autorit mbron veprat letrare, artistike, publicistike si dhe çdo krijim origjinal intelektual i kësaj natyre, pavarësisht nga forma e shprehjes së tij; çdo krijim i prejardhur në formën e një vepre apo të një koleksioni; Lutjet fetare dhe predikimet, të cilat materializohen në një mbajtës që provon ekzistencën e veprës dhe çdo krijim tjetër gojor ose me shkrim, kjo kategori hyn në grupin e parë dhe ligjvënësi e ka vënë për të treguar se krijimtaria e njerëzve, imagjinata dhe fantazia krijuese dhe artistike nuk njuh limite, prandaj rast pas rasti mund të lindin gjini të reja dhe forma veprash të shkruara të cilat nuk janë listuar në ligj, por përsëri mbeten vepra dhe gëzojnë mbrojtje së bashku me autorët e tyre nga ky ligj, sepse plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara që një krijim të jetë vepër.

Programet e kompjuterit, hyjnë në krijimet shkencore, me shkrim ose me gojë, si leksionet shkencore, ciklet e leksioneve universitare, studimet, librat e shkollës, projektet dhe dokumentacioni shkencor; Kompozimet muzikore, me shkrim ose gojore; Krijimet dramatike, dramatiko-muzikore; krijimet koreografike; pantomimat; krijimet kinematografike. Gjithashtu në këto kategori bëjnë pjesë dhe krijimet fotografike, si dhe krijimet e arteve të bukura, që mund të jenë: Piktura, vepra artistike e të shprehurit dydimensional; Skulptura; Vizatime; Skica; Gravura; Krijimet arkitekturale; Krijimet tri-dimensionale; Hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi. Krahas veprave origjinale ka edhe vepra të prejardhura. (Semini M, “E Drejta e Autorit në Shqipëri”, Tiranë, 2009, Scanderbeg books.)

Vepër e prejardhur do të quhet çdo krijim intelektual, që e ka prejardhjen nga një vepër origjinale, por duke plotësuar kushtin: pa e cënuar atë. Të tilla vepra janë ato të cilat mbështeten në një krijim të mëparshëm, por mbartin në vetvete një punë krijuese, kanë natyrë përzgjedhëse dhe sistemimi, gjë e cila bën që këto vepra të kenë statusin e njëjtë juridik si ato origjinale dhe autorët e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat e një autori të një vepre origjinale. Në veprat e prejardhura radhiten: Përkthimet, një vend të vecantë në radhën e veprave të prejardhura do të gjejnë jo vetëm përkthimet por edhe fjalorët, antologjitë, enciklopeditë etj;

Adaptimet apo përshtatjet, ku nga më të përdorurat janë ato të veprave kinematografike, muzikore, koreografike apo teatrore; Ilustrimet, të cilat ndodhen si pjesë të një vepre tjetër ekzistuese, ose janë në vetvete një vepër më vete dhe që përdoren në një vepër të re me qëllim që të shpjegohet më mirë një ide; Çdo lloj transformimi të një vepre letrare, artistike ose shkencore, që është produkt i punës krijuese të mendjes.

Ligjvënësi ndonëse ka listuar në mënyrë të shprehur lloje të ndryshme veprash të prejardhura, në këtë pikë ka lënë hapësirë për çdo lloj transformimi të mundshëm që nuk është një formë e pastër përkthimi, përmbledhje, sistemimi, përshtatje apo adoptimi në një nga këto lloje, por mund të jetë një version i përzier i tyre ose një version i ri; Gjithashtu në këtë grup bëjnë pjesë dhe përmbledhjet e veprave dhe kontributeve (përshtatjet dhe sistemet e krijimeve dhe materialeve folklorike); Baza e të dhënave është përmbledhja e veprave të pavarura, informacioneve ose materialeve të tjera të renditura në mënyrë metodike dhe sistematike të cilat arrihen individualisht me mjete elektronike apo me mjete të tjera.

Këtu nuk përfshihen programet kompjuterike që përdoren për të krijuar ose për të vënë në funksionim bazën e të dhënave të arritshme me mjete elektronike. Nga sa u tha më sipër konkludojmë se: Mbrojtja e veprave të prejardhura bëhet gjithmonë pa cenuar mbrojtjen e veprës bazë që është përdorur për krijimin e veprave të prejardhura. Siç e shohim, që të lindë e drejta e autorit, qoftë kjo për një vepër origjinale apo të prejardhur, duhet që prodhimi i krijimtarisë intelektuale të marrë formë konkrete, të materializohet në mënyrë që të përceptohet nga të tjerët pa qënë i nevojshëm publikimi i veprës.

Në nenin 9 të ligjit 9380, datë 28.04.2005, parashikohen llojet e veprave që nuk janë objekt i të drejtës së autorit dhe që nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj: Nuk janë objekt i të drejtës së autorit dhe nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj: a) Idetë, teoritë, konceptet, zbulimet dhe shpikjet në një vepër krijuese, pavarësisht nga mënyra e marrjes, e të shpjeguarit ose e të shprehurit; b) Tekstet zyrtare, të natyrës juridike, administrative, legjislativë, politike si dhe përkthimet zyrtare përkatëse; c) Simbolet zyrtare të shtetit, të organizatave dhe autoriteteve publike, si për shembull: armët, vula, flamuri, emblemat, medaljoni, shenja dalluese, medalja; d) Mjetet e pagesës; e) Lajmet dhe informacioni i shtypit; f) Të dhënat dhe faktet e thjeshta dhe shprehjet popullore.

## KUPTIMI I ORIGJINALITETIT

Sipas autores Semini, origjinaliteti nuk është në të njëjtën kohë edhe novacion (dicka e re që nuk është ndeshur më parë në qarkullimin civil, në treg apo nuk është perceptuar më parë në publik), siç ndodh tek patenta. Origjinaliteti nuk lidhet detyrimisht me cilësinë e krijimtarisë. Që të jesh autor, duhet të jesh krijues, që e dallon krijimin e tij nga çdo krijim tjetër, të bërë publik, deri në atë moment. Mjafton që vepra e krijuar të jetë e tillë, që dëshmon në vetvete punën krijuese dhe kontributin e një njeriu të caktuar.

Ps: Përsa kohë që riprodhimi ndryshon nga origjinali qoftë edhe pak, atëherë mund të thuhet se përmbushet kërkesa e origjinalitetit.

### 1.2.2 Subjektet: Autori dhe të tjerët joautorë.

Autor është personi i cili krijon veprën, në cilësinë e autorit mund të jetë personi fizik. Meqë vepra është produkt i krijimtarisë intelektuale, në logjikën e ligjit, nuk ka ndonjë kufizim në moshë për të pasur këtë cilësi, prandaj autor mund të jetë cdo personi fizik me zotësi juridike, pavarësisht nëse ka ose jo zotësi për të vepruar. Jo vetëm kaq, por autor mund të jetë edhe një person që është madhor por i është hequr apo i është kufizuar zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës. Cilësia për të qënë autor duhet dalluar nga cilësia për të ushtruar te drejtat e pronësisë për shkak të pronësisë intelektuale, ku kuptohet ka kufizime, për shkak të pasjes së zotësisë për të vepruar.

Në cilësinë e autorit të vepres mund të jenë edhe dy ose më shumë persona fizik, (rasti i bashkëautoresisë) sidomos në rastet e prodhimit të veprave audio-vizuale (këngë, filma). Në këto raste, secili nga bashkëautorët do të ketë autorësinë për pjesën krijuese në veprën e përbashkët. Është pranuar nga praktika se në raste të veçanta, në cilësinë e autorit të veprës mund të jetë edhe personi juridik (për veprat audio-vizive, autori është shtëpia kinematografike). Në përmbajtjen e ligjit konkret, nuk del saktë ky element. Megjithatë, në konceptin e të drejtës së autorit, si produkt i krijimtarisë intelektuale, autor mund të jetë vetëm personi fizik. Përrjashtimisht, flitet për raste të krijimtarisë për shkak të marrëdhënies së punës. Në qoftë se një person juridik (shoqëria kinematografike) kontraktin stafin individualisht me qëllim prodhimit të një filmi, ku në përmbajtjen e kontratës shprehet tekstualisht fakti i mbajtjes së autorësisë për personin juridik, kundrejt

pagesës individuale për secilin nga stafi, kjo në vetevete mund të merret si një « shitje » e së drejtës së autorësisë paraprakisht, për llogari të personit juridik. «Çdo raport që autori krijon me veprën e tij quhet autorësi. Autorësia është marrëdhënie juridike që lidh çdo autor me veprën, marrëdhënie që përfshin brënda saj të gjithë elementët që lidhen me objektin, subjektin dhe përmbajtjen e së drejtës së autorit. » Autorësia është marrëdhënia juridike që krijohet mes personit fizik që ka bërë punën krijuese dhe e ka materializuar atë në një formë të caktuar dhe vetë veprës që është rezultat i punës së tij. Autorësia lind në çastin e krijimit të veprës ose në çastin kur zbulohet se kush është autori i cilës vepër, pa pasur nevojë për ndonjë veprim juridik. Kontrata nuk është burim i lindjes së autorësisë, por është akti ku autori merret vesh me të tjerët për kushtet e kalimit dhe shfrytëzimit të veprës etj, por jo për lindjen e të drejtës së autorit.

### **BASHKËAUTORËT (NENI 6 I LIGJIT NR 9380, DT 28.04.2005)**

Sipas nenit 6 të ligjit vepër e përbashkët është puna krijuese e disa autorëve në bashkëpunim. Bashkautorësia rregullohet me marrëveshje ndërmjet palëve ose sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. E drejta e autorit në veprën e përbashkët u përket autorëve, të cilët me marrëveshje zgjedhin njërin prej tyre si autorin kryesor, autorët e një vepre të përbashkët e shfrytëzojnë veprën në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre. Refuzimi i marrëveshjes nga secili autor i veprës së përbashkët justifikohet në mënyrën e duhur. Autorët e një vepre të përbashkët, nën rezervën e çdo marrëveshjeje ndërmjet tyre, gëzojnë të drejtën të shfrytëzojnë veças kontributin e tyre, me kusht që të mos cenojnë shfrytëzimin e veprës si një të tërë. Në rast shfrytëzimi të veprës së krijuar në bashkëpunim, autorët, në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi në kushtet dhe masat që ata vetë kanë rënë dakord. Në rast se kjo marrëveshje nuk ekziston, shpërblimi ndahet në pjesë, sipas kontributit të secilit autor, ose në pjesë të barabarta, kur kontributi individual nuk mund të përcaktohet. Autori i veprës është pronari i parë i të drejtave vetjake jopasurore dhe pasurore që janë të lidhura me veprën e tij. Po të analizojmë ligjin Për të drejtën e Autorit vihet re përcaktimi se e drejta e pronësisë mbi një vepër i jep të drejtë autorit apo pronarit të saj që të caktojë fatin e veprës, të kalojë te drejtën e pronësisë së veprës tek një person tjetër, ta tjetërsojë atë, ta shesë, ta importojë, ta japë me qera etj.

Në këtë ligj përcaktohet se autori është pronari i të drejtës së autorit, po ashtu përcaktohet se autori është pronari i parë i veprës që ai ka krijuar, sepse pas tij mund të vijnë pronarë të tjerë, të cilëve u kalon e drejta e pronësisë mbi veprën në forma të ligjshme.

## SUBJEKTE TË TJERA TË SË DREJTËS SË AUTORIT

**Botuesi i veprës** është një tjetër subjekt i së drejtës së autorit, ai është personi që ndërmerr publikimin e një vepre, duke vënë në dispozicion të publikut kopjet e veprës, me anë të kontratës së shitjes. Lidhja e botuesit me autorin bëhet nëpërmjet kontratës së botimit, në të cilën autori i kalon botuesit, në shkëmbim të një shpërblimi, të drejtën e riprodhimit dhe shpërndarjes së veprës. Kontrata e botimit dhe të drejtat që i kanë kaluar botuesit janë të vlefshme dhe i fillojnë efektet vetëm pas regjistrimit dhe certifikimit në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe përfundojnë pas afatit për të cilin është rënë dakort në marrëveshje ose pas shpërndarjes së plotë të kopjeve të botimit.

Një subjekt tjetër është **organizuesi i shfaqjeve teatrore dhe muzikore** sepse në marrëdhënien juridike të krijuar mes autorit dhe këtij subjekti parashikohet kalimi i të drejtës së shfaqjes së veprës letrare, dramatike, koreografike ose pantonim, nga autori ose titullari i të drejtës së autorit, te një person tjetër, qoftë ky edhe organizues i shfaqjes, që ta përcjellë ose ta shfaqë atë te publiku.

**Artistët interpretues dhe ekzekutues** janë subjekte që parashikohen nga ligji për të drejtën e autorit. Të tillë janë, aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët dhe personat e tjerë që këndojnë, kërcëjnë, recitojnë, luajnë, shfaqen në drama, filma, që drejtojnë një orkestër, apo shfaqin në cdo lloj mënyre një krijim artistik ose letrar, një shfaqje të cdo lloji, duke përfshirë folklorin, varieten, cirkun dhe teatrin e kukullave.

**Punëmarrësit dhe punëdhënësit** janë subjekte të ligjit për të drejtën e autorit. Të drejtat pasurore mbi veprat e krijuara, në bazë të kontratës individuale të punës, i përkasin punëdhënësit. Të porositurit, huapërdorësit, qeramarrësit janë subjekte që lidhen me autorin, me kontratat përkatëse, me anë të të cilave u transferohen përkohësisht të drejtat pasurore, që lidhen me shfrytëzimin e veprës dhe nxjerrjen e saj në publik. Një tjetër subjekt i së drejtës së autorit është **modeli i pikturuar**, e drejta e këtij personit parashikohet për herë të parë nga

legjislacioni për të drejtën e autorit. Autori ose titullari i të drejtës mbi veprën, nuk ka të drejtë ta riprodhojë ose ta nxjerrë në publik pa autorizimin e personit të pikturuar, ose të trashigimtarëve të tij, deri 20 vjet pas vdekjes. Po ashtu, **personi që ka shërbyer si burim informacioni** për një vepër apo autorësinë e saj, është një subjekt që mbrohet dhe gëzon disa të drejta nga ligji për të drejtën e autorit. Më konkretisht, botuesi ose prodhuesi i një vepre, në bazë të kërkesës së personit, që ka shërbyer si burim informacioni e ka të ndaluar të nxjerrë në publik sekretin e burimit të informacionit, që është përdorur në vepër dhe të botojë ndonjë material të lidhur me të. Nxjerrja në publik e sekretit lejohet vetëm në bazë të marrëveshjes së personit që pranon shprehimisht një gjë të tillë ose me vendim përfundimtar të gjykatës kompetente.

## **PËRMBAJTJA: TË DREJTAT PASURORE DHE PERSONALE JOPASURORE**

A- Të drejtat ekonomike;

B- Të drejtat vetjake jopasurore;

C- Të drejtat fqinjje;

### **Të drejtat ekonomike**

Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës së vet në çdo formë dhe mënyrë.

E drejte ekskluzive, do të thotë, e drejtë personale e autorit, duke përjashtuar cilindo tjetër si titullar te se drejtes. Pra e thënë ndryshe autori shfrytëzon veprën në planin material dhe jo material. Kjo nënkupton, riprodhimin e drejtëpërdrejtë ose të tërthorë të veprës, shpërndarjes në publik të origjinalit apo kopjeve të veprës (duke e shitur, duke e dhënë me qera, duke e huapërdorur, ose dhuruar), importim dhe eksportim të kopjeve të veprës, e drejta për të përkthyer veprën, e drejta për të bërë përshtatje, sistemime e transformime të saj, e drejta për ta përcjellë në publik veprën (shfaqje skenike, recitim, koncerte, etj). Autori i një vepre letrare, artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për çdo rast dhe për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës, të lejuar apo jo nga vetë ai, edhe nëse heq dorë nga kjo e drejtë.

Me hollësisht, sipas Nenit 5 të Ligjit shqipëtar për të Drejtën e Autorit, të drejtat ekonomike të autorit janë:

- **E drejta për të riprodhuar veprën**, ose e drejta për të bërë kopje të veprës.

Çfarë janë kopjet e veprës? Në ligjin tonë nuk ka ndonjë përkufizim për to. Por sipas ligjit amerikan, keto janë objekte materiale, në të cilat fiksohet vepra nëpërmjet çfarëdolloj metode, si ato që njihen, ashtu dhe ato që do të shpiken më vonë, dhe nga të cilat vepra mund të përceptohet, riprodhohet ose të komunikohet në ndonjë mënyrë tjetër të drejtëpërdrejtë ose me ndihmën e ndonjë makine. Sigurisht që gjëja e parë, që të vjen ndërmend kur mendon për kopje të veprës, janë kopjet fizike të saj. Mirëpo në realitetin e sotëm ndeshet shumë shpesh edhe një lloj kopjeje tjetër e veprës, që është kopja elektronike, që edhe ajo, në të vërtet, është kopje materiale. Kështu p.sh, kur gjen një këngë në internet dhe e merr dhe e shkarkon atë në kompjuterin tënd, ti nuk bën gjë tjetër veçse krijon një kopje të saj. Në qoftë se ky veprim bëhet pa lejen e e autorit, atëherë kjo përbën shkelje të së drejtës së autorit dhe, pikërisht, shkelje të së drejtës së tij për të riprodhuar veprën. E njëjta gjë vlen edhe për fotografitë, tekstin dhe c’do gjë tjetër që gjendet në internet dhe që gezon mbrojtje nga e drejta e autorit. (Në botimin e Mariana Seminit “E drejta e Autorit” shtrohet pyetja? A duhet të merret leje për ribotimin e fotografisë? – Nëse një foto ribotohet me lejen e autorit por pa lejen e modelit, autorja Semini mendon se nuk ka shkelje të së drejtave të modelit të fotografuar.)

- **E drejta për ta importuar veprën me qëllim shpërndarjen në publik;** Autori mund të vendos që veprën e tij ta shesë jashtë shtetit me një çmim më të ulët sesa çmimi që ka vepra në vendin e origjinës. Për këtë arsye, blerja e këtyre veprave jashtë shtetit dhe shitja e tyre me një çmim konkurrues në vendin e origjinës mund të jetë një biznes joshës për të tretët. Pikërisht, këtë synon të pengoj Neni 5/b i Ligjit për të Drejtën e Autorit. Duke e bërë të drejtën e importimit të veprës një të drejtë ekskluzive të autorit; çdo person tjetër që e importon pa lejen e tij, kryen një shkelje të së drejtës së autorit. Sigurisht, kjo dispozitë nuk pengon blerjen e kopjeve të veprës jashtë shtetit dhe futjen e saj në vendin e origjinës kur kjo bëhet për përdorim personal. Ligji synon të pengojë vetëm ato importime që bëhen për qëllime fitimi, pra, për rishpërndarjen e veprës publikut.

- **E drejta për të përkthyer veprën;**

Edhe përkthimi i veprës, duke qenë se është një nga të drejtat e autorit, nuk mund të bëhet pa lejen e tij. Shpesh shohim në treg përkthimin e veprave të autorëve të

ndryshëm të huaj. Ato janë të paligjshme dhe mund të bëhen objekt shqyrtimi në gjykatë, nëse për to nuk është marrë më parë leja e autorit. Në përgjithësi, autorët e huaj e japin këtë pëlqim kundrejt një shume simbolike për tregje të tilla të vogla dhe të pa eksploruara si Shqipëria, prandaj është e këshillueshme për këdo që dëshiron të përkthejë një veprë të një autori të huaj, që të kërkojë më parë autorizimin e tij. Sigurisht, përkthimi i një libri të huaj dhe botimi i tij pa emrin e autorit, duke lënë të kuptohet që përkthyesi është edhe autori, është një shkelje shumë e rëndë. Një veprim i tillë do të përbënte jo vetëm shkelje civile, në bazë të Nenit 5/c të Ligjit për të Drejtën e Autorit, por edhe kundravajtje penale në bazë të Nenit 148 të kodit penal. Përkthimet quhen “vepra të prejdardhura” dhe përkthyesi gëzon të drejtën e autorit për përkthimin e tij, siç u sqarua më lart.

- **Përshtatje, sistemime, transformime të veprës;**

Nga përshtatja, sistemimi apo transformimi që mund t’i bëhet një veprë rezulton një veprë e re, e prejdardhur nga e para, që mbrohet edhe ajo me të drejtë autori për ata elemente që janë origjinale në krahasim me veprën e parë. E drejta për të krijuar këto lloj veprash të prejdardhura i takon autorit të veprës fillestare. Vetëm ai ka të drejtë të autorizoj të tjerët të kryejnë këto veprime. Bërja e përshtatjeve, sistemimeve, transformimeve janë disa nga mënyrat kryesore të eksplorimit të veprës fillestare dhe që i sjellin perfitime të konsiderueshme autorit të veprës fillestare. Kështu, shpesh nga romanet krijohen filma, apo pjesët teatrale. E drejta e autorit në këto vepra të prejdardhura i takon producentit, ndërsa autori i romanit vazhdon të ruajë të drejtën e autorit mbi romanin e vet. Kjo do të thotë se ai mund të autorizojë persona të tjerë të krijojnë një film tjetër bazuar mbi veprën e tij. Producentët e dy filmave do vazhdojnë të ruajnë secili të drejtën e autorit tek filmat e vet, por kjo e drejtë do të shtrihet vetëm tek elementet origjinale që ka secili film, dhe jo tek ata elemente që janë pjesë të romanit. P.sh., elemente të tilla origjinale mund të jenë skenat e xhirimit, lidhja e tyre me njëra-tjetrën, kostumet, etj.

- **E drejta e shfaqjes ose e deklarimit të veprës para publikut;**

Edhe për termat “shfaqje” dhe “deklarim” ligji nuk jep ndonjë përkufizim, por, duke e parë këtë të drejtë në harmoni me të drejtat e tjera ekonomike që parashikon Neni 5, që ta shfaqësh veprën, do të thotë që të tregosh një kopje të saj në publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet proceseve dhe aparaturave

(p.sh. rasti i filmave që shfaqen në kinema). Shfaqja, ose deklarimi i veprës para publikut, në këtë kuptim, do të thotë ofrimi i kopjeve fizike të veprës për shitje, dhënie me qera, ose forme tjetër shpërndarjeje, si dhe ekzekutimi ose shfaqja e një vepre para publikut. Në ligj nuk jepet ndonjë përkufizim se çfarë e përbën "publikun", sa njerëz duhen për të përcaktuar nëse vepra është shfaqur në publik. Kjo është një çështje që do të mbetet në vlerësimin e gjykatës. Të drejtën e dhënies me qera ose hua të veprave e kanë autorët e veprave audiovizuale, programeve të kompjuterit, bankave të informacionit apo veprave të tjera që lexohen në aparatura, prandaj vidiotekat që japin me qera filma apo fonograme, duhet ta bëjnë këtë vetëm me autorizimin e këtyre veprave.

### **E drejta e komunikimit të veprës për publikun me anë të transmetimit ose ritransmetimit;**

Meqenëse transmetimi me kabëll ose mjete të tjera mbulohet nga një e drejtë tjetër, që vjen më poshtë në nënparagrafin që vijon, mendoj se drejta e komunikimit të veprës për publikun me anë të trasmetimit ose ritrasmetimit përfshin vetëm trasmetimin dhe ritrasmetimin jokabllor, që i bëhet një vepre nga organizatat transmetuse si radiot dhe televizionet.

### **E drejta e transmetimit të veprës për publikun me kablo a mjet tjetër;**

Kjo e drejtë përfshin transmetimin, por jo atë që bëhet nga radiotelevizionet, në një publik që nuk është prezent në vendin ku fillon komunikimi. Disa shembuj për këtë janë televizioni kabllor dhe trasmetimet në rrjet, si p.sh. transmetimi në internet.

### **B- Të drejtat vetjake jopasurore.**

Nocioni i të drejtave morale është një nocion që ka lindur në vendet e së drejtës civile ose civil laë. Shtetet e ndryshme variojnë nga njëri-tjetri përsa i përket mënyrës sesi ato i përkufizojnë dhe i mbrojnë të drejtat morale. Franca mund të quhet vendi, që i njeh në mënyrën më bujare këto të drejta. Ndërsa në vendet e common laë, në përgjithësi ka pasur një ngurim për njohjen e të drejtave morale. Kështu, SHBA vazhdoi të mos e njihte me ligjin federal të së drejtës së autorit, të drejtat morale, megjithëse u bë anëtare e Konventës së Bernes 1988. SHBA pretendonte se të drejtat morale atje mbroheshin nëpërmjet ligjeve të reja si p.sh. ligji për shpifjet, për konkurrencën e pandershme, për kontratat, për të drejtën e jetës private. Mirëpo, kishte disa të drejta morale, si e drejta e integritetit të

veprës, që nuk arrinin të mbroheshin me ligjet e mësipërme. Pikërisht, për të realizuar mbrojtjen edhe të këtyre të drejtave, në vitin 1990 SHBA nxorri Aktin për të Drejtat e Artistëve të Veprave Vizive, i cili ka hyrë në fuqi me 1 qershor 1991. Nëpërmjet këtij Akti Shtetet e Bashkuara të Amerikës njohin të drejtat morale vetëm për autorët e veprave të artit viziv ku futen pikturat, skulpturat dhe printimet si litografet dhe veprat e gdhendura, të cilat janë të pakta në numër. Franca, si vendi që i bën njohjen dhe mbrojtjen më të madhe të drejtave morale, i përcakton ato si më poshtë:

1) *E drejta e bërjes publike të veprës*: Është e drejta personale e artistit për të vendosur kur, si dhe nëse do ta bëjë publike veprën. Kjo e drejtë ka precedencë edhe mbi vetë detyrimet ekonomike kontraktuale të artistit. Një çështje e famshme lidhur me këtë të drejtë është çështja James a. McNeill Ëhistler dhe Lordit Eden. Ëhistler, një artist amerikan, qe jetoi në Paris në vitet 1855 deri 1859. Ndërkohë që ishte atje, ai lidhi një kontratë me Lordi Anglez Eden për t'i bërë një portret gruas së tij, Zonjes Eden. Ëhistler u pagua për ta bërë portretin dhe, në fakt, e përfundoi. Për arsye që nuk dihen mirë, Ëhistler vendosi që mos t'ia jepte veprën Lordit Eden. Eden i kërkoi gjykatës franceze që, në bazë të kontratës, t'i kërkonte Ëhistlerit dorëzimin e veprës. Gjykata e Kasacionit refuzoi të detyronte Ëhistler të dorëzonte veprën. Ajo u shpreh se kontrata nëpërmjet së cilës një piktor angazhohet të bëjë një pikturë kundrejt një cmimi të fiksuar në kontratë përbën një kontratë të vecantë nëpërmjet së cilës vepra i kalon porositësit, vetëm kur artisti ia dorëzon atij dhe ai e pranon.

2) *E drejta për t'u njohur si autor i veprës*: Kjo i jep artistit të drejtën të kërkojë kreditë për punën e tij në mënyrë që të tjerët ta dinë se ai është autori i asaj vepre. Kjo e drejte njihet si një nga të drejtat morale pothuajse nga të gjitha vëndet që i mbrojnë të drejtat morale. E drejta për t'u njohur si autor i veprës njihet edhe në Shqipëri, por ligji francez shkon shumë larg duke i lejuar artistët të kontrollojë natyrën e kreditit që i jepet (kreditu nuk mund të ndryshohet nga publikuesi pa pëlqimin e artistit). Gjithashtu, në France, si pjesë e kësaj të drejte është edhe e drejta për të mbetur anonim dhe e drejta për të perdorur pseudonim.

3) *E drejta e integritetit*: Në bazë të kësaj të drejte, autori ka të drejtë të ndalojë çdo modifikim që mund t'i bëhet veprës së tij nga të tretët. Menjëherë, lind pyetja "Për çfarë modifikimi bëhet fjalë?" Në disa shtete, sipas kësaj të drejte, ndalohen vetëm ato modifikime që çenojnë nderin dhe reputacionin e artistit. Per ta

përcaktuar këtë, gjykata mund të thërrasë ekspertë. Por, në Francë, kjo e drejtë është më strikte, sepse këtu ndalohet çdo modifikim që vetë autori e vlerëson se cënon nderin dhe reputacionin e tij. Pra, sipas ligjit francez, mbizotëron gjykimi subjektiv i autorit. Për të kufizuar deri diku abuzimet që autori mund të bëjë me këtë të drejtë, gjykatat franceze kërkojnë që ky gjykim të jetë me mirëbesim dhe të mos jetë abuziv. E drejta e autorit për të ndaluar modifikimet shtrihet jo vetëm tek vepra e tij por edhe tek mënyra dhe konteksti në të cilën paraqitet vepra. P.sh. e drejta morale e artistit për të kontrolluar cilësinë e një fotografie shtrihet edhe tek cilësia e letrës që përdoret për fotografi, sepse letra e papërshtatshme mund të bëjë që të ndryshojnë ngjyrat e pikturës.

4) *E drejta e nxjerrjes nga qarkullimi*: Kjo e drejtë mund të shihet si e kundërta e të drejtës për bërjen publike të veprës. Në bazë të kësaj të drejte, autorit i lejohet që, edhe pasi vepra është hedhur në qarkullim, ai t'a ndryshojë, korrigjojë dhe madje t'a tërheqë veprën nga qarkullimi për çfarëdo arsyeje. Por, gjithsesi, artisti nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pa dëmshpërblyer më parë pronarin e veprës për dëmet që nxjerrja nga qarkullimi mund të shkaktoj, në qoftë se pas ndryshimit apo korrigjimit artisti dëshiron që ta shesë përsëri veprën, vepra duhet t'i ofrohet fillimisht pronarit të mëparshëm. Të drejtat morale të autorit njihen edhe nga legjislacioni shqiptar. Përmbajtja e të drejtës së autorit përfshin në vetvete dy grupime të mëdha të rëndësishme, që janë; të drejtat vetjake jopasurore ose siç quhen ndryshe të drejtat morale dhe të drejtat pasurore ose sic quhen ndryshe të drejtat ekonomike. Sipas Ligjit tonë për të Drejtën e Autorit, autori ka këto të drejta vetjake jopasurore (morale):

*-Të vendosë emrin e tij në vepër apo në çdo kopje të saj;*

*-Të kërkojë që t'i njihet cilësimi i tij, si autor i veprës;*

*-Të përcaktojë në emrin e kujt do të prezantohet vepra e tij tek publiku;*

*-E drejta për të mbetur anonim ose për të përdorur pseudonim.*

*-E drejta për të kundërshtuar ç' do lloj shtrembërimi, heqje a ndryshim dhe ç' do veprim tjetër përçmues ndaj veprës që do të cënonte nderin dhe emrin e autorit.*

*-E drejta për të kundërshtuar bashkëautorësinë e vendosur në mënyrë arbitrare nga të tjerët.*

*-E drejta të vendosë nëse vepra e tij do t'i paraqitet publikut, kur do ti paraqitet, në c' mënyrë do të bëhet-kjo gjë, si dhe vendin seku do të prezantohet vepra për herë të parë*

*-E drejta vendosjes e tërheqjes se veprës nga publikimi apo e ndryshimit shkëputjes, ndarjes apo shkatërrimit të saj pjesërisht ose krejtësisht;*

*-E drejta për të tërhequr lejen e shfrytëzimit të veprës duke mosçenuar të drejtat dhe interesat ligjore të palëve të interesuara;*

Pra, sipas kësaj të drejte ndalohen ato modifikime që çenojnë nderin dhe reputacionin e autorit. Po kush është ai që përcakton se një modifikim çënon nderin dhe reputacionin e një autori? Gjykatat shqiptare, për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje do të mbështeten në mendimin e ekspertit dhe jo thjeshtë në mendimin e autorit, pra siç është rasti në Francë. E drejta e mësipërme, në raste të caktuara mund të jetë shumë problematike. Kjo mund të ndodhë sidomos në rastet kur transferohet e drejta ekonomike e përgatitjes së veprave të prejardhura. Kështu p.sh. një libër, nëpërmjet transferimit të kësaj të drejte ekonomike mund të bëhet skenar filmi. Mirëpo ç'ndodh sikur në këtë skenar të jenë bërë ndryshime që autori mund ti vlerësoj se ka modifikuar veprën në një mënyre që e ulë reputacionin e tij. Në këtë rast, siç u tha më lartë, do të jetë gjykata ajo, e cila nëpërmjet mendimit të ekspertit do ta vërtetojë një gjë të tillë, në qoftë se kjo do të rezultojë e vërtetë atëherë autori do të ketë të drejtë ta ndaloj prodhimin e skenarit. Ose, mund të kemi rastin e fotografisë së një pikturë që u përmend më sipër. Megjithëse mund të ketë lejuar përgatitjen e fotografisë, si një vepër të prejardhur, piktori, prapëseprapë, mund të pretendojë se fotografia duke qenë e një niveli të dobët çënon nderin dhe reputacionin e tij, për këtë arsye, mund ta kundërshtojë atë në bazë të të drejtës morale të mësipërme.

### **Karakteristika dalluese të të drejtave vetjake jopasurore:**

-Të drejtat vetjake jopasurore janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me autorin, kur ai është gjallë, por edhe pas vdekjes së tij. Vetëm një pjesë e tyre kalojnë me trashëgimi tek trashëgimtarët e autorit. Kështu e drejta e emrit, e paraqitjes në publik me pseudonim, e bashkëautorësisë, janë të drejta vetjake jopasurore që nuk kalojnë me trashëgimi. Ato janë të lidhura me konceptin e autorit, pavarësisht nëse ai është gjallë, ka vdekur apo veprës i ka skaduar edhe afati i mbrojtjes ligjore të saj. Ndërsa të drejta të tilla jopasurore që përbidhen me konceptin e shmangies së shkeljes së një të drejte personale jopasurore, i kalojnë trashëgimtarëve. Si të tilla mund të përmendim: e drejta e kundërshtimit të bashkëautorësisë, e drejta e shtrembërimit të emrit, etj ... Në vitet e para të

trajtimit të shkeljeve nga ana e praktikës gjyqësore shqiptare, pas viteve 90', ishte rasti i botimit pa autorizimin e trashëgimtarëve të ditarit të Ismail Qemalit (Semini.M, "E drejta e autorit në Shqipëri", Scanderbeg, 2009, Tiranë), nga një shtëpi botuese. Ditari do të shfaqej për të parën herë në publik dhe do të trajtonte ngjarje historike por edhe personazhe historike sa në planin njerëzor po aq dhe personal. Trashëgimtarët e autorit kërkuan sigurimin e padisë dhe bllokimin e shitjeve, pasi edhe vetë autori e kishte konceptuar atë si një vepër personale. Padia u pranua në mënyrë të plotë dhe u ekzekutua plotësisht.

- Autori nuk mund të heqë dorë nga të drejtat vetjake jopasurore;
- Të drejtat vetjake jopasurore nuk mund të tjetërsohen;
- Pas vdekjes së autorit ushtrimi i të drejtave të nenit 10 të ligjit 9380 kalon me anë të trashëgimisë në përputhje me legjislacionin civil dhe dispozitat e ligjit.
- Marrëveshjet për transferimin e të drejtave morale janë të pavlefshme.

Kjo rezulton nga paragrafi i dytë i Nenit 29 që parashikon "Të drejtat morale nuk kalohen midis të gjallëve, por mund të kalohen me dispozitat e trashëgimisë ligjore ose me testament". Gjithashtu, ligjet e shumicës së vendeve ku njihen të drejtat morale parashikojnë se nga të drejtat morale nuk mund të hiqet dorë, përveç në disa kushte të caktuara. Kështu në Francë, çdo marrëveshje, nëpërmjet të cilës autori transferon ose heq dorë nga e drejta e autorësisë, ose e drejta e integritetit, është e pavlefshme. Ndërsa transferimi i të drejtave morale është i pamundur në të gjitha shtetet që i njohin këto të drejta, heqja dorë nga to përbën një problem më të ndërlikuar. Një ndalesë absolute për heqjen dorë nga këto të drejta në fakt do të përbënte një barrë për vetë autorin dhe do të pengonte te tretët të hynin në marrëveshje me të. Prandaj edhe në Francë p.sh., marrëveshjet për heqjen dorë nga të drejtat morale janë të lejueshme, por ama për një kohë, vend dhe qëllim të caktuar. Megjithatë, njohja shumë e madhe që u bëhet në Francë të drejtave morale shumë shpesh ka penguar aplikimin e kontratave për heqjen dorë nga këto të drejta. Kështu në qoftë së autori francez i një libri heq dorë nga të drejtat morale dhe ia transferon kompanisë amerikane të drejtën për të bërë një film mbi bazën e librit të tij, por më vonë gjykon se filmi përbën shkelje të së drejtës së tij morale të integritetit të veprës kur filmi të shfaqet në Francë, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj të drejte në gjykatat franceze dhe të fitoj duke penguar në këtë mënyrë shfaqjen e filmit në Francë. Sipas gjykatave franceze është kundër

politikës publike që kontratat e bëra në bazë të ligjit të huaj të shkelin të drejtat morale të autorit në Francë. Një qëndrim i tillë i gjykatave Franceze e ka bërë të vështirë eksplorimin e veprave që do të shpërndahen apo shfaqen në Francë. Duhet sqaruar se mosnjohja e kontratave, me të cilat hiqet dorë nga të drejtat morale, mund të ndodh në Francë, vetëm atëherë, kur vepra vjen për tu shfaqur në Francë. Shfaqja e këtyre veprave në vende të tjera, që mund ti njohin këto kontrata, apo vende, ku nuk njihen të drejtat morale, si p.sh. në SHBA, është plotësisht e mundur. Në Shqipëri akoma nuk janë paraqitur raste të tilla dhe nuk dihet nëse gjykatat shqiptare do të njohin kontratat me të cilat autori heq dorë nga të drejtat e tij morale. Të drejtat morale ruhen gjatë gjithë jetës së autorit dhe pas vdekjes se tij. Pas vdekjes këto të drejta i ushtrojnë trashëgimtarët e tij. Po në qoftë se ka kaluar një kohë e gjatë sa trashëgimtarët nuk dihen, kush do ti mbrojë këto të drejta? Në Francë, në raste të tilla, është Ministria e Kulturës ajo që ka të drejtë ti mbrojë këto të drejta në interes të pasurive kulturore kombëtare; ne nje te ardhme te aferte e njejta zgjidhje mund te jepet per rastin ne fjale dhe nga gjykatat shqiptare.

### C. Të Drejtat Fqinje

Përveç të drejtave të autorit, në ligjin shqiptar, ashtu sikurse dhe në shumicën e legjislacioneve të vendeve kontinentale njihen edhe disa të drejta të tjera që kanë lidhje me të drejtën e autorit dhe që quhen “të drejta fqinje”. Të drejtat fqinje u jepen atyre që luajnë rol në komunikimin e veprës te publiku, por që nuk i krijojnë veprat vetë. Të tillë janë ekzekutuesit, ku futen aktorët, këngëtarët, muzikantët, kërcimtarët etj; prodhuesit e fonogrameve dhe operatorët radioteleviziv. Për mbrojtjen e subjekteve të mësipërme në Ligjin shqiptar për të Drejtën e Autorit është parashikuar një kre i posaçëm, Kreu VII. Aty janë detajuar të drejtat ekonomike që gëzojnë ekzekutuesit, të drejtat ekonomike që gëzojnë prodhuesit e fonogrameve dhe të drejtat ekonomike që gëzojnë operatorët radioteleviziv. Sipas *Nenit 34* të Ligjit, ekzekutuesit kanë këto të drejta ekonomike:

- *-Të drejtën të autorizojnë trasmetimin e programeve të tyre.*<sup>7/1</sup>
- *-Të drejtën të autorizojnë dhënien në publik të shfaqjes së tyre.*<sup>7/2</sup>
- *-Të drejtën të autorizojë regjistrimin e shfaqjes.*<sup>7/3</sup>
- *-Të drejtën të ndalojë riprodhimin e regjistrimit të shfaqjes së tyre.*<sup>7/4</sup>

E drejta e riprodhimit të regjistrimit është një e drejtë e ndryshme nga e drejta e transmetimit. Gjithashtu, Traktati u njeh ekzekutuesve edhe disa të drejta të tjera ekonomike, që aktualisht, Ligji ynë për të Drejtën e Autorit nuk i parashikon. Këto janë: e drejta e shpërndarjes në publik nëpërmjet shitjes apo ndonje mënyre tjetër kalimi të pronësisë, të origjinalit të kopjeve të shfaqjeve të tyre të fiksuara në fonograme, e drejta e dhënies me qera të origjinalit apo kopjeve të shfaqjeve të tyre të fiksuara në fonograme dhe e drejta për të autorizuar vënien në dispozicion për publikun të shfaqjeve të tyre që janë fiksuar në fonograme, nëpërmjet aparaturave me kabëll ose jo, në atë menyrë që publiku të ketë akses në to, në vendin dhe në kohën që i pëlqen atij. Por po ti referohemi nenit 5367 të ligjit tonë do të vëmë re se sanksionohen të drejtat jopasurore të Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues të cilët janë: a) E drejta të kenë emrat e tyre të permendur, kur shfaqjet e tyre shpërndahen, transmetohen ose fiksohen në mënyrë të pashqitëshme në ndonjë regjistrim fonografik, film kinematografik ose mbajtës tjetër të veprave të tjera audiovizuale ose në çdo prodhim tjetër të ngjashëm; b) E drejta për të mbrojtur respektin e cilësisë së shfaqjes dhe të kundërshtojnë çdo ndryshim, fallsifikim ose ndryshim thelbësor; c) E drejta për të kundërshtuar çdo shpërndarje, transmetim ose riprodhim të shfaqjeve të tyre, të cilat mund të çenojnë nderin ose reputacionin e tyre. Të drejtat e interpretuesve përfundojnë 50 vjet pas datës së shfaqjes. Megjithatë, nëse një shfaqje është vënë ligjërisht në dispozicion të publikut ose i është përcjellë ligjërisht publikut brenda kësaj periudhe, të drejtat do të përfundojnë 50 vjet që nga data e publikimit të parë ose e shfaqjes së parë në publik, cilido qoftë më i hershmi. Të drejtat e mësipërme nuk përbëjnë objekt të dorëheqjes nga ana e titullarëve të tyre. Pas vdekjes së artistit interpretues ose ekzekutues, ushtrimi i të drejtaave kalon me trashëgimi, sipas Kodit Civil, për një kohëzgjatje të përcaktuar në ligj. Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve. Fonogram është regjistrimi i tingujve të një shfaqjeje, ose e tingujve të tjerë që është i ndryshëm nga regjistrimi që bëhet në veprat kinematografike ose veprat e tjera audiovizuale. Prodhues fonogrami është personi fizik ose juridik, i cili merr iniciativën dhe ka përgjegjësinë për regjistrimin e parë të tingujve të një shfaqjeje ose tingujve të tjerë. Në këtë kuptim, prodhues fonogramesh janë të gjitha shtepitë diskografike. Edhe prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtat e tyre (të drejtat fqinje) që janë të ndara nga të drejtat e autorëve të veprës muzikore që regjistrohet, si dhe të ekzekutuesve të saj.

7/1- E drejta e trasmetimit nuk përfshin të drejtën e regjistrimit të shfaqjes dhe anasjelltas; E drejta për regjistrimin e shfaqjes nuk nënkupton të drejtën e trasmetimit të shfaqjes. Këto janë dy të drejta të ndryshme. E drejta e trasmetimit i takon vetëm organizatës që është autorizuar për këtë qëllim nga ekzekutuesit. Kjo organizatë nuk mund t'ua trasferojë këtë të drejtë organizatave të tjera transmetuese, pa pëlqimin e ekzekutuesve.

7/2- E drejta e shfaqjes në publik nuk çenohet kur bëhet një regjistrim I autorizuar I programit apo I një trasmetimi të autorizuar të shfaqjes. Sigurisht, meqenëse trasmetimi e përfshin shfaqjen në publik të programit është normale që ai që është autorizuar të bëjë trasmetimin, automatikisht ka dhe të drejtën e shfaqjes në publik të veprës.

7/3- E drejta e regjistrimit të shfaqjes, sic u tha edhe më lartë nuk përfshin të drejtën e trasmetimit të saj. Po ashtu kjo e drejtë nuk përfshin të drejtën e riprodhimit të regjistrimit. E drejta e riprodhimit të regjistrimit është një e drejtë e ndryshme nga e drejta e regjistrimit. Për riprodhimin e regjistrimit duhet një autorizim tjetër nga ekzekutuesi.

7/4- kur: riprodhimi bëhet pa marrë më parë lejen e ekzekutuesve; bëhet për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ekzekutuesit kanë dhënë autorizimin; kur vetë regjistrimi që është riprodhuar ka qënë I paautorizuar; kur, megjithëse për regjistrimin e shfaqjes nuk ka qënë nevoja për autorizimin e ekzekutuesve, për riprodhimin duhet autorizim, dhe ky nuk është marrë.

Të drejtat e tyre shtrihen vetëm tek mënyra e regjistrimit dhe jo tek muzika, ku të drejtën e autorit vazhdon ta mbajë kompozitori, apo teksti i këngës, ku të drejtën e autorit vazhdon ta mbajë autori i tekstit. Meqenëse prodhuesit e fonogrameve janë përdorues si të pjesëve muzikore, ashtu edhe të teksteve, ata, si çdo përdorues tjetër, duhet të marrin paraprakisht autorizimin e autorëve përkatës. Ky autorizim jepet zakonisht përkundrejt një shpërblimi që përcaktohet me marrëveshje ndërmjet prodhuesit të fonogramit dhe autorit të muzikës dhe tekstit, në qoftë se ka edhe tekst shoqëruar. Prodhuesit e fonogrameve përdorin artistët ekzekutues për krijimin e fonogramit, të cilët duhen paguar. Këta të fundit, kundrejt shpërblimit që caktohet me marrëveshjen midis tyre, i kalojnë prodhuesit të fonogramit të drejtat e tyre ekonomike. Prodhuesit e fonogramit e nxjerrin shpërblimin për punën e tyre dhe

shpërblimin për ekzekutuesit nga shitja e fonogramit. Neni 36 i Ligjit për të Drejtën e Autorit bën fjalë për përdorimin dytësor të fonogrameve, siç është transmetimi nga operatorët radiotelevizivë ose komunikimi për publikun. Në këtë rast, përdoruesi, d.m.th., ai që bën transmetimin ose komunikimin, sipas marrëveshjes, i paguan prodhuesit një shpërblim për ekzekutuesit dhe për vetë atë. Kur ndërmjet ekzekutuesve dhe prodhuesit të fonogramit nuk ka marrëveshje për këtë qëllim, atëherë prodhuesi u paguan ekzekutuesve gjysmën e shumës, që merr nga përdoruesi. Sipas Neni 35 të Ligjit, prodhuesit e fonogrameve kanë këto të drejta ekonomike: 1) Të drejtën e riprodhimit të fonogramit (bërjes së kopjeve). Sipas kësaj të drejte, shtëpia diskografike që e ka krijuar fonogramin (CD, kasetë, shirit, etj.) gëzon të drejtën e shumëfishimit të tij. Një fonogram nuk mund të riprodhohet pa autorizimin e prodhuesit të tij. 2) Të drejtën e importimit të fonogramit. Ashtu sikurse autori gëzon të drejtën e importimit të veprës së tij, si një e drejtë ekonomike më vete, për të njëjtat arsye, kjo e drejtë u njihet edhe prodhuesve të fonogrameve. 3) Të drejtën e dhënies me hua ose të dhënies me qera të fonogramit.

Një e drejtë tjetër shumë e rëndësishme për prodhuesit e fonogrameve, që nuk është parashikuar nga ligji shqiptar, është e drejta e shpërndarjes në publik të fonogrameve nëpërmjet shitjes ose mënyrave të tjera të kalimit të pronësisë. Kjo e drejtë njihet nga Neni 12 i Traktatit të OBPI-se “Për Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet (1996), ku Shqipëria është palë që në vitin 2001. Gjithashtu, një e drejtë tjetër e re, që i përshtatet internetit dhe që njihet nga ky Traktat, është e drejta e vënies në dispozicion të publikut të fonogrameve të tyre, me kabëll ose jo, në mënyrë që publiku të ketë akses në këto fonograme në vendin dhe kohën që i pëlqen atij. Sipas Neni 39 Ligjit për të Drejtën e Autorit, kusht për mbrojtjen e fonogramit është që, në të gjitha kopjet, në ambalazhimet e tyre të shfaqet dukshëm shkronja “P” brenda një rrethi e shoqëruar me datën dhe vitin e botimit të parë, gjë që tregon se fonogrami është i mbrojtur. Gjithashtu, në këto kopje ose ambalazhet e tyre duhet të dalë emri i atij që mban të drejtat, që burojnë nga fonogrami si dhe emrat e atyre, që mbajnë të drejtat ekskluzive. Kjo dispozitë e ligjit shqiptar bie haptazi në kundërshtim me Nenin 20 të Traktatit, sipas të cilit, gëzimi dhe ushtrimi i të drejtave të prodhuesve të fonogrameve nuk duhet t’i nënshtrohet asnjë lloj formaliteti, prandaj ajo duhet shfuqizuar. Edhe operatorët radiotelevizivë gëzojnë një numër të drejtash ekonomike fqinje, që përcaktohen nga Neni 37 i Ligjit:

1) Të drejtën të autorizojnë ritrasmetimin e programeve të tyre;  
2) Të drejtën të autorizojnë regjistrimin e programeve të tyre;  
3) Të drejtën të ndalojnë riprodhimin e regjistrimit të programeve të tyre kur: a) regjistrimi që do të riprodhohet është bërë pa autorizimin e tyre, ose b) programi është regjistruar pa autorizimin e tyre, në përputhje me ligjin, por riprodhimi kërkon autorizimin e operatorit radioteleviziv përkatës, sepse nuk është nga ato riprodhime që ligji i lejon të kryhen pa pëlqimin e tyre. Kështu, një program televiziv shkencor mund të regjistrohet pa pëlqimin e operatorit radioteleviziv që e ka prodhuar atë, në qoftë se ai do të përdoret për kërkime shkencore. Por, riprodhimi i këtij regjistrimi për tu trasmetuar nga operatorë të tjerë televizive, kërkon patjetër autorizimin e operatorit të parë, përndryshe është i kundraligjshëm. Të drejtat fqinje të subjekteve të lartpërmendur zgjasin për një periudhë kohe të caktuar, që në rastin e ekzekutuesve është 50 vjet, duke filluar nga fundi i vitit, në të cilin është dhënë shfaqja; në rastin e prodhimit të fonogramave, 50 vjet, duke filluar nga fundi i vitit kur fonogrami është prodhuar për herë të parë; në rastin e operatorëve radiotelevizive, 50 vjet, duke filluar nga fundi i vitit, në të cilin është bërë transmetimi.

Trajtimi i të drejtave pasurore do të jepet nëpërmjet dallimit të tyre, nga të drejtat vetjake jopasurore të autorit. Ndonëse ato janë të lidhura ngushtë me autorin dhe veprën, për shkak të natyrës së tyre të ndryshme, për shkak të kohëzgjatjes së mbrotjes së tyre, etj, kanë karakteristika që i bëjnë të dallojnë nga njëra-tjetra si më poshtë:

1. Të drejtat vetjake jopasurore janë të drejta që i përkasin sferës jopasurore të interesave të autorit, ndërsa ato pasurore janë të lidhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë me nxjerrjen e të ardhurave nga pasja, përdorimi apo gëzimi i së drejtës së autorit;
2. Të drejtat vetjake jopasurore e shoqërojnë autorin jo vetëm gjatë gjithë jetës së tij, por edhe pas vdekjes. Pra, të drejtat vetjake jopasurore gëzohen përjetësisht, ndërsa të drejtat pasurore gëzohen gjatë gjithë jetës së autorit, si dhe pas vdekjes së tij, derisa plotësohen afatet e caktuara ligjore, që sado të gjata të jenë nuk bëjnë dot që këto të drejta ta shoqërojnë autorin në mënyrë të përherëshme;
3. Të drejtat vetjake jopasurore kanë natyrë personale dhe kryesisht nuk kanë natyrë të transferueshme. Ndërsa të drejtat pasurore janë të lidhura me veprën dhe

jo pazgjidhshmërisht me autorin; ato mund të transferohen në rrugë tarshëgimie ose me kontratë nga autori tek persona të tjerë

## PËRFUNDIM

Autori i vepres është pronari i pare i te drejtave morale dhe ekonomike që janë të lidhura me vepren e tij. E drejta e pronësisë mbi një veper i jep të drejtë autorit apo pronarit të saj që të përcaktojë fatin e vepres, të kalojë të drejtën e pronësisë së vepres tek një person tjetër, ta tjetërsojë atë, ta shesë, ta importojë, të kalojë të drejtën e përdorimit të vepres, ta japë me qira, në huapërdorje e të tjera. Përkishtë për këto arsye, në nenin 22 të ligjit “Për të drejtën e autorit”, thuhet se autori është pronari i pare i vepres që ai ka krijuar, sepse sipas tij mund të vijne pronare të tjera, të cilëve u kalon e drejta e pronësisë mbi vepren në formë të ligjshme. Kur vepra është frut i punës së disa bashkëautorëve, atëherë ata të gjithë së bashkë janë bashkëpronarë mbi të drejtat morale dhe ekonomike që burojnë nga vepra e tyre.

Në qoftë se një veper është objekt i veprimtarisë intelektuale të disa bashkëautorëve, dhe bashkëpronësia e tyre është në pjesë, atëherë bashkëautorët kanë nga njëra anë të drejtën e pronësisë të pavarur secili për pjesën e vet dhe, nga ana tjetër të gjithë së bashku janë bashkëpronarë të vepres së përbashkët. Në një veper kolektive pronari i pare i te drejtave morale dhe ekonomike do të jetë personi fizik ose juridik me emrin iniciativën dhe nën drejtimin e të cilit, ka dalë vepra. Për veprat e krijuara në bazë të kontratave të punës nga autori gjatë kohës së punësimit, pronari i pare i te drejtave ekonomike dhe morale do të jetë autori, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe. Të drejtat ekonomike i kalojnë punëdhënësit në masën e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar nga punëdhënësi.

Në rastin e veprave autovizuale, pronësia e te drejtave ekonomike të autorit i takon prodhuesit të një veprë të tillë. Prodhuesi i saj do të quhet personi juridik ose fizik që merr iniciativën dhe përgjegjësinë për prodhimin e saj. Për shembull, rasti i një shoqërie që prodhon një film. Zakonisht kalimi i te drejtave ekonomike të pronësisë dhe i te drejtave të tjera të përdorimit, bëhet me anë të kontratës, kur ky kalim bëhet midis të gjallëve dhe me anë të testamentit, ose me anë të trashëgimisë

ligjore, kur kalon nga i vdekuri tek te gjallet. Ndersa kalimi i te drejtave morale nuk mund te behet midis te gjalleve, por vetem me ane te dispozitave ligjore te trashegimise ligjore apo testamentare. Pervec kontrates autori ka te drejte te leshoje dhe licenca per kryerjen e veprimeve qe perfshihen ne te drejtat e tij ekonomike. Pavaresisht nese kalimi apo transferimi i te drejtave ekonomike do te behet me kontrate apo me licence perjashtimore, nga pikepamja formale si kontrata, ashtu dhe dhenia e licences do te behet **me shkrese**.

Licencat mund te jene perjashtimore ose joperjashtimore. Kue licenca eshte **perjashtimore**, ne permbajtjen e saj parashikohet qe licencmarresi ka te drejte te kryeje veprime te cilat kane te bejne me perjashtimin e personave te tjere, ose edhe me perjashtimin e vete autorit nga ushtrimi i te drejtave te caktuara me licence. Licencat jane **joperjashtimore** atehere kur ne permbajtjen e saj i jepet licencmarresit e drejta te kryeje veprime me natyre joperjashtimore ne raport me autorin ose me persona te trete, domethene edhe autori mund te shfrytetoje te drejtat per te cilat caktohet me licence nje person. Ne permbajtjen e kontratave me objekt transferimin e te drejtave ekonomike te autorit dhe ne permbajtjen e licencave zakonisht parashikohen veprime te tilla si kufizime per kryerjen e te drejtave te caktuara ekonomike, lidhur me kohen, qellimin, shtrirjen territoriale, menyren dhe mjetet e shfrytezimit te ketyre te drejtave.

Kur ne kontrate apo ne licence nuk eshte percaktuar shprehimisht territori ne te cilin do te kryhet transferimi i te drejtave ekonomike konsiderohet si kufizim i transferimit te se drejtes ekonomike brenda vendin ne te cilin eshte dhene transferimi. Per analogji, e njejta gje do te zbatohet edhe kur kontrata apo licenca nuk shprehen per kufijte e shtrirjes, menyren dhe mjetet e shfrytezimit te nje te drejte ekonomike. Kur autori i ka kaluar nje tjetri te drejten e pronesis se ka tjetersuar origjinalin e vepres se tij apo nje kopje te saj, kjo nuk do te thote se ai i ka kaluar blesesit te drejtat e tij ekonomike ose, se i ka dhene atij licence per kryerjen e veprimeve qe perfshihen ne te drejtat ekonomike. Megjithate, ne rastin e tjetersimit te origjinalit apo te nje kopje te vepres, blesesi i ligjshem ka te drejte te beje ekspozimin e vepres drejteperdrejt ne publik, pervec rasteve kur ne kontrate eshte parashikuar ndryshe nga palet.

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Fillimisht pronësia intelektuale njihej thjeshtë si e drejtë morale dhe jo si një e drejtë edhe ekonomike e autorit apo titullarit të pronësisë intelektuale. Pas vendosjes së regjimit demokratik, Shqipëria ka bërë përpjekje dinjitoze në fushën e rregullimit dhe mbrojtjes të së drejtës së autorit, në mënyrë që si legjislacioni ashtu edhe organet e specializuara në mbrojtje të saj, të jenë në parametrat e ofruara nga e drejta ndërkombëtare si dhe nga e drejta e Bashkimit Europian. Mund të konkludojmë se legjislacioni shqiptarë në këtë fushë, e parë kjo në një plan historik e krahasimor kombëtar, ka bërë përparime të dukshme. Ndërgjegjësimi i qytetarëve është një element thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në kontekstin e fuqizimit të vazhdueshëm të rolit të mediave në ndërgjegjësimin e publikut, do të ishte pozitive marrja e iniciativave të ndryshme mediatike nga ana e institucioneve përgjegjëse për të trumbëtuat çështjet e të drejtës së pronësisë intelektuale. Si të tilla mund të përmenden: Promovimi i aktiviteteve të grupeve të ndryshme të interesit (duke përfshirë OJQ-të, shoqatat e biznesit, dhomat e tregtise, biznesmenë, studiues, etj) të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet mjeteve të diskutimit, ekspozitave, leksioneve etj. Nxitja e debatit publik rreth çështjeve aktuale në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, veçanërisht nga prespektiva e të drejtës ndërkombëtare dhe biznesit ndërkombëtar, përfshirja e sferës së medias dhe masmedias në bashkëpunim në këtë fazë shfaqet si një hap konkret dhe i dobishëm për tu realizuar. Mbështetja e publikut është një element themelor për suksesin e këtyre iniciativave.

Kjo mund të arrihet vetëm nëse publiku do të këtë mundësi të njihet me pasojat e padëshirueshme të shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe gjithashtu të kuptojë ndikimin që ato kanë në jetën e tyre. Në këtë kontekst, është e nevojshme jo vetëm që sektori publik t'i mbrojë si duhet të drejtat e zotëruesve të të drejtave individuale, por edhe që publiku i gjerë të kuptojë se blerja e mallrave të imituara ose të falsifikuara çon në përkeqësim të situatës së punësimit, shpesh duke marrë produkte të pagarantuar, duke përfshirë edhe ndikimet në fushën e shëndetësisë dhe higjienës, dhe nxit përfitimet e strukturave të

jashtëligjshme në shoqëri. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të përmbushen këto detyra, pasi i gjithë sistemi i pronësisë intelektuale nuk është i thjeshtë dhe publiku i gjerë zakonisht ka njohuri shumë të kufizuara dhe shpesh të pasakta rreth saj.

## **BIBLOGRAFIA**

1. Doktoratura, Uarda Albunesa: “E drejta e autorit ne legjislacionin Shqiptar dhe atij European”
2. Mariana Tutulani-Semini: “E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave(pjesa e posacme)”
3. Benacchio G, Simoni V, Repertorio di diritto comunitario civile e commerciale (Legislazione-Dottrina- Giurisprudenza), Cedam, 2001, Padova.
4. Ligji nr. 9380 datë 28.04.2005(i shfuqizuar) “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”
5. Ligji nr.35 datë 31.3.2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

# **ROLI I PROKURORISË, DHE GJYKATËS NË TRAJTIMIN E FËMIJËVE-MITURVE TË INVOLVUAR NË KRIMINALITET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT , REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Doc. Dr. Driton Haruni**

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë ([d.haruni@eust.edu.mk](mailto:d.haruni@eust.edu.mk))

**Doc. Dr. Shemsije Demiri**

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë ([d.haruni@eust.edu.mk](mailto:d.haruni@eust.edu.mk))

---

## **Abstrakt**

Studimet në fushën e të drejtës penale janë të shumta dhe gjithëpërfshirëse, megjithatë doktrinës juridike në vendin tonë i mungonte një qasje specifike dhe e integruar, kundrejt një kategorie tepër të ndjeshme veprash penale dhe kryesve të tyre.

Nga formacionet e para e deri më sot po edhe në të ardhmen tek fëmijët si shkaktar të kryesve të v.p paraqitet mosha si dhe karakteristikat tjera: sociologjike, psikologjike, kriminale-politike, juridike. Trajtimi penal i fëmijëve është ndryshe nga personat e rritur në shteteve aktuale pa marr parasysh diversitetet e tyre, dhe pozita juridike e tyre ka evoluar në favor të fëmijëve si me trajnim më të butë, më të favorshëm në krahasim me kryesit madhor të v.p. Ky trajnim më i favorshëm i fëmijëve është i pranishëm në fushën e legjislacionit penal matrial dhe procedural.

Cili është roli i personit kyq që meret me akuzimin e fëmijëve/miturve, pra cili është roli i prokurorëve në R.M.V-së, R.Sh-së. dhe R.K-së.

Meqë kemi të paraqitur, të arrestuar dhe ndaj tyre kemi edhe një akuzë të ngritur atëherë duhet të kemi edhe organin që do zhvilloj procedurën ndaj fëmijëve/miturve, në fakt kush do të zhvilloj gjykimin dhe në këte rast cili është roli i gjykatave në R.M.V-së, R.SH-së. dhe R.K-së.

**Fjalët kyçe:** *i mitur, vepra penale, prokurori, gjykata.*

## **HYRJE**

Roli i prokurorisë, dhe gjykatës në trajtimin e fëmijëve-miturve të involvuar në kriminalitet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës

Involvimi i fëmijëve në kriminalitet është i padëshiruar dhe i pa pëlqyer, i papranuar në shoqëri, mirpo fatkeqsisht e kemi prezent dhe dikush duhet që të meret me këte problematikë. Organet shtetrorë në përgjithësi poashtu edhe prokuroria dhe gjykatës në vecanti luajn nje rolë jashtzakonisht të madhe në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të fëmijëve.

Roli i prokurorit në R.e Maqedonisë së Veriut, R.e Shqipërisë dhe R. e Kosovës për fëmijët e involvuar në kriminalitet

Prokuroria është organ unik dhe i pavarur shtetror që për detyrë kryesore e ka ndjekjen e kryesve të v.p dhe të veprave tjera të dënueshme me ligj dhe ushtron edhe punë të tjera të caktuar me ligj.<sup>1</sup>Veprimtaria e prokurorisë për luftimin e kriminalitetit zhvillohet në disa faza të procesit të hetimeve paraprake sipas normave të KPP.Prokurorija është organ i vetëm që ushtron ndjekjen penale dhe ka përparsi të plotë në kryerjen e funksioneve të saj dhe i nënshtrohen kushtetutës dhe ligjeve, urdhërat e prokurorisë më të lartë janë obligim për prokurorinë më të

---

<sup>1</sup> E drejta Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Mersim Maksuti Tetovë 2010 f.217

ulët.Ndjekjen penle, kryen hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngritjen e akuzës para gjykatës, merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me KPP.<sup>2</sup>

Në nenin 106 të Kushtetutës së R.M.V-së potencon ceshtjen e prokurorisë publike ku thot se: është organ unik dhe i mëvetësishëm shtetëror i cili i ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave të tjera të ndëshkueshme të përcaktuara me ligj dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.<sup>3</sup>

## **ROLI I PROKURORISË, DHE GJYKATËS NË TRAJTIMIN E FËMIJËVE-MITURVE TË INVOLVUAR NË KRIMINALITET**

Sipas ligjit për drejtësi të fëmijëve ne R.M.V-së pas kallëzimit për veprim që me ligj është paraparë si v.p e kryer nga fëmija mbi 14 vjet, për të cilën është përcaktuar dënim në para ose dënim me burgim deri në tre vjet, prokurori kompetent publik mundet që:të mos ngritë procedurë para gjykatës edhe pse ekzistojnë dëshmi se e ka kryer veprimin që me ligj është paraparë si v.p, nëse konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme të udhëhiqet procedurë duke marrë parasysh natyrën e veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale dhe rrethanat në të cilat është kryer, jetën e mëparshme të fëmijës dhe cilësitë e tij personale, si dhe kur zbatimi i dënimit dhe masës edukuese është nërrjedhë; kushtimisht ta prolongojë ngritjen e procedurës para gjykatës në kohë prej gjashtë muajsh me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprim tjetër që me ligj është paraparë si v.p dhe ta kompensojë dëmin ose në mënyrë tjetër t'i përmirësojë pasojat e dëmshme të shkaktuara me kryerjen e veprës; dhe të mos ngritë procedurë nëse në bazë të raportit të qendrës konstaton se është arritur marrëveshje ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij dhe të dëmtuarit për kthimin e dobisë pronësore, kompensimin e dëmit ose përmirësimin e pasojave të dëmshme ngavepra.

---

<sup>2</sup>Av.Gjok Buna Kodi i Procedurës penale dhe legjislacioni lidhur me të i përditësuar dhe me praktik gjyqësore prill 2014 f.14.

<sup>3</sup>Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Shkup nëntor 1991 neni 106.

Para miratimit të vendimit prokurori publik mund të kërkojë raport të veçantë nga Ministria e Punëve të Brendshme për rrethanat në të cilat është kryer v.p. Procedura e ndërmjetësimit dhe barazimit përjashtohet nëse vepra penale ka pasur si pasojë vdekjen e ndonjëpersoni. Me përjashtim, krahas masave edukuese për veprime që me ligj janë të parapara si vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg deri në pesë vite, prokurori publik mundet që në afat prej 30 ditësh të vendosë që të mos ngritë procedurë edhe pse ekzistojnë dëshmi se fëmija e ka kryer veprimin që me ligj është paraparë si vepër penale, nëse konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme që të udhëhiqet procedurë duke pasur parasysh natyrën e veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale dhe rrethanat në të cilat është kryer, jetën e mëparshme të fëmijës dhe personalitetin etij.

Prokurori publik është i obliguar që të kërkojë njoftim nga prindi ose prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës, nga persona dhe institucione tjera, e kur kjo është e nevojshme mundet që këta persona dhe fëmijën t'i thirrë në prokurorinë publike për njoftim të drejtpërdrejtë. Në afatin e parapar mund të kërkojë mendim nga qendra për përshtatshmërinë e ngritjes së procedurës ndaj fëmijës. Për miratimin e vendimit duhet të analizohen cilësitë personale të fëmijës, prokurori publik mundet në pajtim me qendrën ta dërgojë fëmijën në vendpranim ose në institucion për pyetje ose edukim, që mund të zgjasë më së shumti një muaj.

Vijimi i zbatimi të dënimit ose sanksionit tjetër, prokurori publik mund të vendosë që të mos kërkojë ngritjen e procedurës për veprim tjetër që me ligj është paraparë si vepër penale të fëmijës, duke pasur parasysh peshën e këtij veprimi që me ligj është paraparë si vepër penale, si dhe dënimin, ose sanksionim që zbatohet, nuk do të kishte qëllim ngritja e procedurës dhe shqiptimi i sanksionit për atë vepër. Kur prokurori publik konstaton se nuk është e përshtatshme që të ngritet procedurë ndaj fëmijës, për këtë do ta njoftojë të dëmtuarin me theksimin e shkaqeve për të cilat nuk e ka ngritur procedurën. I dëmtuari mundet në afat prej tetë ditësh të kërkojë nga këshilli për fëmijë të vendosë për ngritjen e procedurës.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup>Ligji i drejtësisë për fëmijë i R.M-së shkup 2013 neni 75.

Procedura ndaj fëmijëve ngrihet vetëm me kërkesë të prokurorit publik. Procedura ndaj fëmijës mbi 14 vjet për veprim që me ligj është paraparë si v.p ngritet vetëm me kërkesë të prokurorit publik. Për veprime që me ligj janë të parapara si vepra penale për të cilat ndiqet me propozim ose padi private, procedura mund të ngritet nëse i dëmtuari në afat prej tre muajsh nga zbulimi i veprës së kryer ose kryerësit, kan dhënë propozim për ngritjen e procedurës te prokurori publikkompetent. Nëse prokurori publik nuk dorëzon kërkesë për ngritjen e procedurës ndaj fëmijës, do ta njoftojë për këtë të dëmtuarin. I dëmtuari nuk mund ta ndërmarrë procedurën, ose nuk mund të parashtojë padi private në gjykatë, por mundet në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit të kërkojë që këshilli për fëmijë i gjykatës kompetente të vendosë për ngritjen e procedurës.

Para se të vendos nëse do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës përgatitore, prokurori publik e dëgjon fëmijën në prani të prindit/ëve, ose tutorit/ëve të tij dhe mbrojtësit, përveç kur gjendja e tij psikofizike këtë nuk e lejon. Nëse fëmija dhe prindi/ët, ose tutori/ët e tij nuk marrin mbrojtës, prokurori publik me detyrë zyrtare nga lista avokatëve të dorëzuar nga Oda e avokatëve do t'i caktojëmbrojtës. Nëse procedura nuk vazhdohet para gjykatës, shpenzimet për avokatin i bartin prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës, e në rastet kur prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës nuk janë në gjendje që t'i paguajë, ato janë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Konsiderohet se prindi/ët, ose tutori/ët nuk janë në gjendje që t'i paguajnë shpenzimet për avokat nëse realizon të hyra të përgjithshme mujore më të vogla se neto rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çfarë duhet të dorëzojë vërtetim për të hyrat e përgjithshme mujore të dhënë nga organi kompetent, ose organizata, te qendra më së voni në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e pranimit të njoftimit të marrë për dokumentacionine nevojshëm.

Nëse prindi/ët, ose tutori/ët nuk dorëzojnë vërtetim të këtillë do të konsiderohet se prindi/ët, ose tutori/ët janë në gjendje që t'i paguajnë shpenzimet e avokatit. Kur janë të plotësuar kushtet për dënim të fëmijës në rrezik mbi 14 vjeç, prokurori publik mundet që para se të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës përgatitore, t'i propozojë fëmijës, mbrojtësit të tij, prindit/ëve, ose tutorit/ëve që të ngritet procedura e veçantë për pranimin e përgjegjësisë dhe marrëveshjes për

shumën e dënimit. Propozim të këtillë prokurori publik mund të parashtrojë në rastet kur disponon me argumente të cilat padyshim tregojnë se fëmija është kryerësi i veprës penale, se është përgjegjës për veprën e kryer dhe se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit. Në procedurën për marrëveshje prokurori publik do t'i mbledhë të gjitha raportet e nevojshme dhe dokumentet tjera për personalitetin e fëmijës dhe do të sigurojë pëlqim nga i dëmtuari. Nëse me propozimin pajtohet edhe i dëmtuari, prokurori publik i thirr në marrëveshje publike fëmijën, përfaqësuesin e tij ligjor, mbrojtësin, qendrën dhe të dëmtuarin. Nëse në marrëveshje arrihet pëlqim, përpilohet marrëveshje që e nënshkruajnë të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm.

Prokurori publik e dorëzon marrëveshjen te këshilli për fëmijë që mund ta pranojë marrëveshjen dhe të miratojë aktgjykim me të cilin do ta shqiptojë sanksionin e propozuar, kundër të cilit nuk lejohet ankesë. Nëse gjykata nuk e pranon marrëveshjen, e kthen lëndën te prokurori publik i cili është i obliguar që të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurëspërgatitore. Gjatë procedurës përgatitore, shkresat gjyqësore dhe deklaratat e fëmijës dhe mbrojtësit të tij të dhëna në procedurën për marrëveshje nuk guxojnë të përdoren si argumente dhe do të veçohen nga proceduragjyqësore. Prokurori publik nuk guxon të thirret në të dhënat dhe deklaratat e dhëna në procedurën përmarrëveshje.<sup>5</sup>

Legjislacioni penal i R.sh-së konkretisht Kodi i drejtësisë penale për të mitur, KPP, ligji mbi prokurorët në mënyrë të prerë dhe decide sqarojnë që ndjekjen penale në tërë territorin e shtetit e kryejn prokurorët. Në theks të veçant prokurorët e trajnuar dhe të specializuar për të mitur kryejnë çështjen e ndjekjes për të mitur.

Duke patur parasysh qëllimin e politikës penale ndaj të miturve si kryerës të v.p që është rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri gjatë marjes në pyetje duhet ti baj të gjitha përpjekjet paraprake du u përpjekur që marrja në pyetje ti shërbej jo vetëm zhvillimit të pa anshëm të hetimeve paraprake, portë realizoj të drejtat dhe interesat e të miturit, ti shpjegoj të pandehurit të mitur, prindit/tutorit, përfaqësuesit ligjor për të drejtat për të mos u përgjigjur gjë e cila nuk e ndalon

---

<sup>5</sup>Ligji për drejtisi për fëmijët Republika e Maqedonisë Shkup dhjetor 2013, neni 106,107,108.

procedimin. Pas deklaramit të përfaqësuesit ligjor se kjo e drejtë është kuptuar dhe se i mituri heqë dorë prej saj atëherë mund të vijoj marja në pyetje. Për çdo të dhënë nga ana e prokurorit duhet ti bahet me dije të miturit se do të mbahet në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime të këtij procedimi penal. Të gjitha veprimet përshkruhen në procsverbal.

Ambijenti ku do të merret në pyetje i mituri luan një rol shumë të rëndësishëm dhe i njëjti duhet të jetë miqësor me kushte të përshtatshme edhe për gjininë, gjendjet e tij shëndetësore dhe psikologjike, mos të ketë ndërprerje dhe mos lejohet të përzihen personat e pautorizuar, përveç rasteve kur ndërprerja është e domosdoshme për shkaqet shëndetësore apo kur kemi ulje të koncentrimit të të miturit. Të zërit dhe mënyra e komunikimit ndaj të miturit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në asnjë mënyrë të mos jetë agresiv, kërcënues apo i ashpër.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori nuk duhet të komentoj apo veprojë në mënyrë të tillë që të paragjikohej se vendimarrja e gjykatës është në favor apo disfavor të tij. Gjatë caktimit të dënimit duhet të jetë proporcional duke ruajtur raportin e rëndësisë së shkeljes, të drejtës së të dëmtuarit, nevojës për trajtim të posaçëm.<sup>6</sup>

Në legjislacionin penal të R.K-së duke u mbështetur në KPP, kodin për drejtësi të të miturve dhe ligjin për prokurorinë e shtetit poashtu është e theksuar se prokurori kryen hetimin e v.p dhe përvaqson akuzën para gjykatës.

Në bazë të kallëzimit penal të policisë, kallëzimit penal nga persona të tjerë ose nga burime të tjera nëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer v.p: prokurori i shtetit për të mitur mund të fillon procedurën përgatitore ndaj të miturit të caktuar, ku për v.p të dënueshme me burgim prej më pak se tre vjet ose me gjobë, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer v.p, nëse se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së v.p, në rrethana në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit

---

<sup>6</sup>Udhëzim për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar ose dëshmitar Tiranë 2013 neni 14 dhe neni 17.

të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale. Kur ndaj të miturit ekzekutohet dënimi ose masa, mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore për një v.p tjetër të kryer nga i mituri, nëse duke pasur parasysh peshën e asaj v.p, si dhe dënimin a masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënimit ose i masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi. Nëse prokurori i shtetit për të mitur vendos të mos fillojë procedurën përgatitore, ai e njofton organin e kujdestarisë, policinë dhe palën e dëmtuar kur rasti është inicuar nga policia. Nëse është e nevojshme, prokurori i shtetit për të mitur mund ta thirr prindin, prindin adoptues ose kujdestarin e të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar. Nëse për ndonjë arsye nuk është e mundur që anketa sociale të përfundohet para se të merret vendimi për përshtatshmërinë e fillimit të procedurës përgatitore, prokurori i shtetit për të mitur i siguron informatat e nevojshme dhe mund të konsultohet me shërbimin sprovues për vendimin e tij. Procedura përgatitore fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit për të mitur. Në aktvendim përcaktohet i mituri ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore, koha e fillimit të procedurës përgatitore, përshkrimi i veprës që përcakton elementet e v.p, emërtimi ligjor i v.p, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e bazuar për v.p, provat dhe informatat e mbledhura dhe raporti për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Një kopje e vulosur e aktvendimit mbi procedurën përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur.

Pas përfundimit të procedurës përgatitore prokurori i shtetit, kur nuk shqipton masën e diversitetit ose nuk vepron sipas parimit të oportunitetit, mund ti paraqes propozim të arsjetuar trupit gjykues për të mitur për shqiptim të masës educative ose të dënimit.

Propozimi i prokurorit të shtetit duhet të përfshijë: të dhënat personale të të miturit, përshkrimin e v.p, emërtimin ligjor të v.p me përcaktimin e dispozitave të KPP, provat që tregojn se i mituri e ka kryer v.p, rezultatet e ndonjë ankete sociale të zbatuar nga shqërbimi sprovues dhe propozimin për shqiptimin e masës

educative ose të dënimit duke përfshir arsytet pse nuk është shqiptuar masa e diversitetit.<sup>7</sup>

Roli i gjykatës në R.e Maqedonisë së Veriut, R.e Shqipërisë dhe R. e Kosovës për fëmijët/miturit e involvuar në kriminalitet

Pushteti shtetrot në R.M.V-së ndahet në pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat, të cilat janë të mëvetësishme dhe të pavarura, gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Organizimi i gjyqësisë është unik dhe ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme.<sup>8</sup>

Duke u bazuar në ligjin për drejtësi të fëmijëve i R.M.V-së seksionet e specializuara gjyqësore për kriminalitetin e fëmijëve të formuara në gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar përbëhen nga:

gjykatës për fëmijë,

këshilla për fëmijë dhe

këshilltarë për fëmijë.

Gjykatësi për fëmijë e zbaton procedurën përgatitore, miraton vendime në pajtim me nenin 86 të ligjit për drejtësi të fëmijëve i R.M.V-së, kryeson me këshillin për fëmijë dhe kryen punë tjera. Gjykatësi për fëmijë, prokurori publik, avokati dhe personat e autorizuar zyrtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme, së paku pesë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për drejtësi për fëmijë në vend dhe jashtë vendit.

Përbërja e këshilli për fëmijë në gjykatën themelore përbëhet nga gjykatësi për fëmijë dhe dy gjykatës-porotë. Gjykatësi për fëmijë është kryetar i këshillit,

---

<sup>7</sup> Ejup Sahiti, Rexhep Murati e drejta e procedurës penale Prishtinë 2013 faqe 434.

<sup>8</sup>Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Shkup 1991 neni 98.

ndërsa gjykatësit-porotë zgjidhen nga radhët e punëtorëve të arsimit, psikologëve, pedagogëve, punëtorëve socialë dhe personave tjerë që kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Këshilli për fëmijë në gjykatën themelore vendos në shkallë të parë në procedurë për veprime që me ligj janë të parapara si v.p. Në gjykatën themelore formohet këshilli penal për fëmijë që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të gjykatësit për fëmijë edhe në rastet e parapara në ligjin për drejtësi të fëmijëve i R.M.V-së, përbëhet nga tre gjykatës që e kanë ndjekur trajnimin për delikucencë të fëmijëve.

Gjykatësi për fëmijë i cili ka miratuar aktvendimin kundër të cilit është parashtruar ankesë nuk mund të marrë pjesë në këshillin penal për fëmijë.

Në gjykatën e apelit këshilli për fëmijë përbëhet nga gjykatësi për fëmijë dhe dy gjykatës tjerë, të cilët vendosin për ankesat kundër vendimeve të këshillit për fëmijë të gjykatës themelore.

Pesë gjykatës e formojnë këshillin për fëmijë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë i cili vendos për këshilla juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe e përcjell e punon në avancimin e praktikës gjyqësore në këtë sferë dhe përpilonaliza.

Në seksionet e specializuara gjyqësore për drejtësi për fëmijë, të formuara në gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar, për kryerjen e punëve profesionale, kryetari i gjykatës cakton nga një punëtor social, pedagog ose psikolog me propozim të qendrës. Vendim për numrin, detyrat e punës dhe mënyrën e përfshirjes së personave profesionalë miraton kryetari i gjykatës, dhe të njejtit e ndihmojnë gjykatësin për fëmijë dhe këshillit për fëmijë në udhëheqjen e procedurës përgatitore dhe shqyrtimit, japin mendime profesionale lidhur me vendimin e gjykatës dhe sanksionin që do të duhej të shqiptohet në rastin konkret, i ndihmojnë gjykatës në mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve të shqiptuara dhe japin propozime për ndërprerjen e zbatimit ose zëvendësimit të një sanksioni metjetër.

Kompetent vendor sipas rregullës është gjykata e vendbanimit të tij, e nëse fëmija nuk ka vendbanim të përhershëm ose nëse ai është i panjohur, gjykata e vendqëndrimit të fëmijës. Procedura mund të zbatohet para gjykatës së vendqëndrimit të fëmijës ose para gjykatës së vendit të kryerjes së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje, në rastet kur është e qartë se para asaj gjykate procedura do të zbatohet paprolongim.<sup>9</sup>

Sa i përket Kodit për drejtësi për të mitur i R.Sh-së në nënin 27 sqaron kompetencat e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të mitur. Ku i mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Seksionet janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e v.p ndaj të miturve si viktime. Gjyqtari i caktuar për gjykimin e të miturit në këto seksione duhet të jetë i specializuar dhe trajnuar për drejtësinë penale për të mitur. Kur një i mitur ka kryer v.p së bashku me një të rritur, ai gjykohet në seksionet për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore, duke zbatuar dispozitat e këtij Kodi, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nënin 80, pika 1, të K.P.P.

Legjislacioni penal, Kushtetuta e R.K-së systemin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat në procedurë penale, dhe gjatë punës së sajë është e panvarur, dhe vendos në bazë të ligjit. Pushteti gjyqësor është unik, i panvarur, i drejtë, apolitik, e i paanshëm dhe siguron qasje të barabart në gjykata.<sup>10</sup>

Kodi i drejtësisë për të mitur i R.K-së në kapitullin e dytë përcakton trupin gjykues për të mitur edhe atëi mituri në shkallën e parë gjykohet nga gjyqtari për të mitur për v.p për të cilat si dënim kryesor është i paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në 10 vite.

---

<sup>9</sup>Ligji i drejtësisë për fëmijët i Republikës së Maqedonisë shkup 2013 neni 101-105.

<sup>10</sup> Ejup Sahiti, Rexhep Murati e drejta e procedurës penale Prishtinë 2013 f.126.

Trupi gjykues në shkallë të parë për të mitur përbëhet nga 3 gjyqtarë prej të cilëve kryetari i trupit gjykues është gjyqtar për të mitur, gjykon për v.p për të cilat është i paraparë dënim me burgim mbi 10 vite ose dënimi më i rëndë. Në shkallën e dytë gjykon kolegji për të mitur i përbërë prej tre gjyqëtarëve prej të cilëve gjyqtari referues është gjyqtari për të mitur. Në shkallën e tretë si dhe sipas mjeteve të jashtëzakonëshme juridike dhe në raste tjera të përcaktuara me këtë kodë gjykon kolegji për të mitur i përbërë nga 3 gjyqëtarë prej të cilëve kryetari i kolegjit është gjyqtar për të mitur.<sup>11</sup>

Gjykata, në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të pakët dhe janë të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese, dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese ka të drejtë të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse.

## **PËRFUNDIMI**

Kriminalitetin e fëmijëve/miturve nuk mund të zhduket mirpo mund të parandalohet dhe të zvoglohet duke u trajtuar në mënyrë bashkëkohore. Involvimin e kriminalitetit të fëmijëve/miturve e trajtojnë organet shtetërore në R.M.V-së, R.Sh-së dhe R.K-së si: prokurorija dhe gjykata.

Fëmijët/miturit gjatë kryerjes së v.p gjithmonë duhet të kenë parasyshë që egziston organi që kryen ndjekjen e tyre që është prokuroria konkretisht departamenti për të fëmijë/mitur të cilët kanë të drejtën absolute për propozimin e fillimit të procedurës për fëmijët/miturit që në momentin e kryerjes së v.p kanë mbi 14 vjet, të mosë ngritë procedurë para gjzkatës, të prolongoj ngritjen e procedurës, dhe në R.K-së prokurori për të mitur ka të drejtë të caktojë edhe masat e diversitetit.

Si nga momenti i paraqitjes së rastit ku fëmiju/mituri dyshohet se ka kry v.p, gjatë fazës së hetimit si dhe pas ngritjes së procedurës në gjykatë edhe gjatë gjykimit

---

<sup>11</sup>Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës Prishtinë tetor 2018 neni 48.

fëmiju/mituri trajtohet në mënyrë të veçant nga të rriturit pra nga gjykatësi për fëmijë/mitur, këshilli për fëmijë dhe këshilltarë për fëmijë. Me rëndësi është të cekim se trupi gjykues të gjykatës themelore në R.M.V-së përbëhet nga gjykatësi për fëmijë, ndërsa këshillin për fëmijë e përbëjnë gjykatësi për fëmijë dhe dy porotë të cilët zgjidhen nga radhët e punëtorëve të arsimit, psikologëve punëtorëve social dhe personave tjerë që kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjëve, në gjykatën e apelit këshilli për fëmijë përbëhet nga gjykatësi për fëmijë dhe dz gjykatës tjerë, si dhe pesë gjykatës e formojnë këshillin për fëmijë në gjykatën supreme. Në R.K-së trupi gjykues përbëhet nga tre gjykatës në të tre nivelet (themelor, apelit dhe supreme). Gjykatësit për fëmijë, prokurorët për fëmijë dhe pjestarët e MPB-së dhe avokati për fëmijë së paku pesë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për drejtësi për fëmijë brenda dhe jashtë shtetit.

## BIBLIOGRAFIA

- Vesel LATIFI. Delikuenca e të miturve Prishtinë.1979
- Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës Prishtinë tetor 2018
- Ejup SAHITI, Ismail ZEJNELI E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë. Tetovë. 2007
- Zako za maloletnicka Pravda (sl.vesnik na R.M broj 87/07-01.09.2008
- Ligji për të mitur i Republikës së Maqedonisë “ Gazeta Zyrtare e R.M-së Nr87/2007
- Vlladimir Krivokapiq Prevensija kriminaliteta policiska akademija Beograd 2002
- Vladimir Krivokapiq FSHK, Sarajevë 2006,
- Afrim OSMANI Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë 2010
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1990
- Krivicen zakonik na R.M sl. vesnik na R.M brooj 37/06
- Vllado KAMBOVSKI, Tatjana VELKOVA Maloletnicka Pravda Skopje 2008
- Dr. Kambovski , Vllado; e drejta penale – pjesa e përgjithshme (përkthim) Përkthyen
- Ismail Zejneli, Afrim Osmani ; Shkup , 2005
- Dr. Saliu Ismet; E drejta penale për të mitur; Prishtinë 2005

- Ligji i procedurës penale i Republikë së Maqedonisë 2005,
- Elezi, Ismet & Kaçupi, Skënder & Haxhia, Maksim, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1999.
- Gashi, Rexhep. III, Shërbimi Korrektues i Kosovës (historiku, fushëveprimi, organizimi) dhe struktura e personave të dënuar e të paraburgosur në institucionet korrektuese, E drejta, nr. 2, Prishtinë, 2008.
- Gashi, Rexhep. IV, Shërbimi Sprovues i Kosovës, historiku, fushëveprimi, organizimi dhe aktiviteti i tij, E drejta, nr. 3-4, Prishtinë, 2008.
- Hajdari Azem. II, Kodi i Procedurës penale, Komentari, Prishtinë, 2016.
- Hajdari, Azem. VI, E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2013. Hajdari, Azem. VII, Juvenile criminality in Kosovo, Macrothink Institute, 2015, Vol. 3, no. 1.
- Haxhimusa, Rexhep & Kabashi, Ismet. Komentari për Ligjin Penal për të Mitur, Prishtinë, 2011.
- M.Abazoviq, E.Muratbegoviq, M.Budimliq, E.Beqirevliq Politika e luftimit të kriminalitetit Sarajevë/Prishtinë 2006 Fsk-09/06
- Ligji për drejtsin e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2013
- E drejta e procedurës penale përkthim nga kroatishtja Mustaf Recica Prishtin 2007
- Kodi Nr. 06/L-006 I Drejtsisë për të Mitur i Republikës së Kosovës, tetor 2018, Prishtinë
- Udhëzim për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar ose dëshmitar Tiranë 2013
- E drejta Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Mersim Maksuti Tetovë 2010
- Av.Gjok Buna Kodi i Procedurës penale dhe legjislati i lidhur me të i përditësuar dhe me praktik gjyqësore prill 2014
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Shkup nëntor 1991
- Ejup Sahiti, Rexhep Murati e drejta e procedurës penale Prishtinë 2013
- Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës Prishtinë tetor 2018

# THE CONFLUENCE OF HISTORICAL TRAJECTORIES AND LEGAL PARADIGMS: A COMPARATIVE EXAMINATION OF ALBANIAN AND MACEDONIAN JURISPRUDENTIAL EVOLUTION

*Dr Lorenca Bejko*

---

## **Abstract**

Situated at the crossroads of diverse civilizations, the Balkans have exhibited a unique *mélange* of legal influences. This paper delves into the jurisprudential histories of Albania and Macedonia, examining their evolution through distinct and shared epochs. By juxtaposing the development trajectories of their legal systems, we aim to discern patterns, divergences, and the broader implications for Southeast European legal historiography.

**Keywords:** *history, trajectories, legal paradigms.*

## **INTRODUCTION**

In understanding the Balkans' multifaceted history, Albania and Macedonia emerge as fascinating case studies. Their proximate geographies belie distinct paths, yet shared historical arcs, particularly in the realm of law, provide intriguing points of convergence.

The Balkan Peninsula, often termed the "powder keg" of Europe, boasts a complex mosaic of cultures, languages, religions, and historical narratives.

Nestled within this intricate tapestry are Albania and Macedonia, two nations whose stories, while intertwined by the threads of regional geopolitics and shared encounters, also diverge sharply in their historiographical trajectories.

Albania and Macedonia, despite their geographical contiguity, have charted unique paths through the annals of time, often shaped by their interactions with various empires, neighboring influences, and their inherent ethnic and cultural dynamics. Yet, it is within the nexus of jurisprudential evolution where these nations, each with its own legal tapestry woven with threads of indigenous practices, foreign impositions, and modern adaptations, reveal compelling intersections. The comparative examination of their legal histories not only offers insights into their individual journeys but also into broader Balkan legal traditions, external influences, and the processes of legal synthesis and divergence.

As we embark on this exploration, it becomes crucial to approach their histories with a nuanced lens, recognizing both the shared legacies, born out of mutual historical experiences, and the distinct legal traditions that have emerged from their unique sociopolitical contexts. This confluence and divergence in their legal landscapes serve as a testament to the broader dynamics of the Balkan region—its ability to assimilate, resist, innovate, and transform.

## ANCIENT LEGACIES AND MEDIEVAL LEGALITIES

*Albania:* Beyond the Kanun of Lekë Dukagjini, Albania was influenced by the Roman and Byzantine legal codes, which presented a blend of civil and customary laws.

*Macedonia:* The region, as part of the larger Macedonian Empire and later the Roman Empire, saw the promulgation of legal edicts that bore Hellenistic and Roman imprints. This amalgamation laid foundational legal tenets.

**Albania:** As the tides of empires ebbed and flowed across the Balkan landscape, Albania's legal framework evolved into a rich palimpsest of influences. The

Kanun of Lekë Dukagjini, a set of traditional customary laws rooted deeply in the Albanian social fabric, governed aspects ranging from property rights to familial honor. However, these laws were not insular. The presence of the Roman Empire and subsequently, the Byzantine Empire, meant that the Roman legal philosophy, particularly the 'Corpus Juris Civilis,' left its mark. The Byzantine influence further nuanced this with the introduction of the 'Ecloga', a legal code that fused Roman law with Christian tenets. Thus, in the Albanian legal milieu, one witnessed a coexistence of indigenous traditions and imperial edicts, often leading to a synergetic legal framework where civil laws from empires and local customs intertwined.

**Macedonia:** Macedonia's legal evolution showcases a trajectory marked by its role as a crucible of civilizations. Initially, as the heartland of the mighty Macedonian Empire under figures like Alexander the Great, the region experienced legal formulations that reflected its Hellenistic roots. The conquest by the Roman Empire ushered in a new legal epoch. The Roman legal system, characterized by its comprehensive codes, principles of justice, and the rule of law, found its way into Macedonian governance. Legal documents, like the 'Twelve Tables', became influential. However, it wasn't a mere imposition; it was an amalgamation. Macedonian traditions and Hellenistic principles often seeped into, or coexisted with, Roman edicts, creating a hybrid legal culture. This composite framework set the stage for later legal developments, especially during periods of subsequent conquests and cultural exchanges.

## **TRANSITION THROUGH THE MIDDLE AGES AND THE DAWN OF OTTOMAN INFLUENCE**

With the decline of the Byzantine Empire and the subsequent rise of the Ottoman Empire, both Albania and Macedonia faced a new set of legal paradigms. Ottoman laws, primarily based on Islamic jurisprudence and the 'Qanun' (administrative laws), were introduced. However, the reception and integration of these laws varied.

*Albania:* While the Ottoman administrative and tax codes became prevalent, there was a nuanced negotiation between the Kanun and the Qanun. In many areas, particularly the rugged highlands, the Kanun remained the de facto law, especially in matters pertaining to personal and family issues.

*Macedonia:* Ottoman Macedonia, with its diverse populace, witnessed the millet system, where religious communities were granted a degree of autonomy in their personal and religious affairs. This meant that while the Qanun governed broader administrative matters, Christian, Jewish, and other communities could adhere to their religious laws in personal domains.

The interplay between Ottoman jurisprudence and pre-existing legal traditions in both regions offers a fascinating insight into the adaptability and resilience of local legal cultures in the face of overarching imperial systems.

The winds of nationalism that began to sweep across Europe in the 19th century also touched the Balkans, instigating a re-evaluation of identity and self-governance. Both Albania and Macedonia, after centuries under the Ottoman yoke, began to witness movements calling for autonomy, sovereignty, and the rejuvenation of indigenous cultures and traditions. This period was also marked by an emergent interest in codifying and standardizing legal practices that reflected national identities.

**Albania:** The late 19th and early 20th centuries saw a surge in Albanian nationalism. This growing consciousness was accompanied by demands for an autonomous legal system that would be more in line with Albanian traditions and aspirations. The Declaration of Independence in 1912 was not just a political watershed but also heralded the beginning of efforts to create a distinct Albanian legal code. While some Ottoman practices were retained, there was a marked push to reintegrate principles from the Kanun, especially in areas where it had remained dominant.

**Macedonia:** Similarly, the seeds of Macedonian nationalism germinated during the declining phase of the Ottoman Empire. While the Ilinden Uprising of 1903

was a significant manifestation of Macedonian aspirations, the post-Ottoman period saw Macedonia initially integrated into the Kingdom of Serbs, Croats, and Slovenes (later Yugoslavia). Legal reforms in this period reflected a complex tapestry of Yugoslav state laws, remnants of Ottoman practices, and emerging Macedonian legal thought. The emphasis was on creating a harmonized legal system while acknowledging regional peculiarities.

Post World War II, both regions found themselves grappling with the realities of Communist influence, albeit in different capacities.

**Albania:** Under Enver Hoxha, Albania adopted a strict Stalinist approach. The legal landscape was radically transformed, with socialist principles being embedded into every aspect of jurisprudence. Property laws, civil rights, and even aspects of criminal justice were viewed through the prism of socialist ideologies, often sidelining traditional legal norms.

**Macedonia:** As a federal unit of Socialist Yugoslavia, Macedonia's legal system was incorporated into the broader Yugoslav socialist framework. While Marxist-Leninist tenets played a pivotal role, Yugoslavia's unique brand of "self-management" socialism also influenced legal paradigms, especially in labor and property laws.

During the Ottoman dominion, both territories grappled with the juxtaposition of the Ottoman legal system and their indigenous traditions.

*Albania:* While Shari'a law permeated administrative and personal matters, the resilient Kanun, especially in the rugged hinterlands, provided an alternative legal recourse.

*Macedonia:* The millet system allowed religious communities certain juridical autonomy, leading to a mosaic of legal practices across Macedonian territories.

## NATIONHOOD, STATECRAFT, AND LEGAL SYNTHESIS

*Albania:* The post-Ottoman Albanian state oscillated between monarchic consolidations and socialist experiments. Each phase attempted legal codifications, drawing from Western European, Ottoman, and socialist precedents.

*Macedonia:* Initially absorbed into the Yugoslav framework, Macedonian legal structures bore the hallmarks of Yugoslav socialist jurisprudence, interspersed with localized adaptations.

The 20th century, characterized by monumental shifts in political ideologies and global alignments, brought both Albania and Macedonia to the forefront of profound national transitions. Their forays into statehood were marked by intense endeavors to craft legal structures that would balance historical legacies with new national identities.

**Albania:** Emerging from the vestiges of the Ottoman Empire, Albania found itself navigating the tumultuous waters of nationhood. The early years were marked by monarchic ventures, with King Zog attempting to establish a legal system inspired by Western European codes. However, the influence of customary laws, especially the Kanun, remained palpable in the rural hinterlands, leading to a dual legal existence.

However, the winds of change were swift. With the onset of World War II and the subsequent rise of Enver Hoxha's Communist regime, Albania underwent a radical transformation. The socialist period, stretching from the late 1940s to the early 1990s, saw concerted efforts to uproot feudal remnants and replace them with Marxist-Leninist legal tenets. Land reforms, collectivization drives, and state-centric economic policies necessitated a wholesale revamping of legal codes. Yet, beneath the veneer of socialist legality, traces of older systems, including influences from Ottoman times, persisted.

**Macedonia:** Macedonia's journey into statehood was, in many ways, intertwined with the larger narrative of the South Slavic unification dream. As the Ottoman Empire receded, Macedonia became a contested space, with Bulgaria, Greece, and Serbia vying for influence. The post-World War I era saw Macedonia integrated into the newly formed Kingdom of Serbs, Croats, and Slovenes, which subsequently became Yugoslavia.

Under the Yugoslav federation, Macedonian legal structures were largely molded by the overarching socialist framework of Tito's Yugoslavia. Concepts like 'workers' self-management' and socialist federative principles were enshrined in Macedonian jurisprudence. Yet, Macedonia's unique history and cultural tapestry meant that these laws were not mere impositions. Local customs, practices, and the evolving Macedonian identity influenced and localized many of these broader Yugoslav legal concepts.

## **POST-COLD WAR REALIGNMENTS AND THE EUROPEAN PARADIGM**

*Albania:* The implosion of the Communist regime necessitated a jurisprudential overhaul. Modern Albania, in its quest for EU membership, has been calibrating its legal system, infusing it with European standards while grappling with post-socialist legacies.

*Macedonia:* The tumultuous post-independence period, punctuated by the Ohrid Agreement, demanded constitutional recalibrations. EU aspirations further steered legal reforms, harmonizing them with the *acquis communautaire*.

The collapse of the Iron Curtain and the dissolution of the socialist bloc brought forth unprecedented changes to the political and legal landscapes of Europe. Both Albania and Macedonia, like many of their Eastern and Southeastern European neighbors, found themselves at crossroads, tasked with the immense challenge of restructuring their legal frameworks to align with Western democratic standards, particularly those of the European Union.

## **Albania:**

The abrupt end of nearly half a century of Communist rule in the early 1990s left Albania in a state of profound transformation. The initial years post-transition were marked by economic instability, political upheavals, and a need to dismantle the totalitarian legal edifice. The new democratic Albania sought to rebuild its legal system from the ground up, with a clear orientation towards European standards.

Key legal reforms were initiated in various sectors, ranging from property rights, where issues of restitution and compensation for expropriated lands during the socialist era arose, to reforms in the judicial system aiming for increased transparency, efficiency, and independence. Civil liberties, rule of law, and human rights became focal points, with Albania striving to align its codes with the European Convention on Human Rights.

Albania's European Union membership aspirations further intensified these reforms. In the ongoing negotiation processes, Albania has been consistently adapting its legal norms to the EU's standards, a journey that is both aspirational and reflective of the nation's broader European integration endeavors.

## **MACEDONIA (NORTH MACEDONIA):**

The early 1990s marked Macedonia's emergence as an independent state, a transition that was not without its complexities. The challenges of crafting a new national identity, coupled with the ethnic tensions culminating in the 2001 conflict, required sensitive and strategic legal interventions.

The Ohrid Framework Agreement, signed in 2001, became a pivotal document in Macedonia's post-independence legal history. It not only addressed immediate ethnic concerns but also laid down the blueprint for broader constitutional and legal changes, ensuring greater ethnic inclusivity in political and public life.

Parallel to these internal realignments, Macedonia, like Albania, set its sights on European integration. The Stabilisation and Association Agreement with the EU became the cornerstone for subsequent legal reforms. The process of harmonizing national laws with the *acquis communautaire*—the body of European Union law—took center stage. Whether it was environmental regulations, competition laws, or judicial reforms, the Macedonian legal landscape underwent significant recalibrations, mirroring EU standards.

## **SYNTHESIS AND FORWARD TRAJECTORIES**

The ebb and flow of empires, ideologies, and modern geopolitics have bequeathed Albania and Macedonia with intricate legal tapestries. As they inch closer to the European fold, understanding their jurisprudential histories becomes paramount, not only for harmonization but also for preserving their unique legal heritages.

Albania and Macedonia, in their quests for statehood and nation-building, showcased remarkable resilience and adaptability. Their legal histories during the 20th century underscore the complexities involved in melding historical legacies with new political imperatives. While both nations sought inspiration from external sources, be it Western Europe or socialist comrades, their legal journeys were deeply rooted in their unique historical experiences and cultural sensibilities. These intertwined tales of tradition and transformation offer invaluable insights into the broader processes of legal synthesis and evolution in the Balkans and beyond.

For both Albania and Macedonia, the post-Cold War era has been a period of rediscovery, redefinition, and realignment. While their unique histories have shaped distinct legal pathways, their shared aspiration for European integration has emerged as a unifying thread. The oscillation between embracing European standards and preserving national and local legal particularities encapsulates the ongoing narrative of legal evolution in these nations. Their journeys underscore the broader theme of the transformative power of the European paradigm in shaping the legal destinies of Balkan states in the contemporary era.

## REFERENCES

1. Elsie, R. (2001). *A dictionary of Albanian history*. Centre for Albanian Studies.
2. Malcolm, N. (1998). *Kosovo: A short history*. Macmillan.
3. Poulton, H. (2000). *Who are the Macedonians?* Indiana University Press.
4. Brown, K. (2003). *The past in question: Modern Macedonia and the uncertainties of nation*. Princeton University Press.
5. Gellci, M. (2014). *The Albanian Legal Tradition in the 20th Century: Between Continuity and Rupture*. *European Journal of Legal History*, 2(3), 140-157.
6. Ramet, S. (2006). *The three Yugoslavias: State-building and legitimation, 1918–2005*. Indiana University Press.
7. Stojarova, V. (2010). *Party politics in the Western Balkans*. Routledge.
8. Bieber, F. (2003). *The role of the Ohrid Framework Agreement and the peace process in Macedonia*. In W. Petritsch & V. Dzihic (Eds.), *Conflict resolution in the South Balkans*. Palgrave Macmillan.
9. Vickers, M. (1999). *Between Serb and Albanian: A history of Kosovo*. Columbia University Press.
10. European Commission. (Various Years). *Progress Reports on Albania and Macedonia*. European Commission.
11. Jelavich, B. (1983). *History of the Balkans: Twentieth century*. Cambridge University Press

# INTERNATIONAL PROTECTION OF INDUSTRIAL PROPERTY!

**Prof.Assoc.Dr. Ervis Çela**

Professor at the Faculty of Law, University of Tirana

[zyreavokatiecela@gmail.com](mailto:zyreavokatiecela@gmail.com)

**MSc. Endi Kalemaj**

Specialist at the National Youth Agency

[endikalemaj2000@gmail.com](mailto:endikalemaj2000@gmail.com)

---

## Abstract

Human history has been based on applications of imagination, innovation and creativity. This is done to solve various problems. There are countless examples of how the imagination of individuals has made today's technological progress possible throughout the course of human history. As for science, imagination is a source of progress in art as well. Music, paintings, sculptures, architecture and other works of art are created by individuals who are not satisfied with the old, but see and express things in new and innovative ways.

If we take a retrospective look at the history of the development of the industrial property right, we will see the problems encountered throughout its development. In this paper, the concept of industrial property, the elements of industrial property, focusing on each one in a general, exhaustive way and finally the treatment of what international protection the directives and legislation of the EU and other member countries offer, will be treated in an analytical way. The analysis will begin with the treatment of the Paris Convention, the Convention for the European System of Granting Patents, the Convention for the Common Patent.

It will continue with the analysis of "Patenting of inventions abroad", "License Contract", "International license agreements", "Legal protection of industrial

samples and trademarks". We will also focus on the three groups of countries based on the birth of the right to the brand.

In this paper, it is intended to deal with the protection of industrial property and to highlight its importance on a wider scale. Important in this whole process and what is intended to be evidenced in the paper is the protection of citizens' interests through the improvement of state institutions and the promotion of sustainable regional development.

**Keywords:** *industrial property, patent, trademark, legal protection, license contract, etc.*

## HYRJE

Përdorimi i gjerë i konceptit “pronë industriale” sipas kuptimit të dokumentave ndërkombëtarë, do të thotë e drejta për shpikjet, markat e mallrave, mostrat industriale etj. E drejta e shpikjes ka karakter thellësisht territorial, dmth shpikja bëhet në një vend dhe vetëm në këtë vend do gëzoje mbrojtje juridike. Një mënyre e tillë krijon situatë të padëshirueshme sepse sjell vetëm dëm ekonomik për shpikësin dhe mbajtësin e së drejtës së shpikjes, gjithashtu vështirëson tregtinë e jashtme. Për të marrë mbrojtje juridike në shtetet e tjera, përdoret “Instituti i Patentimit Jashtë Shtetit” që lejon të merren në mbrojtje dokumentat për shpikjen e caktuar në këto shtete. Në vendet ku shpikja është patentuar, askush pa lejen e mbajtësit të patentës nuk ka të drejtë të përdorë shpikjen e dhënë.

Në kohën e tanishme, regjistrimi i patentave jashtë shtetit përcaktohet nga faktorë të tillë si nevoja e domosdoshme e mbrojtjes juridike të produkteve të gatshme të eksportit, shitjes së licencës, sigurimit të prioritetit të shpikësit dhe më në fund, sigurimi i marrëdhënieve kontraktore me partnerët e huaj. Patentimi i shpikjeve jashtë shtetit bëhet në bazë të legjislacionit të brendshëm të shtetit, në të cilin kërkohet mbrojtja e dokumentit. Mbrojtja e dokumentit realizohet në përputhje me ligjet nacionale të vendosura, megjithatë merren parasysh dhe kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në fushën e mbrojtjes të pronës industriale në kohën e sotme veprojnë shumë marrëveshje të përbotshme, rajonale dhe dy palëshe. Në të parat hyjnë “Konventat e Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale”

në vitin 1883, pjesëmarrës të së cilës janë rreth 90 shtete. Konventa e dhenë është rishikuar disa herë (në vitet 1900, 1911, 1925, 1934, 1958, 1967) por problem i rishikimit të saj qëndron dhe në kohën e tanishme.

Në vitin 1970, në Washington është nënshkruar marrëveshja për kooperimin e patentave, qëllimi i së cilës është thjeshtëzimi i procesit të regjistrimit të patentave jashtë shtetit. Markat e mallrave janë një nga objektet e pronës industriale që gjithashtu u përket mbrojtja ndërkombëtare në bazë të “Marrëveshjes të Madridit për Regjistrimin e Markave dhe të Mallrave”, në vitin 1891.

Nga marrëveshjet që janë në veprim, duhet të përmendim “Marrëveshjen e Strasburgut për Klasifikim Ndërkombëtar të Patentave”, në vitin 1971. Përsa u përket marrëveshjeve rajonale, duhet të përmendim “Konventën për krijimin e Sistemit Europian për dhënien e Patentave” dhe marrëveshjet që veprojnë në marrëdhëniet midis shteteve Afrikane”, viti 1973.

Këshilli Europian dhe Bashkësia Ekonomike Europiane kanë përgatitur disa projekt- marrëveshje për verifikimin e të drejtës së patentave. Në dhjetor të 1975, anëtarë të EEC, në Konferencën e Luksenburgut nënshkruan “Konventën për Patentën e Përbashkët”, sipas të cilës krijohet një e drejtë patente për të gjitha këto shtete. Konventa parashikon mundësinë e dhënies së patentës unike ashtu dhe patentës nacionale.

## **ELEMENTËT E PRONËSISË INDUSTRIALE**

### **A. Treguesit gjeografikë**

Një tregues gjeografik, shpesh me shkurtimin GI, është një emër ose shenjë e përdorur mbi disa produkte, e cila korrespondon me një vendndodhje gjeografike specifike ose origjinë, si për shembull një qytet, një rajon ose një vend. Përdorimi i një GI-je, mund të veprojë si një çertifikatë, që tregon se produkti zotëron disa cilësi të caktuara ose gëzon një reputacion të caktuar në sajë të origjinës së tij gjeografike. Më shpesh, një tregues gjeografik përbëhet prej emrit të vendit të origjinës së të mirave. Produktet bujqësore, në mënyrë tipike, kanë cilësi që rrjedhin prej vendeve të tyre të prodhimit dhe që janë ndikuar prej faktorëve lokale specifikë, të tilla si klima, dhe toka . Treguesit gjeografikë mund të

përdoren për një variantet të gjerë të produkteve bujqësore, të tilla si për shembull “Tuscany” për vajin e ullirit të prodhuar në një zon specifike të Italisë ose “Roquefort” për djathin e prodhuar në Francë. Sidoqoftë, përdorimi i treguesve gjeografik nuk është i limituar thjesht tek produkte bujqësore.

## **B. Të drejtat e dizenjove industriale**

Të drejtat e dizenjove industriale janë të drejta të pronësisë intelektuale, që mbrojnë dizenjon vizuale të objekteve. Një dizenjo industriale përbëhet prej krijimit të një forme, konfiguracioni, kompozimi të modeleve, ngjyrave ose kombinimi i modeleve dhe ngjyrave në formë tredimensionale që përmbajnë vlera estetike. Një dizenjo industriale mund të jetë një model dy ose tredimensional, i përdorur për të prodhuar një produkt, një të mirë industriale ose artizanale. Dizenjo industriale aplikohen mbi një varietet të gjerë produktesh industriale dhe artizanale që nga instrumentet teknike, deri tek orët, arturinat dhe artikuj të tjerë luksi. Që të mbrohet në shumë ligje kombëtare, një dizenjo industriale duhet të “tërheq syrin”. Kjo do të thotë që një dizenjo industriale ka fillimisht një natyrë estetike, dhe nuk mbron ndonjë veçori teknike të produktit mbi të cilin ajo është aplikuar.

## **C. Patenta**

Një patentë është një set i të drejtave ekskluzive i dhënë prej një shteti një të patentuari për një periudhë kohe të fiksuar, kjo në shkëmbim të bërjes publike. Një patentë e dhënë i ofron mbajtësit një status mbi teknologjinë e patentuar dhe procesin e patentuar, për një periudhë kohe ngas 15 deri 20 vjet, në varësi të shtetit ku mbrohet. Ligjet e dhënies së patentave në Amerikë dhe Japoni, japin një shembull të ndryshimeve ligjore në këto shtete si dhe implikimet e tyre për kompanitë. Ndryshimi më thelbësorë midis dy shteteve, është në parimet “first-to-file” dhe “first-to-invent”. Ndërsa shumica e shteteve ndjek parimin e “first-to-file” vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Filipinet ndjekin parimin e “first-to-invent”.

## **D. Veshjet tregtare**

Veshjet tregtare u referohen karakteristikave të paraqitjes vizuale të një produkti ose paketimi të tij (ose madje fasada e një ndërtese, si për shembull një restorant), e cila mund të jetë regjistruar dhe mbrojtur, përballë të qenit e përdorur prej konkurrentëve, me të njëjtën mënyrë si marka. Këto karakteristika përfshijnë formën tredimensionale, dizenjon grafike, kolorin, ose madje aromën e një produkti dhe/ose paketimin e tij. Ekzistojnë dy kërkesa të thjeshta që duhen të plotësohen për mbrojtjen e veshjeve tregtare. E para është që ato veçori duhet të jenë të afta të funksionojnë si një tregues burimi, duke identifikuar një produkt të veçantë dhe prodhuesin e tij tek konsumatorët. Së dyti, veshjet tregtare, duhet të jenë jo funksionale që të mbrohen ligjërisht; përndryshe ajo është një çështje subjekt i ligjit të patentave. Çfarë është funksionale, varet fuqimisht prej produktit të veçantë. Për të qënë jo funksionale, ajo nuk mund të ndikojë mbi kostot, cilësinë e produktit ose aftësinë e një prodhuesi për të konkurruar efektivisht.

## **E. Markat**

Një markë është një shenjë dalluese e ndonjë lloji të caktuar, e cila është përdorur prej ndonjë organizate për të identifikuar në mënyrë unike veten, produktet dhe shërbimet e saj tek konsumatorët dhe për të dalluar organizatën, produktet dhe shërbimet e saj prej atyre të organizatave të tjera. Një markë është një lloj i pronësisë industriale, e cila është e dallueshme prej formave të tjera të pronësisë intelektuale. Sidoqoftë, në juridiksionet e ndryshme është e jashtëligjshme përdorimi i simbolit ® në lidhje me një markë, kur ajo markë nuk është regjistruar. Tradicionalisht një markë përfshin një emër, fjalë shprehje, logo, simbol, dizenjo, imazh, ose një kombinim të këtyre elementëve. Simboli ™, mund të përdoret kur të drejtat e markës pretendohet, por që marka nuk është regjistruar në zyrën e markave të një vendi ose juridiksioni të veçantë, ndërsa shenja ® përdoret kur marka është regjistruar. Nuk është i detyrueshëm përdorimi i të dy simboleve, megjithëse forca e traditës është e tillë që, simbolet përdoren gjerësisht nëpër botë.

Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë industriale

Në mbrojtjen ndërkombëtare të pronësisë industriale luan një rol mjaft të rëndësishëm Konventa e Parisit. Konventa e Parisit ka si objekt mbrojtje patentat

për shpikje, modelet e dobishme, mostrat industrial, markat e prodhimit, shenjat e shërbimeve, emrin e firmave, tregimin e origjinës ose emrin e vendit të origjinës si dhe shmangien e konturimit të pandërgjegjshëm .

Sipas Konventës së Parisit, patenta për shpikje përfshin të gjitha llojet e mbrojtjes së dokumentave sepse në vendet e ndryshme për shpikjet, ka mënyra të ndryshme për ruajtjen e dokumentave si patentat, dëshmitë e autorëve, certifikatat etj.

Të dyja marrëveshjet e përmendura nuk krijuan një patentë ndërkombëtare. Ideja e krijimit të një patente ka ngjallur në kuadrin e Këshillit Europian dhe të Bashkësive Ekonomike Europiane për përgatitjen e disa projekte-marrëveshje për verifikimin e të drejtës së patentave.

Në tetor të vitit 1973 në Muni, 14 shtete europiane nënshkruan “Konventën për Sistemimin Europian të Dhënies së Patentave”. Konventa parashikon dhënien e një patente unike europiane në përputhje me kërkesat e paraqitura në Institutin Europian të Patentave.

Në dhjetor të vitit 1975, 5 anëtare të EEC nënshkruan Konventën për Patentën e Përbashkët në Luksenburg, sipas të cilës krijohet një e drejtë patentë për të gjithë këto shtete. Konventa parashikon mundësinë e dhënies së patentave unike dhe të patentës nacionale.

Në kontinentin e Afrikës në Libreville në vitin 1962, 12 shtete nënshkruan marrëveshjen Afro-Malgashe, me të cilën krijuan në Kameruan një institut të patentave për dhënien e patentave që kanë fuqi në vendet e treguara. Në Konventën e Parisit, të vitit 1883 për mbrojtjen e pronës industriale, përcaktohet se shtetasit e shteteve pjesëmarrës të kësaj konvente, gëzojnë në territorin e shtetit tjetër regjimin nacional në fushën e mbrojtjes juridike të pronës së dhënë.

Për patentën e shpikjeve, mostrave industriale dhe regjistrimin e markave të mallrave nga organet e shtetit ku kryhet veprimi, merret taksë që caktohet në dispozita të veçanta. Pjesëmarrja në marrëveshjen për kooperimin e patentave të vitit 1970, mundëson paraqitjen e kërkesës ndërkombëtare me ndihmën e së cilës mund të sigurohet mbrojtja e shpikjes njëherësh në disa vende. Kërkesa ndërkombëtare u jepet shtetasve dhe personave juridikë të Republikës së Shqipërisë dhe shtetësve të huaj që banojnë në Republikën e Shqipërisë, nga organi i ngarkuar për problemin e shpikjeve dhe racionalizimeve. Në marrëveshje parashikohet afati specifik për dhënien e kërkesës ndërkombëtare. Kërkesa ndërkombëtare jepet në fund të afatit vjetor nga data e prioritetit. Në shumë nga

marrëveshjet e përfunduara midis shteteve parashikohet bërja e përbashkët e kërkimeve dhe e studimeve, si rezultat i kësaj lind domosdoshmëria e mbrojtjes së objekteve të pronës industriale. Të huaj që janë bashkëautor në shpikje dhe në mostrat industriale ose trashëgimtarët e tyre, kanë të drejtë të marrin shpërblim për përdorimin e këtyre shpikjeve dhe të mostrave industriale.

Ky shpërblim ndahet midis bashkëautoreve ose trashëgimtarëve të tyre, sipas marrëveshjes me shkrim të nënshkruar nga të gjithë bashkëautorët ose trashëgimtarët e tyre pa përjashtim. Pjesë e shpërblimit të se cilit person caktohet me përqindje. Në rast se lind mosmarrëveshje për ndarjen e shpërblimit, ajo shqyrtohet në rrugën gjyqësore.

## **PATENTIMI I SHPIKJEVE JASHTË SHTETIT**

Legjislacioni i çdo shteti që i përket fushës në fjalë, parashikon se për mbrojtjen jashtë shtetit të interesave ekonomike të vendit në fushën e shpikjeve dhe për shpejtimin e progresit teknik të vendit, ministritë, institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat realizojnë patentimin (mbrojtjen juridike) të shpikjeve jashtë shtetit.

Patentimi jashtë shtetit realizohet në pajtim me legjislacionin nacional, të vendit në të cilin merret leja për mbrojtjen e dokumentit. Ky dokument, zakonisht kërkohet në emër të ndërmarrjes, firmës ose në emër të autorit të shpikjes. E drejta, në shumicën më të madhe të shteteve parashikon se kërkesa paraqitet nëpërmjet të besuarve të patentave me cilësinë e të cilëve dalin zyra ose firma të veçanta. Kërkesa me të gjitha materialet e nevojshme, brenda 3 muajve pas marrjes së vendimit të organit kompetent për premtimin e shpikjes, i kalon dhomës përkatëse të tregtisë dhe industrisë, e cila i drejtohet të besuarit të saj të patentave të vendit përkatës.

Të gjitha shpenzimet për patentimin e shpikjeve përballohen sipas rastit nga shteti, ndërmarrja, firma ose personi fizik. Pas marrjes së patentës, organizata patentuese detyrohet të bëjë në kohën e duhur pagimin e taksës.

## **KONTRATA E LIÇENSËS**

Zhvillimi i bashkëpunimit tekniko-shkencor midis shteteve, presupozon përdorimin e formave të ndryshme për dhënien e arritjeve tekniko-shkencore dhe sidomos nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve për liçencë. Marrëveshja për

liçencë, përfaqëson në vetvete një lloj kontrate të tregtisë së jashtme, sipas së cilës njëra palë (liçencë dhënësi) detyrohet ti sigurojë palës tjetër (liçencëmarrësit) një pozitë të tillë, në të cilën mund të shfrytëzojë zgjidhjen e caktuar teknike, kurse pala tjetër detyrohet të paguajë për këtë shpërblim përkatës. Sipas kontratës së liçencës, liçencëdhënësi i kalon liçencëmarrësit të drejten për të përdorur shpikjen e caktuar, mostrën industrial ose markën e mallit në kushtet e caktuara që më parë dhe për qëllimin e rënë dakort. Meqënëse kushtet e këtyre kontratave janë të ndryshme, i ndryshëm është dhe objekti i tyre.

Marrëveshjet ndërkombëtare për liçencën janë:

1. Marrëveshje për shfrytëzimin e shpikjes që mbrohen me dokumenta që ruhen dhe marrëveshje për shfrytëzimin e arritjeve për mbrojtjen e dokumentave që nuk mbrohen me dokument.
2. Sipas kushteve të liçencës kemi marrëveshje për liçencë të thjeshtë, liçencë të jashtëzakonshme dhe liçencë të plotë.
3. Marrëveshje paraprake dhe me opsion sis tad i ndërmjetëm për lidhjen e kontratës së liçencës.

Ka mundësi edhe për riklasifikime të tjera të këtyre kontratave.

Kontrata e liçencës mund të lidhet për patentimin e shpikjes nëpërmjet së cilës parashikohet e drejta e liçencëmarrësit për përdorimin e kësaj shpikjeje dhe sigurimi i një përdorimi të tillë.

Kjo do të thotë se liçencëmarrësit jo vetëm i kalon e drejta për përdorim por dhe për prodhimin e produktit të shpikjes së dhënë dhe shitjen e këtij produkti.

Në shumë raste, shpikja mund të mos ketë mundësi të patentohet p.sh. në përmbledhjen e esencës së saj në literaturë, vendosjen e saj në ekspozitë etj. Shpesh herë, shpikjet nuk patentohen për të evituar zbulimin e sekretit të tyre. Kësisoj për lloje të tilla të arritjeve teknike bëhet shumë i vështirë shfrytëzimi i tyre në vende të tjera, pa dokumentacionin teknik dhe kontrollin e prodhimit. Një lloj kontrate është ajo që lidhet për transferimin e teknologjisë nën emrin “Hoy\_Xay” nga anglishtja përkthehet me kuptimin “di si bëhet kjo”. Në përmbajtjen e kontratës përfshihen projektimi i ndërmarrjes, përpunimi i teknikës për procesin e prodhimit të dhënë, vizatimet e paisjeve, reparteve dhe stërvitja e personelit të shërbimit të këtyre paisjeve.

Kontrata për transferimin e teknologjisë së “Hoy\_Xay” lidhet për një afat të caktuar ose pa e treguar këtë afat që nënkupton veprimin për një kohë të pacaktuar. Në marrëdhëniet midis personave juridike të shteteve të ndryshme veprojnë kontratë liçence tip për transferimin e teknologjisë. Përpjekje për unifikimin e përmbajtjes së këtyre kontratave janë bërë në kuadrin e organizatave të ndryshme Për shembull, grupi i ekspertëve pranë Komisionit Ekonomik të OKB për Europën, ka përpunuar dhe udhëhequr hartimin e kontratës për kalimin ndërkombëtar të përvojës së prodhimit dhe njohjes së ndërtimit të makinave të miratuar në mbledhjen e Komisionit Ekonomik për Europën. Në vitin 1969, në Organizatën për Koordinimin European të Industrisë për Punimin e Metaleve është hartuar kontrata tip për transferimin e teknologjisë.

Kontrata e thjeshtë për liçencën, parashikon se me kalimin e të drejtës liçencëmarrësit për përdorimin e arritjeve teknike, liçencëmarrësi ruan për vetë të drejtën për ta shfrytëzuar dhe për t’ia kaluar këtë të drejtë dhe personave të tjerë. Kjo lloj kontrate lidhet zakonisht në lidhje me aftësinë konkurrese për produktet e konsumit të gjerë si medikamentet, prodhimet ushqimore etj. Afati i kontratave është 3-4 vjet.

Kontrata për dhënien e plotë të liçencës lidhet zakonisht në ato raste, kur dhënësi i liçencës nuk ka mundësi ta përdorë vetë shpikjen. Sipas kontratës, ai ia kalon të gjitha të drejtat për përdorimin e shpikjes liçencëmarrësit dhe ky i fundit bëhet zotërues i vetëm i të drejtave, duke zëvendësuar zotëruesin e patentës. Kjo lloj kontrate ka shumë ngjashmëri me kontratën e shitblerjes dhe e dallon nga ajo e fundit vetëm afati, për shembull marrësi i liçencës bëhet zotërues i të drejtave për shpikjen vetëm për periudhën e kohës së parashikuar në kontratë.

Kontrata për shfrytëzimin ekskluziv të liçencës do të thotë se dhënësi i liçencës i kalon të drejtën për përdorimin të arritjeve teknike vetëm marrësit të liçencës. Kontrata për përdorimin ekskluziv të liçencës, për të njëjtën shpikje mund të lidhet me disa kontraktues në vende të ndryshme, duke u dhënë të drejtën atyre për të nxjerrë prodhimin përkatës në këto vende dhe për ta shitur atë në një territor të caktuar. Si shembull, kontrata ekskluzive e liçencës me të drejtën e prodhimit të materialeve silikate të ndërtimit dhe shitjen e tij në territorin Italian, është lidhur nga bashkimi për tregti të jashtme “Licenzintong” me një firmë italiane. Një kontratë e tillë që i përket dhënësit të liçencës për silikatet, është lidhur me

firmën japoneze “Asthi Kemikel Indastriz”, me të drejtën që prodhimi i këtij materiali dhe shitja e tij të bëhet në territorin e Japonisë dhe në disa vende të tjera. Praktika njeh dhe kontratën e ndërmjetme që mund të jetë paraprake dhe me opsion. Kontrata paraprake përmban teza bazë për marrëveshjen e ardhshme për licencën dhe përfshin detyrimin për të lidhur një kontratë të tillë në të ardhme për ta përforcuar me një sasi të hollash si garanci. Për shkeljen e këtij detyrimi marrësi i licencës humbet të drejtën mbi të hollat e vëna si garanci.

Në kontratën me opsion, njëra palë i jep palës tjetër me preferencë, të drejtën për të blerë licencën gjatë një afati të caktuar. Në kontratë, ky afat përcaktohet në mënyrë të saktë. Gjatë këtij afati, shitësi nuk mundohet t’ia propozojë objektin e kontratës blerësve të tjerë. Kontrata është me shpërblim.

